

MONITORIMI I AKSESIT NË DREJTËSI DHE PERFORMANCA GJYQËSORE PËR ZHVILLIMIN E NJË GJYKIMI TË DREJTË

MANUAL TRAJNIMI PËR SHOQËRINË CIVILE

Afatet dhe Cilësia e Gjykimit

Manual 3

Tiranë, Shtator 2023

Ky botim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.



Funded by
the European Union

Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit “Gjyqësori në fokus” i zbatuar nga një konsorcium prej tre partnerësh: Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore (ISPL), Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Centre for Legal Empowerment (CLE), me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të kornizës “Civil Society Facility and Media Programme 2021”.

Ky botim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e Institutit për Studimet Publike & Ligjore dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pozicionin e Bashkimit Evropian.

©Të gjitha të drejtat e botimit i takojnë Institutit për Studimet Publike & Ligjore (ISPL)

ISBN: 9789928361479

SHKURTIME

GjK	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë
GjL	Gjykata e Lartë
GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GjKKO	Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
SPAK	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
GjAJP	Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm
GjAA	Gjykata Administrative e Apelit
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
MD	Ministria e Drejtësisë
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
ILD	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë
ShM	Shkolla e Magjistraturës
K.Pr.C.	Kodi i Procedurës Civile
K.Pr.P.	Kodi i Procedurës Penale
OJF	Organizata jofitimprurëse
CEPEJ	Council of Europe European Commission for the Efficiency of Justice
UNROLI	United Nations Rule of Law Indicators
OECD	Organisation for Economic Co-operation and Development
UDHR	Universal Declaration of Human Rights
PNDKP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
WJP	World Justice Project

Pasqyra e lëndës

SHKURTIME	3
HYRJE	9
PLANI I TRAJNIMIT	12

MODULI 1

MONITORIMI I ZHVILLIMIT TË GJYKIMIT	14
BRENDA NJË AFATI TË ARSYESHËM.....	14
1. Hyrje	14
2. Standardet ndërkombëtare.....	16
3. Kuadri ligjor i brendshëm.....	17
3. Jurisprudenca kombëtare dhe ndërkombëtare mbi elaborimin e termit “afat i arsyeshëm”	19
4. Institucionet përgjegjëse për respektimin e afateve procedurale.....	23
4.1 Gjykata	23
4.2 Prokuroria	24
4.3 Palët/Mbrojtësi ligjor	24
4.4 Sekretaria gjyqësore/Punonjësit e gjykatës.....	25
5. Organet monitoruese (KLGj, KLP, ILD).....	26
6. Udhëzim i shkurtër në lidhje me përcaktimin e indikatorëve, mënyrës së realizimit të monitorimit, përdorimin e faqeve zyrtare, si dhe mbledhjen dhe analizimin e të dhënave	27

MODULI 2

ZHVILLIMI I GJYKIMIT BRENDA NJË AFATI TË ARSYESHËM NË PROCESIN PENAL.....	33
1. Hyrje	33
2. Zbatimi i afateve procedurale gjatë hetimeve paraprake	34
3. Zbatimi i afateve procedurale gjatë zhvillimit të gjyqësorisë në shkallë të parë.....	34
3.1 Afatet procedurale për shqyrtimin dhe caktimin e masave të sigurimit personal.....	34
3.2 Afatet procedurale gjatë zhvillimit të seancës paraprake	36
3.3 Afatet procedurale për zhvillimin e seancës gjyqësore	37
3.4 Afatet procedurale për zhvillimin e gjyqësorisë të posaçme.....	38
3.4.1 Gjykimi i shkurtuar	38
3.4.2 Gjykimi i drejtpërdrejtë	39
3.4.3 Gjykimi me marrëveshje.....	39
3.4.4 Urdhri penal.....	41

4.	Zbatimi i afateve procedurale gjatë gjykimit në apel	42
5.	Zbatimi i afateve procedurale gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë	42
6.	Indikatorët për monitorimin e respektimit të afatit të arsyeshëm	43
	në një proces penal	43

MODULI 3

ZHVILLIMI I GJKIMIT BRENDA NJË AFATI	48
TË ARSYESHËM NË PROCESIN CIVIL.....	48
1. Hyrje.....	48
2. Zbatimi i afateve procedurale gjatë zhvillimit të gjykimit në shkallë të parë.....	48
2.1 Gjykimi i masave të sigurimit.....	48
2.2 Gjykimi zakonshëm	49
2.3 Gjykimi i posaçëm	50
3. Gjykimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit	51
3.1 Procedura dhe mjetet për të kërkuar konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit të çështjes	52
3.2 Procedura dhe gjykimi i padisë për shpërblimin e dëmit për cenim të afatit të arsyeshëm.....	53
3.3 Problematikat në lidhje me aplikimin e neneve 399/1-399/12 të K.P.C.....	54
4. Zbatimi i afateve procedurale në gjykimin në apel	56
5. Zbatimi i afateve procedurale në gjykim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.....	57
6. Indikatorët për monitorimin e respektimit të afatit të arsyeshëm në një proces civil.....	58

MODULI 4

ZHVILLIMI I GJKIMIT BRENDA NJË AFATI TË ARSYESHËM	62
NË PROCESIN ADMINISTRATIV	62
1. Hyrje	62
2. Zbatimi i afateve procedurale gjatë zhvillimit të gjykimit në shkallë të parë.....	63
2.1 Respektimi i afateve procedurale për shqyrtimin e kërkesave për sigurimin e padisë;.....	63
2.2 Respektimi i afateve procedurale për zhvillimin e gjykimit të zakonshëm;	64
2.2.1 Afatet për kryerjen e veprimeve përgatitore;.....	64
2.2.2 Afatet për zhvillimin e seancës gjyqësore;.....	65
3. Zbatimi i afateve procedurale në gjykimin në apel	66
4. Zbatimi i afateve procedurale në gjykimin pranë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.....	66
5. Indikatorët për monitorimin e respektimit të afatit të arsyeshëm në një proces administrativ.....	67

MODULI 5

CILËSIA DHE ARSYETIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE.....	70
1. Hyrje.....	70
2. Standartet ndërkombëtare.....	71
3. Kuadri ligjor i brendshëm dhe jurisprudenca vendase.....	71
4. Elementet, struktura dhe standarti i arsytimit që duhet të ketë një vendim gjyqësor	72
4.1 Struktura dhe elementet e vendimeve civile dhe administrative;	73
4.2 Struktura dhe elementet e vendimeve penale;.....	74
5. Kontrolli i vendimeve gjyqësore nga gjykatat më të larta.....	75
6. Roli i organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në monitorimin e cilësisë së vendimeve	77
7. Roli i Shkollës së Magjistraturës në përmirësimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore.....	79
8. Indikatorët për monitorimin e cilësisë dhe arsytimit të vendimit gjyqësor.....	80

MODUL 6

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE.....	81
1. Hyrje.....	81
2. Nxjerrja e urdhrin të ekzekutimit.....	82
3. Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimeve penale.....	84
4. Ekzekutimi i dënimit me burg	85
5. Ekzekutimi i dënimeve alternative	86
6. Ekzekutimi i dënimit me gjobë.....	87
7. Indikatorët për monitorimin e ekzekutimit të vendimeve penale.....	87

MODUL 7

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE CIVILE & ADMINISTRATIVE	89
1. Hyrje.....	89
2. Vënia në ekzekutim e vendimit gjyqësor.....	90
3. Zhvillimi i procedurës përmbare për ekzekutimin e vendimit.....	91
4. Pavlefshmëria e titullit ekzekutiv (neni 609 i K.Pr.C.).....	92
5. Kundërshtimi i veprimeve përmbare (neni 610 K.P.Civile)	93
6. Kërkimi i sendit nga personi i tretë (neni 612 i K.Pr.C)	94
7. Indikatorët për monitorimin e zbatimit të rregullave dhe afateve procedurale për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore civile dhe administrative.....	95

EKSTRAKTE NGA LEGJISLACIONI	97
RASTE STUDIMORE	104
BIBLIOGRAFIA	107

HYRJE

Manuali i Trajnimit nr. 3 mbi “*Monitorimin e aksesit në drejtësi dhe performanca gjyqësore për zhvillimin e një gjykimi të drejtë*”, është hartuar në kuadër të projektit “Judiciary under spotlight” i zbatuar nga konsorciumi prej tre partnerësh, Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore (ISPL), Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Centre for Legal Empowerment (CLE) me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të kornizës “Civil Society Facility and Media Programme 2021” nën IPA III/2022/441-466. Projekti synon të fuqizojë shoqërinë civile të Shqipërisë dhe aktorët e tjerë për të zhvilluar monitorimin dhe vlerësimin e gjyqësorit dhe ushtrimit të veprimtarisë së tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Manuali hartohet si vijimësi e Guidës Monitorimi për Shoqërinë Civile, “Aksesi në Drejtësi dhe Gjykimi i Drejtë”, synimi i të cilës është aftësimi i aktorëve të shoqërisë civile të ndërmarrin nisma në kuadër të llogaridhënies efektive, rritjes së përgjegjshmërisë nga ana e institucioneve të drejtësisë dhe përmirësimit të legjislacionit nëpërmjet:

- Zhvillimit të një kornize të përgjithshme matjeje për të monitoruar përvojën e qytetarëve në plotësimin e nevojave të tyre të përditshme ligjore dhe në aksesin në sistemin e drejtësisë;
- Ofrimit për organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në fushat e sistemit të drejtësisë dhe ndihmës juridike, studentëve të drejtësisë dhe gazetarëve të një kornize referimi të përbashkët, në mënyrë që të nxiten, të përmirësohen dhe të harmonizohen nismat e tyre për të monitoruar aksesin në drejtësi të qytetarëve.

Në vijim të treguesve dhe faktorëve të përcaktuar në guidë, nëpërmjet këtij Manuali do të analizohen në mënyrë të detajuar të gjitha elementet dhe standardet që duhet të zbatohen për zhvillimin e një procesi të rregullt gjyqësor, duke u ndalur në tre komponentë kryesorë:

- 1. Zhvillimi i një procesi gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm;**
- 2. Dhënieja e një vendimi të arsyetuar sipas standardeve të përcaktuara në ligj;**
- 3. Ekzekutimi i vendimeve.**

Analiza ligjore e akteve ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor të brendshëm do të ndërthurren me jurisprudencën e GjEDNj-së dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, si dhe do të merren në analizë disa vendime të praktikës gjyqësore me qëllim dhënien e një tabloje të plotë të mënyrës së zbatimit dhe respektimit të këtyre parimeve dhe ofrimit

të elementeve të referimit për monitorimin e tyre nga aktorët e drejtësisë.

Manuali do të ndahet në 7 module, ku secili modul do të strukturohet në disa nëntema, me qëllim analizimin në mënyrë të detajuar të të gjitha elementeve që përmbajnë 3 komponentët e mësipërm:

Moduli 1: Do të përmbajë një analizë të detajuar të koncepteve kryesore të parimit të zhvillimit të një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, aktet ndërkombëtare universale që kanë parashikuar këtë parim, si ka evaluar ky parim nëpërmjet përkufizimeve dhe analizimit në vendimet e GjEDNj-së, jurisprudencën vendase etj. Në këtë modul do të përfshihet dhe një udhëzues i shkurtër në lidhje me përdorimin e të dhënave gjyqësore të publikuara në faqet zyrtare të gjykatave, MD dhe prokurorisë, me qëllim realizimin e monitorimit të zbatimit nga gjykatat vendase të këtij parimi.

Moduli 2-4: Në tri modulet do të trajtohet veçmas respektimi i afatit të arsyeshëm në procesin penal, civil dhe administrativ, pasi referuar kuadrit ligjor secili proces gjyqësor rregullohet nga një ligj i posaçëm, konkretisht nga K.Pr. Penale, K.Pr.Civile dhe ligji nr.49/2012. Analiza juridike e secilit proces (penal, civil, administrativ) do të trajtohet në module më vete, të cilët do të kenë të njëjtën strukturë dhe do të kenë në fokus analizimin e komponentëve të njëjtë. Konkretisht do të analizohen afatet e parashikuara në ligj për shqyrtimin e çështjes në shkallë të parë, në apel dhe në Gjykatën e Lartë, rolin që kanë institucionet përgjegjëse për respektimin e afateve procedurale. Në fund të çdo moduli do të shpjegohen në mënyrë të detajuar indikatorët dhe metodologjia e monitorimit të respektimit të afatit të arsyeshëm në secilin proces, mbledhja e të dhënave dhe analizimi i tyre.

Moduli 5: Do të përmbajë një analizë të detajuar të koncepteve kryesore të cilësisë dhe standardit të arsyetimit të një vendimi gjyqësor, elementet dhe struktura që duhet të ketë një vendim gjyqësor. Gjithashtu do të analizohet roli i gjykatave më të larta, organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe i Shkollës së Magjistraturës në kontrollin e cilësisë së vendimeve gjyqësore dhe përmirësimin e cilësisë së tyre. Në fund të modulit do të shpjegohen në mënyrë të detajuar indikatorët dhe metodologjia e përdorur për monitorimin e respektimit të cilësisë dhe standardit të arsyetimit të një vendimi gjyqësor.

Moduli 6: Me anë të këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen dhe thellojnë njohuritë në lidhje me standardet ndërkombëtare dhe procedurën e parashikuar në K.Pr.Penale, ligjin nr.79/2020 "*Për ekzekutimin e vendimeve penale*" i ndryshuar, në lidhje me ekzekutimin e një vendimi penal, pasojat që sjell mosekzekutimi në kohë i vendimit penal, të drejtat dhe gjykimi i kërkesave procedurale gjatë ekzekutimit të dënimit. Në fund të modulit do të shpjegohen në mënyrë të detajuar indikatorët dhe metodologjia e monitorimit të ekzekutimit të një vendimi penal.

Moduli 7: Ky modul do të përmbajë një analizë të detajuar mbi ekzekutimin e një vendimi gjyqësor, të drejtat dhe mjetet procedurale që kanë palët për të kundërshtuar ekzekutimin e një vendimi, pavlefshmëria e titullit ekzekutiv (vendimit gjyqësor), pasojat e mosekzekutimit të vendimit, pozita procedurale e personit të tretë në procesin e ekzekutimit etj. Në fund të

modulit do të shpjegohen në mënyrë të detajuar indikatorët dhe metodologjia e monitorimit të ekzekutimit të një vendimi civil dhe administrativ.

Ky Manual ka për qëllim aftësimin e aktorëve të shoqërisë civile, studentëve, gazetarëve, praktikantëve të ligjit në thellimin e njohurive të tyre mbi parimet dhe standardet e zhvillimit të procesit të rregullt gjyqësor, duke pasur në fokus zhvillimin e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, standardet për cilësinë dhe dhënien e një vendimi të arsyetuar nga gjykata, si dhe ekzekutimin e vendimit të formës së prerë.

Manuali ka për qëllim:

- Të ofrojë njohuri të thelluara mbi standardet ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor të brendshëm në lidhje me zhvillimin e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm;
- Të ofrojë njohuri të thelluara mbi standardet ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor të brendshëm në lidhje me standardet e dhënies së një vendimi të arsyetuar;
- Të ofrojë njohuri të thelluara mbi institucionet/aktorët përgjegjës për respektimin e afateve procedurale dhe ndikimin që kanë ata në performancën e sistemit gjyqësor;
- Të ofrojë njohuri të thelluara mbi rëndësinë e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore;
- Të shërbejë si një pikë referimi për përcaktimin e indikatorëve të monitorimit, me qëllim mbledhjen e të dhënave nëpërmjet metodave cilësore dhe sasiore;
- Nëpërmjet ndërthurjes së metodës teorike me kazuse dhe zgjidhjes së ushtrimeve nga praktika, do të synojmë aftësimin dhe rritjen e kapacitetit ligjor të aktorëve të shoqërisë civile, studentëve, gazetarëve dhe praktikantëve të ligjit për zbatimin dhe monitorimin e këtyre parimeve.

Në përfundim të këtij manuali aktorët e shoqërisë civile do të kenë aftësitë e duhura për të ndërmarrë nisma në kuadër të llogaridhënies efektive, rritjes së përgjegjshmërisë nga ana e institucioneve të drejtësisë, përmirësimit të legjislacionit të sistemit të drejtësisë, ndihmës juridike, monitorimin e respektimit të parashikimeve ligjore të zhvillimit të një gjykimi brenda afateve të arsyeshme, dhënien e një vendimi të arsyetuar dhe ekzekutimin e vendimit duke analizuar standardet e performancës të parashikuara në ligj e gjithashtu duke pasqyruar treguesit e realizimit dhe mënyrat e matjes së tyre.

PLANI I TRAJNIMIT

Trajnimi i pjesëmarrësve mbi monitorimin e respektimit të afatit të arsyeshëm, cilësisë dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ekzekutimit të vendimeve penale, sipas moduleve të strukturuar si më lart mund të realizohet në një kohëzgjatje 2 orë, sipas tabelës së mëposhtme:

Aktiviteti	Metoda	Kohëzgjatja
<p>Zhvillimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm (Moduli 1-4)</p> <p>Me anë këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen me aktet ndërkombëtare dhe ligjet e brendshme që parashikojnë standardet për zhvillimin e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm në procesin civil, administrativ dhe penal duke e ndërthurur me analizën gjyqësore që është bërë nga gjykatat e brendshme, GjK dhe GjEDNj.</p> <p>Gjithashtu në këtë modul do të prezantohet një udhëzim i shkurtër në lidhje me përdorimin e faqeve zyrtare të gjykatave dhe të dhënave zyrtare të publikuara nga gjykata, prokuroria, MD, të dhëna që pjesëmarrësit mund t'i përdorin gjatë punës/veprimtarisë së tyre.</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/rasteve studimore</p>	<p>1 orë</p>
<p>Cilësia dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore (Moduli 5)</p> <p>Me anë këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen me aktet ndërkombëtare dhe ligjet e brendshme që parashikojnë standardet për cilësinë dhe arsyetimin e një vendimi gjyqësor, duke e ndërthurur me analizën gjyqësore që është bërë nga gjykatat e brendshme dhe GjEDNj.</p> <p>Gjithashtu në këtë modul do të pasqyrohet roli që kanë gjykatat më të larta, institucionet e sistemit të drejtësisë, ShM, avokatët etj., për përmirësimin e cilësisë së vendimeve.</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/rasteve studimore</p>	<p>30 minuta</p>

<p>Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore (Moduli 6-7)</p> <p>Me anë këtyre dy moduleve pjesëmarrësit do të njihen dhe thellojnë njohuritë në lidhje me standardet ndërkombëtare dhe procedurën e parashikuar në K.Pr. Penale, ligjin nr.79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” në lidhje me ekzekutimin e një vendimi penal, të drejtat dhe gjykimi i kërkesave procedurale gjatë ekzekutimit të dënimit, procedurën e parashikuar në K.Pr.Civile, ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, në lidhje me ekzekutimin e një vendimi civil&administrativ, të drejtat që kanë palët për të kundërshtuar veprimet e përmbaruesit, të kërkojnë pavlefshmërinë e titujve ekzekutivë etj.</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/ rasteve studimore</p>	<p>1 orë e 30 minuta</p>
--	--	--------------------------

MODULI 1

MONITORIMI I ZHVILLIMIT TË GJYKIMIT BRENDA NJË AFATI TË ARSYESHËM

1. Hyrje

Drejtësi e vonuar, drejtësi e mohuar, është një nga postulatet që qëndron në themel të zhvillimit të një procesi të rregullt gjyqësor, i mishëruar në shumë akte ndërkombëtare dhe kombëtare. Gjykimi dhe shqyrtimi i një çështjeje penale ose e një mosmarrëveshjeje civile apo administrative duhet të realizohet brenda një afati të arsyeshëm, në të kundërt humbet kuptimi i vetë të drejtës që po gjykohet.

Parimi i procesit të rregullt ligjor përbëhet nga një tërësi elementesh dhe komponentësh, të cilët duhet të zbatohen në mënyrë rigorozë nga gjykata, autoritetet publike apo palët gjatë një procesi gjyqësor ose administrativ. Një nga elementet e rëndësishme të këtij parimi është e drejta për zhvillimin e procesit gjyqësor brenda një “afati të arsyeshëm”. Respektimi i këtij elementi shihet si garanci për mbrojtjen e palëve, rritjen e besimit në sistemin e drejtësisë dhe forcimin e shtetit ligjor e të së drejtës. Efiçenca në sistemin e drejtësisë është një kriter i rëndësishëm për zhvillimin dhe konsolidimin e një procesi të rregullt ligjor, si dhe për rivendosjen e të drejtave që pretendohen se janë cenuar. Prandaj, çdo vonesë ndikon dhe ka efekt të drejtpërdrejtë te palët në proces, pasi këtyre të fundit iu cenohen të drejtat e tyre kushtetuese dhe përfundimisht procesi gjyqësor degradon dhe bëhet joefektiv.¹

Ndonëse parimi për zhvillimin e një procesi brenda një afati të arsyeshëm është parashikuar në disa akte të rëndësishme ndërkombëtare, të cilat janë pasqyruar edhe në legjislacionin e brendshëm, respektimi i tij në praktikë është problematik.

Referormimi i sistemit gjyqësor pati një ndikim të drejtpërdrejtë në respektimin e këtij parimi, pasi për shkak të shkarkimit dhe largimit nga detyra të gjyqtarëve në kuadër të procesit të “vetingut”, dy nga gjykatat më të rëndësishme, Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë pushuan së funksionuari për periudhën 2017-2019, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në pezullimin e gjykimit të çështjeve, duke krijuar një stok çështjesh që duhen vite për t’u shqyrtuar. Sipas statistikave të këtij procesi, 60% e magjistratëve janë pushuar nga detyra ose kanë dhënë dorëheqjen, duke përfshirë gjyqtarë në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese (në një moment këto dy gjykata kishin në përbërje të tyre vetëm nga

1. Shih Raportin: *Studim dhe Monitorim i Gjykatës së Rrethit Tropojë*, përgatitur nga Qendra Integrim dhe Zhvillim Demokratik”, Viti 2019

një gjyqtar secila). Aktualisht, Gjykata e Lartë ka një “backlog” (çështje të prapambetura) prej pothuajse 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) çështje, një pjesë e të cilave është akumuluar në periudhën maj 2019 deri në mars 2020, periudhë gjatë së cilës ajo nuk mund të formonte një trupë gjyqësore për të gjykuar çështjet.² I njëjti efekt u pasqyrua në gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, ku një çështje jokomplekse (p.sh. marrëdhënie pune) i duhet mesatarisht një afat prej më shumë se 5 vite për t’u gjykar në të dyja shkallët. E gjithë kjo situatë ka cenuar procesin e rregullt ligjor, dhe besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Ky fakt konstatohet edhe nga KLGj³, e cila shprehet se në gjykatat e shkallëve të para ka rritje të backlog-ut në çështje civile, penale apo të të dyjave kategorive. Stoku i çështjeve të mbartura në fund të vitit 2020, ka pësuar një rritje prej 29% në krahasim me fundin e vitit 2019. Kjo rritje përbën një fakt shqetësues për sistemin gjyqësor...Gjykata Administrative e Apelit paraqet një nivel të ulët të efikasitetit ku pavarësisht mungesave të papërfillshme krahasuar me gjykatat e apelit në përgjithësi, me vetëm 1.5 gjyqtarë për të plotësuar organikën, ritmi i gjykimit të çështjeve ka qenë i ngadaltë. Kjo performancë e dobët solli uljen e normës së likuidimit të çështjeve në nivelin 37% duke ndikuar njëkohësisht në rritjen e backlog-ut dhe zgjatjen e afateve kohore të nevojshme për shqyrtimin e çështjeve.

Gjykata e Lartë shprehet se: *“Numri i madh i çështjeve të grumbulluara në vite mbetet një problem shqetësues për veprimtarinë e Gjykatës së Lartë, që ndikon drejtpërdrejt në efektivitetin e administrimit të drejtësisë. Duhet vënë në dukje se gjatë pjesës së parë të vitit 2022, u desh të përballej me vështirësi serioze për shkak të vakancave të shumta në organikën e magjistratëve dhe këshilltarëve ligjorë të Gjykatës së Lartë, e cila ka pasur ndikim vendimtar në sasinë e çështjeve gjyqësore të gjykuara në Gjykatën e Lartë”*.⁴ Vonesat në shqyrtimin e çështjeve kanë ardhur si rezultat i ngarkesës së madhe dhe akumulimit të dosjeve në këtë gjykatë ndër vite. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë po shqyrton çështjet e themelit të regjistruara në vitin 2014, që kanë kaluar për gjykim pas seleksionimit të tyre në dhomën e këshillimit. Aktualisht rezultojnë 656 çështje civile të vitit 2014⁵. Pra, nëse u referohemi këtyre të dhënave, rezulton se në vitin 2023, janë ende të pashqyrtuara në Gjykatën e Lartë 656 çështje të regjistruara në vitin 2014, ndonëse kanë kaluar rreth 9 vite, një afat i cili absolutisht mund të konstatohet që ka cenuar parimin e gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

Respektimi i parimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm varet nga disa faktorë, si sjellja dhe roli i gjykatës, prokurorisë, sekretarisë gjyqësore, palëve ndërgjyqëse, natyrës/kompleksitetit të çështjes, infrastrukturës së gjykatave dhe hartimit e zbatimit të politikave ligjore.

2. Shih Raportin e Komisionit të Ministrave, datë 4 qershor 2020, (CM/Notes/1377/H46-1); Vendimi i GjEDNj-së “Bara dhe Kola kundër Shqipërisë”, Kërkesa nr. 43391/18 dhe 17766/19.

3. Shih Raportin “Mbi Gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2020”, aksesuar në linkun: http://www.gjykataelarte.gov.al/web/raporti_vjetor_klgj_2020_6578.pdf

4. Shih Raportin Vjetor të Performancës për vitin 2022., Gjykata e Lartë, aksesuar në linkun http://www.gjykataelarte.gov.al/web/raporti_vjetor_i_performances_se_gjykates_se_larte_per_vitin_2022_redaktuar_final_14055.pdf

5. Shih Vendimin nr.139, datë 21.06.2023 i Gjykatës Kushtetuese.

Monitorimi i këtyre elementeve nga aktorët e shoqërisë civile, studentëve dhe gazetarëve do të sjellë evindentimin e problematikave konkrete, duke mundësuar dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e situatës. Gjithashtu do të përftohen të dhëna dhe fakte që do të ndikojnë në marrjen e masave dhe hartimin e politikave efikase për respektimin e këtij parimi nga të gjithë aktorët, me qëllim jo vetëm rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur nga pala që e pretendon atë, por edhe rritjen e standardit të gjykimit apo rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

2. Standardet ndërkombëtare

Termin “zhvillimi i procesit brenda një afati të arsyeshëm”, i cili është pjesë e parimit të procesit të rregullt ligjor e gjejmë të parashikuar në mënyrë të shprehur, si pjesë e formulimit të këtij parimi në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Konkretisht në nenin 6 të KENDj-së parashikohet se: *“...çdo person ka të drejtë që çështja të gjykohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar në bazë të ligjit”.*

Në aktet ndërkombëtare që kanë parashikuar mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, elementi “afat i arsyeshëm” nuk është pjesë e parimit të procesit të rregullt, por këtë element e gjejmë të parashikuar në dispozitë më vete.

Në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, si akti i parë ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nuk e gjejmë të parashikuar në mënyrë të shprehur termin “brenda një afati të arsyeshëm”. Në nenin 10 të Deklaratës “parimi i procesit të rregullt ligjor” parashikohet me këtë formulim: *“Gjithkush gëzon njëlloj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale”.*

Edhe në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, termi *“brenda një afati të arsyeshëm”*, gjendet i parashikuar në nenin 9 të Paktit, por nuk është pjesë e parimit të procesit të rregullt ligjor.

Prashikimi i parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, në formulimin e parimit të procesit të rregullt ligjor, nxjerr në pah rëndësinë që ka ky parim në efikasitetin dhe dhënien e drejtësisë. Zhvillimi i një procesi gjyqësor për një kohëzgjatje të pajustificuar, në raport me rrethanat e çështjes, passjell pasiguri dhe humbje të interesit të palëve në gjykim për të pritur përfundimin e gjykimit dhe marrjen e një vendimi të formës së prerë.

Nga ana tjetër, një sistem drejtësie efikas është vendimtar për rritjen ekonomike pasi besimi se standardet ligjore respektohen plotësisht, përkthehet drejtpërdrejt në bindje dhe siguri për investime të veçanta në ekonomi. Për më tepër, duke marrë parasysh se janë kryesisht gjykatat kombëtare që janë kujdestare të së drejtës së BE-së, efikasiteti i sistemeve të drejtësisë kombëtare është gjithashtu thelbësor për zbatimin e kësaj të drejte. Pra, mangësitë e sistemeve të drejtësisë kombëtare, janë një problem jo vetëm për Shtetet Anëtare, por

gjithashtu ndikojnë në funksionimin e tregut të BE-së dhe zbatimin e instrumenteve të saj, bazuar në njohjen reciproke dhe bashkëpunim. Ata gjithashtu mund të dëmtojnë sigurinë që qytetarët dhe bizneset kanë të drejtë të presin në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të tyre nga legjislacioni i Bashkimit Evropian⁶.

Lidhja e ngushtë midis procesit civil, shpejtësisë në gjykim, procedurave të sakta dhe të drejta është nënvizuar edhe në Rekomandimin Nr. R(84)5385 të Komitetit të Ministrave të KE-së, që ka identifikuar nëntë “*parimet e procedurës civile të krijuara për të përmirësuar funksionimin e drejtësisë civile*”. Këto parime sugjerojnë që të caktohet një staf administrativ dhe mjete më moderne/teknike në dispozicion të gjykatave, të ketë një numër të caktuar seancash; trupa gjyqësore të ketë aftësinë të konstatojë cenimet e procedurës, cilët janë cenesit dhe t’i ndëshkojë ata; të lehtësojë sa të mundet parashtrimin e fakteve dhe provave gjatë gjykimit dhe në fund të gjykimit të japë një vendim përfundimtar, të arsyetuar dhe konciz.⁷

3. Kuadri ligjor i brendshëm

Garantimi i procesit të rregullt ligjor dhe të drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, parashikohet shprehimisht në nenin 42 paragrafi II i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: “*Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj*”.

Zhvillimi i një procesi gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm konkretizohet në aktet ligjore që parashikojnë rregulla për zhvillimin e një procesi gjyqësor civil, penal dhe administrativ, si Kodi i Procedurës Civile, Kodi i Procedurës Penale dhe Ligji nr.49/12 “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative*” etj., në të cilat janë parashikuar afate, procedura dhe rregulla të cilat diktojnë zhvillimin e gjykimit në një afat sa më të shpejtë.

Në nenin 342, të Kodit të Procedurës Penale parashikohet parimi i gjykimit të pandërprerë: “*1. Kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të përfundojë në një seancë të vetme, gjykata vendos që të vazhdojë ditën e mëpasme të punës. 2. Gjykata mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor, vetëm për arsye të veçanta, deri në pesëmbëdhjetë ditë*”.

Në nenin 28 dhe 171 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet detyrimi i gjykatave për të shqyrtuar dhe zgjidhur kërkesat e palëve, nëpërmjet caktimit dhe respektimit të afateve për zhvillimin e procedurës së rregullt gjyqësore, me qëllim realizimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

6. Shih Staszczuk.P S ‘*Pozicioni i debitorit dhe kreditori sipas legjislacionit Brusles, legjislacioni dytesor, Studia Praëno-Ekonomieczne*, 2015 PL ISSN 0081-6841 s. 109-121.

7. Shih Raportin: *Studim dhe Monitorim i Gjykatës së Rrethit Tropojë*, përgatitur nga Qendra Integrim dhe Zhvillim Demokratik”, Viti 2019.

Edhe në ligjin 49/2012, parashikohet detyrimi i gjykatës për të siguruar nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, mbrojtjen juridike të të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues e ligjorë të subjekteve, që mund të cenohen si pasojë e ushtrimit ose jo të funksioneve publike nga ana e organeve të administratës publike (neni 3 i ligjit).

Disa nga problematikat e evidentuara në analizën e sistemit të drejtësisë, janë të lidhura me mungesën e gjykimit të një çështjeje brenda një afati të arsyeshëm, kjo për shkak të mungesës së rregullimeve të detajuara në Kodin e Procedurës Civile të cilat kanë sjellë zvarritje të proceseve gjyqësore duke u bërë kështu një problem serioz në Shqipëri. Deri në shtator të vitit 2014, 70% e ankesave drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë ndaj gjyqtarëve, kishin të bënin me zvarritjen e proceseve gjyqësore⁸.

Referuar problematikave të konstatuara me ligjin nr.38/2017, u bënë disa ndryshime dhe shtesa thelbësore në Kodin e Procedurës Civile, pasi për herë të parë u parashikua se cila është periudha e gjykimit të një çështjeje, që do të konsiderohet e “arsyeshme” dhe e drejta e palëve ndërgjyqëse në një proces për të përfituar dëmshpërblim, nëse çështja e tyre është zgjatur dhe gjykuar tej afateve të arsyeshme.

Konkretisht në nenin 399/2 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet: *“1. Në kompetencë të gjykatave, sipas shkallëve të gjykimit të përcaktuar në këtë kre, hyjnë edhe shqyrtimi i kërkesave për shpërblimin e drejtë të personit që ka pësuar një dëm pasuror ose jopasuror, për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes, sipas përkufizimit të nenit 6/1 të Konventës Europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”. 2. Dispozitat e këtij kreu përcaktojnë vlerësimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, si edhe shpërblimin e drejtë, kur konstatohet kohëzgjatje e paarsyeshme në procedurat e hetimit, gjykimit të çështjeve, si edhe në procedurat e ekzekutimit të vendimeve”.*

Ndonëse për proceset civile dhe penale nuk janë parashikuar afate specifike, brenda të cilave duhet të përfundojë procesi gjyqësor i gjykimit të themelit të çështjes, në Kodin e Procedurës Civile janë parashikuar afate tavan për shqyrtimin e një çështjeje në procesin penal, civil apo administrativ, ku tejkalimi i këtyre afateve përbën shkelje të afatit të arsyeshëm dhe legjitimon kërkesën për kërkimin e dëmshpërblimit.

Duhet të theksojmë që për herë të parë termi “afat i arsyeshëm” është konkretizuar me afate specifike për secilin proces dhe fazë gjykimi. Në nenin 399/2 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen:

8. Shih “Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”, Qershor 2015, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë; Relacion Për projektligjin “Për Kodin e Procedurës Civile”.

	Hetime paraprake	Gjykatë Shk.1	Gj. Apelit	Gj. Lartë	Ekzekutimi i vendimeve
Administrativ		1 Vit	1 Vit	-	1 Vit
Civil		2 Vite	2 Vite	2 Vite	1 Vit
Penal:	3 Muaj-3 Vite	2 Vite			
a) Krime			1 Vit	1 Vit	
b) Kundërvajtje		1 Vit	6 Muaj	6 Muaj	

Tabela nr.1

Në lidhje me afatet e sipërcituara të zhvillimit të llojeve të gjykimit, ato llogariten që nga momenti i regjistrimit të çështjes në secilën shkallë të gjykimit dhe deri në shpalljen e vendimit të arsyetuar. Afati i përcaktuar për ekzekutimin e vendimit civil ose administrativ fillon nga dita e paraqitjes së kërkesës për vënien në ekzekutim nga pala që ka fituar të drejtën. (Neni 399/2 pika 1/c K.Pr.C).

Në afatet e sipërcituara, nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, ose kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për zhvillimin e procedimit. (399/2 pika 3 K.Pr.C)

Në varësi të kompleksitetit të çështjes, objektit të mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjykimit, sjelljen e organit që po kryen procedurat, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen, palët mund të kërkojnë konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm edhe nëse nuk janë plotësuar afatet e sipërcituara. (399/2 pika 2 K.Pr.C).

3. Jurisprudenca kombëtare dhe ndërkombëtare mbi elaborimin e termit “afat i arsyeshëm”

Lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata Kushtetuese⁹ dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në një sërë çështjes kanë konsoliduar qëndrimin se arsyeja e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet sipas rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos sjelljen e kërkuarit dhe rrezikun që

9. Shih Vendimin nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese; Vendimi nr.16, datë 16.03.2021; Vendimi nr. 76, datë 04.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese.

passjell për të kjo tejzgjatje e afateve të gjykitimit, kompleksitetin e çështjes si dhe sjellja e autoriteteve.

Ndonëse GjEDNj-ja nuk përcakton limite kohore specifike dhe merr në konsideratë rrethanat e çdo çështjeje për të vlerësuar vonesat, një studim i vitit 2006, i kryer nga Komisioni Evropian për Efiçencën e Drejtësisë (CEPEJ)¹⁰, ka konstatuar se referuar vendimeve të GjEDNj-së do të konsiderohen shkelje të afatit të arsyeshëm:

Natyra e çështjes	Objekti	Kohëzgjatja	Vendimi
Penale	Të ndryshme	Më shumë se 5 vite	Shkelje
Civile	Çështje me përparësi	Më shumë se 2 vite	Shkelje
Civile	Komplekse	Më shumë se 8 vite	Shkelje
Administrative	Çështje me përparësi	Më shumë se 2 vite	Shkelje
Administrative	Normale, komplekse	Më shumë se 5 vite	Shkelje

Tabela nr.2

Në morinë e çështjeve të trajtuara, GjEDNj-ja për të analizuar nëse një proces gjyqësor është zhvilluar brenda një afati të arsyeshëm ose jo, ka evidentuar disa faktorë përcaktues, si:

- a. *Kompleksiteti dhe natyra e çështjes (Numri i palëve pjesëmarrëse, numri i dëshmitarëve, lidhja e çështjes me çështje të tjera etj.);*
- b. *Sjellja e ankuesve;*
- c. *Sjellja e autoriteteve gjyqësore e administrative.*

Më poshtë do të analizojmë se çfarë do të kuptojmë me secilin nga komponentët, si ato zbatohen rast pas rasti në çështje të caktuara, interpretimi që i ka dhënë GjEDNj-ja dhe Gjykata Kushtetuese secilit komponent.

- i. *Periudha që duhet marrë në konsideratë;*

Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se kohëzgjatja e procesit normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor, deri në momentin kur jepet vendim.¹¹ Për herë të parë me ndryshimet e K.P. Civile është përcaktuar afati i arsyeshëm brenda të cilit duhet të shqyrtohet një çështje civile/penale/administrative. Krahas këtij parashikimi siç do të analizojmë dhe në modulet në vijim ligjvënësi ka parashikuar afate specifike brenda të cilave duhet të zhvillohet një proces gjyqësor. Në këto raste gjykatat janë të detyruara të respektojnë afatet, në të kundërt janë përpara shkeljes së gjykitimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

10. <https://rm.coe.int/best-practices-on-the-prevention-of-the-unreasonable-length-of-proceed/1680790b44>

11. Shih Vendimin nr. 83, datë 30.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese.

Për shembull, lidhur me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, gjykata ka vërejtur se garantimi i kryerjes së procesit të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme, të parashikuara nga neni 3 i ligjit nr. 49/2012, është parim me rëndësi të veçantë. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësimit në krijimin e gjykatave administrative. Ky ligj synon thjeshtimin e procedurave që kanë objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative. Afatet konkrete të përcaktuara në ligj për gjykimin e çështjeve duhet të zbatohen nga gjykatat administrative për shqyrtimin e çështjeve. Ligji nr. 49/2012, për më tepër ka parashikuar afate të mirëpërcaktuara për gjykimin në shkallë të parë (neni 25 - për veprimet përgatitore, neni 27 - për caktimin e seancës gjyqësore), për gjykimin në apel (neni 48, pika 2 - për shqyrtimin e çështjes nga gjykata e apelit), si dhe për gjykimin në Gjykatën e Lartë (neni 60, pika 2).¹²

ii. Sjellja/interesi për kërkuesin dhe rreziku që sjell tejzgjatja e procedurave për të

Në lidhje me sjelljen e kërkuesit, ky kriter lidhet me mënyrën se si janë sjellë palët në proces ndaj procedimit. Diligjencën e treguar prej tyre për përfundimin e procesit, pengesat që ato kanë krijuar dhe faktorë të tjerë që janë të lidhur me veprimet ose mosveprimet e tyre që kanë ndikuar në ecurinë e procesit. Megjithatë, kjo duhet vlerësuar rast pas rasti, pasi një person nuk është i detyruar të bashkëpunojë me autoritetet proceduese në mënyrë aktive për të përshpejtuar procedurat gjyqësore që çojnë në dënimin e tij¹³.

Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj është shprehur se vlerësimi i sjelljes është një element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke analizuar rrethanat nëse kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nëse ai është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim¹⁴.

Sipas GjEDNj-së, sjellja e kërkuesve është faktor objektiv që duhet të merret parasysh për të vlerësuar nëse është tejkaluar koha e arsyeshme në kuadër të nenit 6, paragrafi I i Konventës¹⁵. Disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm gjykimi në procedurat vendase. Në këto raste duhet të merret parasysh çfarë vihet në pikëpyetje për kërkuesin. Kjo do të thotë se disa çështje që lidhen me interesa “vetjake e jetësore”, siç janë ato të kujdestarisë, marrëdhëniet e punës lipset të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë.¹⁶

iii. Kompleksiteti i çështjes

Në vlerësimin e kompleksitetit të çështjes, merren në konsideratë të gjithë faktorët dhe elementet që kanë të bëjnë me çështjen, natyrën e interesave të përfshira në të, rëndësinë e fakteve, rëndësinë e zgjidhjes ligjore, numri i personave të akuzuar dhe i dëshmitarëve,

12. Shih Vendimin nr.16, datë 16.03.2021; nr. 59, datë 16.09.2016 të Gjykatës Kushtetuese;

13. Shih vendimin e GjEDNj-së “*Eckkle kundër Republikës Federale Gjermane*”, datë 15.07.1982; Vendimin nr. 2/3/3/1, datë 17.01.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë;

14. Shih vendimin nr. 69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese;

15. Shih vendimin e GjEDNj-së “*Humen kundër Polonisë*” [GC], 15 tetor 1999, § 66.

16. Shih vendimin e GjEDNj-së “*Tsikakis k. Gjermanisë*”, 10 shkurt 2011, §§ 64 dhe 68; *Thlimmenos k. Greqisë* [GC], 6 prill 2000, §§ 60 dhe 62).

elementet ndërkombëtare, lidhja e çështjes me çështje të tjera dhe ndërhyrja e personave të tjerë në procedurë.¹⁷

Gjykata Kushtetuese ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin e saj, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme. Ajo ka theksuar, gjithashtu, se kompleksiteti i çështjes lidhet me një sërë faktorësh, siç janë natyra e fakteve dhe provave të çështjes, aspekte të ligjit ose ndërthurjes së ligjeve apo akteve, numri i palëve pjesëmarrëse në proces.¹⁸

iv. Sjellja e autoriteteve

Gjykata Kushtetuese ka theksuar gjithashtu se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme.¹⁹

Në vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të procedurave, Gjykata ka treguar një qasje më të kujdesshme për të, duke pasur parasysh ndryshimet që solli reforma në sistemin e drejtësisë në vendin tonë dhe efektet e saj, veçanërisht lidhur me plotësimin e numrit të gjyqtarëve në gjykata dhe numrin e madh të çështjeve në pritje për t'u shqyrtuar. Megjithatë, ajo ka vënë re se parashikimi i një reforme të kësaj natyre nuk mund të justifikojë vonesat, pasi shteti është i detyruar të organizojë hyrjen në fuqi dhe zbatimin e masave që shmangin tejzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve në pritje. Në këtë drejtim, akumulimi i përkohshëm i çështjeve nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi, me kusht që ky i fundit të ketë ndërmarrë veprime të menjëhershme që synojnë përmirësimin e situatës për të zgjidhur një situatë të këtij lloji. Pavarësisht se ka disa metoda që mund të zbatohen nga gjykatat për të nxitur përkohësisht përshtetimin e gjykimit të çështjeve, nëse edhe një zgjidhje e tillë rezulton në tejzgjatje dhe kthehet në një problem të organizimit strukturor, atëherë shteti duhet të sigurojë miratimin e masave më efektive dhe të organizojë sistemin gjyqësor, në mënyrë që të garantohet e drejta për të marrë një vendim përfundimtar brenda një periudhe të arsyeshme.²⁰

17. Shih Vendimin e GjEDNJ-së “*Trggiani kundër Italisë*”, datë 19.02.1991; Vendimin e GJEDNJ-së “*Manieri kundër Italisë*”, datë 27.02.1992, Vendimin e GjEDNJ-së “*Stefancic kundër Sllovenisë*”, datë 25.10.2012; Vendimin nr. 2/3/3/1, datë 17.01.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

18. Shih Vendimin nr. 16, datë 16.03.2021 të GJK-së; Vendimin nr. 22, datë 20.03.2017 të GJK; Vendimin nr.14, datë 10.03.2016 të GJK-së; Vendimin 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

19. Shih vendimin nr. 16, datë 16.03.2021 të GJK-së; Vendimin nr. 76, datë 04.12.2017 të GJK-së; Vendimin nr. 22, datë 20.03.2017 të GJK-së; Vendimin nr. 12, datë 05.03.2012 i Gjykatës Kushtetuese.

20. Vendimi nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka shqyrtuar një sërë ankesash nga shtetasit shqiptarë kundër Shqipërisë, për shkelje të afatit të arsyeshëm të zhvillimit të një procesi gjyqësor, duke pretenduar se nga tejkalimi i afateve palëve në proces u janë cenuar të dejtat dhe u janë shkaktuar dëme të konsiderueshme.

Në çështjen "*Gjonboçari e të tjerë kundër Shqipërisë*"²¹, GjEDNJ-ja, ka fajësuar shtetin Shqiptar për mosdhënien e një vendimi të formës së prerë dhe për kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore, duke deklaruar se ishte detyrë e gjykatave shqiptare të identifikonin procedurat gjyqësore të lidhura me këtë çështje dhe aty ku i gjykonin të nevojshme t'i bashkonin, t'i pezullonin ose të refuzonin hapjen e mëtejshme të procedurave të reja për të njëjtën çështje.

Një vendim i rëndësishëm i GjEDNJ-së kundër Shqipërisë, i cili pas analizës aktuale që ndodhet sistemi i drejtësisë në Shqipëri, ka vendosur që justifikimi i gjykatave se tezgjatja e afateve është shkaktuar për shkak të reformës në drejtësi dhe të numrit të lartë të çështjeve, është i pabazuar dhe përbën shkelje të parimit për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Shtetet kanë një detyrim të përgjithshëm që t'i organizojnë sistemet e tyre ligjore për të garantuar respektim të kushteve të parashikuara në nenin 6/1, duke përfshirë edhe një seancë të drejtë dëgjimore brenda një afati të arsyeshëm²².

4. Institucionet përgjegjëse për respektimin e afateve procedurale

Respektimi i afatit të arsyeshëm është një detyrë dhe përgjegjësi e të gjithë aktorëve, që prej momentit të paraqitjes së padisë deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Për zhvillimin e një shqyrtimi të shpejtë, të gjithë palët duhet të sillen me korrektesë, të kryejnë veprimet në afate sa më të shpejta, të shmangin zvarritjen e procesit, të jenë të kujdesshëm gjatë kryerjes së veprimeve etj.

4.1 Gjykata

Gjykata është organi që realizon dhënien e drejtësisë dhe kujdeset për zhvillimin e procesit në përputhje me standartet, kuadrin ligjor dhe në një afat sa më të shpejtë. Gjykata ka një rol të rëndësishëm në garantimin e respektimit të afateve, që nga momenti që paraqitet një padi ose kërkesë panë saj, gjykata duhet të marrë menjëherë masat për kryerjen e veprimeve si verifikimi nëse padia përmban të gjitha elementet, njoftimin e padisë palës së paditur dhe caktimin e një afati për depozitimin e mbrojtjes, caktimit të datave të seancave gjyqësore, organizimin e procesit për të shmangur shtyrjet (psh. nëse gjykata është në një trajnim, duhet të sigurohet që mos të lërë datën e gjyqit në atë ditë etj.). Gjykata duhet të respektojë afatet për shqyrtimin e kërkesave, padive brenda atij afati të përcaktuar në ligj (psh. kërkesa për masë sigurimi duhet të gjykohet brenda afatit 5 ditor).

Gjykata duhet të marrë masa ndaj subjekteve që për shkaqe apo arsye jo objektive, bëhen pengesë për zhvillimin e çështjeve brenda afatit të arsyeshëm dhe nuk repsketojnë afatet e caktuara për kryerjen e veprimeve etj.

21. Vendimi i GjEDNJ-së "*Gjon bocari etj. Kundër Shqipërisë*", aplikim nr.10508/02, datë 31.03.2008.

22. Shih Vendimi i GjEDNJ "*Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*", Kërkesa nr. 43391/18 dhe 17766/19.

4.2 Prokuroria

Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikqyr ekzekutimin e tyre, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja sipas rregullave të caktuara në këtë Kod. (Neni 24 KPP).

Në K.P. Penale, janë parashikuar afate brenda të cilit organi akuzës duhet të kryejë hetimet dhe të dërgojë çështjet në gjykim (shiko analizën në Modulën 2). Si një nga aktorët e rëndësishëm në hetimin e veprave penale dhe identifikimin e personave përgjegjës që kanë kryer veprën penale organi i akuzës duhet të marrë të gjitha masat për realizimin e hetimeve dhe veprimeve procedurale në një afat sa më të shpejtë, sidomos kur janë vendosur masa sigurimi si “*arrestimi në burg*” ose “*arrestimi në shtëpi*”.

4.3 Palët/Mbrojtësi ligjor

Palët dhe mbrojtësit e tyre ligjorë kanë detyrimin që të jenë të kujdesshëm, të tregojnë korrektësi, të respektojnë afatet dhe procesin gjyqësor.

Pala duhet të tregojnë kujdes në:

- Paraqitjen e padisë pa të meta dhe të shoqëruar me të gjitha provat në formën e kërkuar nga ligji;
- Ndërtimin e drejtë të ndërgjyqësisë;
- Paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes dhe provave në formën dhe brenda afatit të përcaktuar;
- Respektimi i afateve dhe i datave të përcaktuara nga gjykata (p.sh. minimizimi i kërkesave për shtyrje të seancave gjyqësore);
- Realizimi i të drejtave procedurale në afate sa më të shpejta (p.sh. afati për të bërë ankim është 15 ditë nga njoftimi i vendimit. Nëse ankimi do të paraqitet në ditën e pestë, do të përshpejtohet procedura. Nëse ankimi paraqitet me postë ditën e pesëmbëdhjetë, do të sillte vonesa në procedurë).

Për të normuar sjelljen e palëve dhe/ose mbrojtësve gjatë procesit gjyqësor dhe respektimit të afateve si mënyrë për të shmangur shtyrjet e paarsyeshme të gjykimit të çështjes, në nenin 107 të K.P. Civile dhe në nenin 350 të K.P. Penale, janë parashikuar sanksione që mund të merren nga Gjykata ndaj palëve, si për shembull gjobë nga 5 000 deri në 100 000 lekë dhe gjykata mund ta urdhërojë palën të paguajë shpenzimet e seancës (neni 350 K.P.P).

Në këtë modul do të analizojmë sjelljen e palëve gjatë procesit si një nga komponentët që përcakton nëse është respektuar “afati i arsyeshëm” apo jo.

4.4 Sekretaria gjyqësore/Punonjësit e gjykatës

Një rol të rëndësishëm në realizimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e afateve dhe urdhrave të gjykatës e ka sekretaria, nëpunësit dhe ftuesit e gjykatës.

a) *Disa nga detyrat e sekretarisë gjyqësore janë:*

- Regjistrimi i çështjeve;
- Formon fashikujt gjyqësorë, duke bërë pjesë dhe duke administruar sipas ligjit dokumente ose kopje të tyre të njehësuar/vlefshme;
- Përpilon komunikimet dhe njoftimet e parashikuara nga ligji ose nga gjykata;
- Lëshon kundrejt pagesës kopje të akteve të përpiluara, procesverbale, regjistrime audio ose audiovizive të seancave, transkripte të plota ose të pjesëshme të këtyre të fundit, si dhe ekstrakte autentike të akteve të përpiluara me shtypshkrim apo dorëshkrim.

b) *Disa nga detyrat e punonjësit të gjykatës/ftuesit gjyqësor janë:*

- Merr pjesë në seancë gjyqësore;
- Merr masa për zbatimin e urdhrave;
- Ndjek procedurën e njoftimit të akteve;
- Kryen detyra të tjera që lidhen me procesin gjyqësor.

Punonjësi i gjykatës është përgjegjës për kryerjen e rregullt të njoftimeve. Ai merr masa për realizimin e kërkimeve të nevojshme në lidhje me adresën e personit që i drejtohet njoftimi, duke verifikuar në regjistra publikë, në organet e administratës shtetërore, në familje apo te të afërmit, në vendqëndrimin ose vendbanimin e fundit të personit që i drejtohet njoftimi, ose nëpërmjet burimeve të tjera të mundshme. Kërkesat e punonjësit të gjykatës janë të detyrueshme për subjektet të cilave u drejtohen. Këta të fundit duhet të kthejnë përgjigje brenda afateve të caktuara në kërkesë. Për këto veprime, punonjësi i gjykatës harton një raport, të cilin ia paraqet gjykatës (neni 78 K.P.C).

Është shumë i rëndësishëm procesi i njoftimit të akteve, pasi ai është momenti nga ku fillojnë dhe efektet e afateve të përcaktuara në ligjin procedural. Për shembull, njoftimi i vendimit të arsyetuar duhet të bëhet sa më shpejt, pasi ndikon në llogaritjen e afatit të ankimit dhe depozitimit të tij nga pala ankuese. Ose mosnjoftimi i fletëthirrjes për datën dhe orën e seancës gjyqësore passjell shtyrjen e seancës, duke shkaktuar vonesa të paarsyeshme dhe të panevojshme.

Një nga shkaqet kryesore të shtyrjes së seancave gjyqësore është mungesa e njoftimeve ose njoftimi jo i rregullt i palëve ndërgjyqëse. Duhet të theksojmë që është shumë i rëndësishëm procesi i njoftimit të rregullt të seancës, akteve, pasi përbën shkak për cenim të procesit të rregullt ligjor dhe prishjen e vendimeve nga shkallët më të larta të gjykatave.

5. Organet monitoruese (KLGj, KLP, ILD)

Reformimi i sistemit të drejtësisë preku edhe institucionet që monitorojnë veprimtarinë e gjykatave, prokurorive në shqyrtimin e çështjeve dhe dhënien e drejtësisë. Kjo reformë ndërhyri në mënyrë gjithëpërfshirëse në sistemin gjyqësor, duke krijuar edhe një sërë organesh të reja të cilat ose zëvendësuan organet e mëparshme për administrimin e sistemit të drejtësisë, ose u krijuan rishtazi me detyra të reja, sikundër janë organet e vlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilat në tërësinë e tyre kanë në kompetencë miradministrimin e sistemit të drejtësisë në tërësi. Reforma gjithashtu pati ndikim edhe te ridimensionimi i juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, i cili u zgjerua në lidhje me mundësitë për ankimimin e individëve, për të garantuar efektivisht të drejtat dhe liritë themelore të tyre.²³

Institucionet që kanë në kompetencë monitorimim dhe mbikëqyrjen për administrimin e mirë të drejtësisë janë KLGj, KLP dhe ILD. Në ligjin nr.115/2016 janë parashikuar rregullat, parimet dhe kompetencat e këtyre organeve.

Kompetenca e KLGj-së për monitorimin dhe marrjen e masave për respektimin e afateve për shqyrtimin e çështjeve nga gjykatat parashikohet në nenin 94 të ligjit nr.115/2016. KLGj-ja miraton rregullat standarde për funksionimin e brendshëm të gjykatave dhe eficiencën e drejtësisë, konkretisht:

- Afate dhe/ose standarde kohore për gjykimin e llojeve të ndryshme të çështjeve gjyqësore, kur është e mundur, përfshirë edhe afatet për fazat kryesore të procedurës, për ekzekutimin e vendimeve, gjithmonë duke mbajtur parasysh organizimin gjyqësor dhe normat procedurale;
- Rregulla, standarde që do të përdoren nga gjykatat për përcaktimin e afateve kohore, duke mbajtur parasysh kompleksitetin e çështjeve, me qëllimin për të përmirësuar në vijimësi sistemin e menaxhimit të çështjeve;
- Veprimet, masat standarde që duhet të ndërmerren në rastet kur shqyrtimi i çështjeve i tejkalon afatet;
- Rregulla standarde për monitorimin e kohëzgjatjes së pezullimeve që vijnë si rezultat i mosveprimit nga palët ose gjykatat;
- Udhëzues për një rol aktiv të gjyqtarëve në menaxhimin e çështjeve;
- Udhëzues për monitorimin e shtyrjeve të seancave gjyqësore.

Mosrespektimi i rregullave dhe afateve nga ana e gjykatës, nëpunësve, stafit administrativ i ngarkon këto të fundit me përgjegjësi disiplinore (Ligji 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”).

23. Shih Mërkuri. E, “Organet e sistemit të drejtësisë”, Monitorimi i Zbatimit të Reformës në Drejtësi, Tiranë 2020, fq.1

6. Udhëzim i shkurtër në lidhje me përcaktimin e indikatorëve, mënyrës së realizimit të monitorimit, përdorimin e faqeve zyrtare, si dhe mbledhjen dhe analizimin e të dhënave

Monitorimi i respektimit të afatit të arsyeshëm nga gjykata mund të realizohet duke u bazuar në disa hapa:

Hapi 1 – Përzgjedhja e gjykatës dhe procesit që do të monitorohet

Për të realizuar një monitorim sa më të saktë dhe të detajuar, duhet të zgjidhni cilën shkallë të gjyqësorit do të monitoroni (gjykata të shkallës së parë, të apelit, Gjykatën e Lartë). Në kushtet kur aktualisht janë 12 gjykata të shkallës së parë, duhet të përcaktoni gjykatën e cilit rreth do të monitoroni. Mund të zgjidhni dhe dy apo tri gjykata duke bërë një shpërndarje gjeografike dhe të analizoni të dhënat në mënyrë krahasuese (p.sh. Gjykatën e Tiranës, Sarandës, Shkodrës etj.).

Duhet të zgjidhni llojin dhe natyrën e procesit që do të monitoroni (penal/civil/administrativ). Siç do të analizojmë dhe në vijim, të tria proceset paraqesin rregulla të ndryshme të zhvillimit të gjykimit, si rrjedhojë sugjerojmë që të zgjidhni për monitorimin e njërit prej proceseve.

Hapi 2 – Përcaktoni indikatorët dhe komponentët mbi të cilët do të shtrihet monitorimi, të cilët lidhen me objektivat dhe qëllimin që doni të realizoni

Në këtë Manual do të gjeni një sërë indikatorësh/tregues të detajuar për secilin modul që lidhen me respektimin e afatit të arsyeshëm, cilësinë dhe standardin e arsyetimit të një vendimi gjyqësor, ekzekutimin e vendimeve, të cilat mund t'i përdorni për realizimin e monitorimit, për hartimin e pyetësorëve, intervistave të strukturuar, analizimin e çështjeve konkrete etj.

Hapi 3 – Përcaktoni metodologjinë mbi të cilën do të bazohet monitorimi

Në varësi të indikatorëve që do të përzgjidhni për të monitoruar, do të përcaktoni dhe metodën që do të përdorni, metodën sasiore, cilësore, intervistat e strukturuar, sondazhet, përzgjedhja e disa çështjeve kampion dhe monitorimi drejtpërdrejt i tyre etj. Metodatat e mësipërme mund të kombinohen me qëllim përftimin e rezultateve sa më të plota e të sakta.

P.sh. Në rast se do t'ju duhet të bëni një krahasim midis dy gjykatave në lidhje me respektimin e afatit të arsyeshëm në çështjet penale p.sh. midis Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, do t'ju duhet të orientoheni drejt metodave sasiore. Nëse do të merrni në analizë afatet e shqyrtimit të çështjeve penale të cilat gjykohen sipas procedurës së ritit të gjykimit të zakonshëm, do t'ju duhet të orientoheni drejtë indikatorëve cilësorë.

Hapi 4 - Burimet e informacionit

Pasi të keni përcaktuar metodën dhe metodologjinë e përfitimit të të dhënave, duhet të përcaktoni burimet e marrjes së tyre. Në këto raste mund t'ju vijnë në ndihmë raporte dhe statistika zyrtare të publikuara nga organet kompetente, si p.sh. Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Këshilli i Lartë Gjyqësor, raporte të publikuara nga organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, jursiprudenca e GjEDNj-së, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë etj. Disa nga uebsajtet që mund të përfitoni të dhëna për të monitoruar komponentë të ndryshëm të procesit të rregullt ligjor janë pasqyruar në pikën 4.3 të këtij moduli.

Të dhënat mund të mblidhen nga:

- a) Raportet/statistikat vjetore të gjykatave (shiko shembullin më lart). Faqet zyrtare ku mund t'i gjeni të dhënat:
 - <https://www.gjykata.gov.al/>
 - <https://www.gjykatatirana.gov.al/media/pssdbk2c/analizavjetore2021.pdf>
 - <http://www.gjykataelarte.gov.al/>
 - Raportet vjetore/statistikat e Prokurorisë së Përgjithshme/Prokurorive të Rretheve
 - https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PROKURORIT_T_P_RGJITHSH_M/
- b) Raportet vjetore të Ministrisë së Drejtësisë - <https://www.drejtesia.gov.al/statistika>;
- c) Pyetësorë/Intervista të strukturuar/Sondazhe;
- d) Analiza e vendimeve gjyqësore konkrete.

Shembull:

Nëse do të analizohen afatet dhe kohëzgjatja e hetimeve paraprake, të dhënat mund të mblidhen nga raportet vjetore të Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorive pranë Gjykatave të Juridiksionit të Përgjithshëm, Raporti vjetor i Ministrisë së Drejtësisë, mund të organizohen intervista të strukturuar për gjyqtarët, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore, avokatët, avokatët e caktuar kryesisht ose mund të merren në analizë një numër çështjes konkrete. Në këtë rast sugjerohet që të hartohet një formular i shkurtër, me indikatorët që kërkohen të identifikohen (p.sh.mund të përzgjidhen 50 çështje të hetuara për vitin 2021-2023, duke e shtrirë monitorimin në çështje që lidhen me krime, kundërvajtje dhe të analizohen në mënyrë cilësore të dhënat si p.sh.: Kur është regjistruar çështja, kur kanë përfunduar hetimet, a ka pasur kërkesa për shtyrje hetimesh, cili është lloji i veprës penale (krim/kundërvajtje), a ka pasur ankime kundër vendimeve për shtyrjen e hetimeve, cili janë shkaqet e shtyrjes etj.)

Hapi 5 - Mbledhja dhe analizimi i të dhënave

Mbledhja dhe analizimi i të dhënave është një element i rëndësishëm, pasi në bazë të tyre do të nxirret një konkluzion dhe do të hartohen rekomandimet.

Më poshtë po analizojmë me anë të një shembulli se si mund të përdorni faqet e uebit të gjykatave për të marrë të dhëna të rëndësishme në lidhje me respektimin e afatit të arsyeshëm.

Shembull:

Nëse do të monitoroni respektimin e afatit të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, për t'u dhënë përgjigje dy indikatorëve: *A është gjykuar çështja brenda afatit 30-ditor? A ka përfunduar gjykimi brenda afatit 1-vjeçar?* - mund të veproni si më poshtë:

a) Pasi të klikojmë në linkun <https://www.gjykata.gov.al/>, do të shfaqet tabela e mëposhtme. Në rubrikën “Gjykatat shqiptare”, në njërën nga nënrubrikat që shfaqet kur e klikojmë, zgjedhim ikonën “Gjykatat administrative” e më pas zgjedhim gjykatën që po monitorojmë, në këtë rast “Gjykata Administrative e Apelit”.



b) Klikojmë në nënrubrikën “Gjykata Administrative e Apelit” dhe do të shfaqet faqja e gjykatës. Në faqe do të na shfaqen disa rubrika dhe në varësi të indikatorit që kërkojmë të monitorojmë (i përcaktuar në Hapin 2) do të klikojmë një nga rubrikat. Për të përfunduar të dhëna për afatin e shqyrtimit të çështjeve për vitin 2022 dhe nëse kanë përfunduar gjykimet brenda vitit 2022 (afati 1-vjeçar) klikojmë në rubrikën “Informacion mbi shortin”.

Përcaktojmë datën “01.01.2022” deri “31.12.2022” te kuadratët përkatës dhe klikojmë në butonin “View report” në krahun e djathtë të faqes dhe do të na shfaqet lista e çështjeve të regjistruara për vitin 2022.

GJKATA ADMINISTRATIVE E APELIT
REPUBLIKA E SHQIPËRIË

Sistemi i drejtësisë | Gjykatat shqiptare | Statistika | Përshytyje | Na kontaktoni

Informacion mbi shortin

Nga Data: 1/1/2022 12:00:00 AM Deri ne: 12/31/2022 12:00:00 AM

1 of 27 Find | Next

Informacion mbi shortin nga data: 1/1/2022 deri ne daten 12/31/2022

Nr. ceshtjes	Tipi i shortit	Gjyqtari	Titulli i ceshtjes	Palet
31157-00335-86-2018	Rshortim		Tjere [Padites] Kundër: [I Paditur]	

Listën e çështjeve të shortuara për vitin 2022 mund ta shkarkoni në formatin excel në ikonën e ilustruar më poshtë:

GJKATA ADMINISTRATIVE E APELIT
REPUBLIKA E SHQIPËRIË

Sistemi i drejtësisë | Gjykatat shqiptare | Statistika | Përshytyje | Na kontaktoni

Informacion mbi shortin

Nga Data: 1/1/2022 12:00:00 AM Deri ne: 12/31/2022 12:00:00 AM

1 of 27 Find | Next

Informacion mbi shortin nga data: 1/1/2022 deri ne daten 12/31/2022

Nr. ceshtjes	Tipi i shortit	Gjyqtari	Titulli i ceshtjes	Palet
31157-00335-86-2018	Rshortim	Enol Rozha	Tjere [Padites] Kundër: [I Paditur]	

Në anën e majtë të tabelës është regjistruar nr. i çështjes, të cilën do ta kopjoni dhe do ta vendosni te tabela që do ju shfaqet pasi të shtypni ikonën “çështje administrative” në të majtën e tabelës.

GJKATA ADMINISTRATIVE E APELIT
REPUBLIKA E SHQIPËRIË

Sistemi i drejtësisë | Gjykatat shqiptare | Statistika | Përshytyje | Na kontaktoni

Gjykata

31157-00335-86-2018

31157-00335-86-2018

Numeri	Numeri i aktit	Regjistri	Emri i gjyqtarit	Palet	Data e regjistrimit	Numeri i vendimit	Data e vendimit	Veprimi
30000...	1422	Kërkesa Civile		*****	26.06.2023			Dat
30000...	1425	Kërkesa Civile		*****	26.06.2023			Dat
30000...	1423	Kërkesa Civile		*****	26.06.2023			Dat

c) Pasi të vendosni nr. e çështjes siç është ilustruar më lart dhe të klikoni në ikonën “Kërko” do ju shfaqet tabela e mëposhtme:

The screenshot shows a web application interface for the 'GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT REPUBLIKA E SHQIPËRISË'. A modal window titled 'Çështja: 31154-01708-86-2019' is open, displaying the 'Informacion mbi çështjen' (Case Information) section. The form contains the following fields and values:

- Kodi anonimizimit:** [Empty field]
- Vendosni kodin e anonimizimit për të shikuar informacionin e pa anonimizuar:** [Empty field]
- Titulli:** [Empty field]
- Numri i çështjes:** 31154-01708-86-2019
- Numri i aktit:** 12751
- Date e rregjistrimit:** 06-05-2019
- Regjistrimi:** Civile Themel
- Tipi i çështjes:** Shfuqzim akti administrativ
- Lloji i fillimit:** Gjykim fillestar
- Kategoria:** Shfuqzim akti administrativ
- Statusi:** Mbyllur
- Objekti i padisë:** -Shfuqzimi i aktit administrativ "Vendim Përfundimtar nr. 16, date 01.10.2018", me nr. 1599/10 prot i pales se paditur Autoriteti i Avlacioit Civil, si i regjerr ne kundërshtim me ligjin. -Detyrimi i pales se paditur te riktheje paditesin Konstantin Sterjopullo ne vendin e meparshem te punes ose ne nje vend ekuivalent me te. -Detyrimin e pales se

A 'Mbyll' button is located at the bottom right of the modal window.

The screenshot shows the same web application interface, but the modal window now displays the 'Vendimi përfundimtar' (Final Decision) section for the same case. The form contains the following fields and values:

- Kodi anonimizimit:** [Empty field]
- Vendosni kodin e anonimizimit për të shikuar informacionin e pa anonimizuar:** [Empty field]
- Numri i vendimit:** 86-2022-324
- Data e vendimit:** 14/06/2022
- Tipi:** Lënien në fuqi të Vendimit
- Gjyqtari:** Blerona Hasa
- Përmbledhje:**
 - Vendos:** VENDOS*****
 - Ø Lënien ne fuqi te Vendimit Nr.396 (415), Dt.11.02.2019 te Gjykatës Administrative te Shkallës se Pare Tirane.
 - Ø Shoënzimet zhyvësore ne Gjykatën e Apelit Administrativ nuk u kryen dhe as nuk u pretenduan.
- Konkluzioni:**
 - GJYKATA E APELIT*****ADM*****STRAT*****V
 - referuar akteve bashkëngjitur dosjes Nr.396 (415) Dt.11.02.2019, sqarimeve te paleve ndergjegjëse dhe akteve te dorëzuara rishitas prej tyre:
 - VEREN**

A 'Mbyll' button is located at the bottom right of the modal window.

Në të majtën e tabelës jepen të dhënat mbi çështjen, si data e regjistrimit të çështjes, objekti i çështjes, palët (mund të verifikoni numrin e paditësave, të të paditurve, nëse ka persona të tretë) dhe data e vendimit.

Shembull: Nga analiza e të dhënave të pasqyrurara në tabelë konstatojmë që çështja është regjistruar në datën 06.05.2019 dhe vendimi është marrë në datë 14.06.2022, pra pas 3 vitesh. Siç do të analizojmë dhe më poshtë, konkludojmë që në këtë rast është shkelur afati i arsyeshëm për shqyrtimin e çështjes. Nga analizimi i të gjitha çështjeve të regjistruara dhe të gjykuara për vitin 2022, mund të japim një të dhënë sasiore si për shembull në 60% të çështjeve nuk është respektuar afati nga Gjykata Administrative e Apelit Administrativ. Ose mund të nxjerrim të dhëna cilësore p.sh. marrim disa çështje të cilat janë në pritje të gjykimit prej më shumë se 3 vitesh dhe në kuadër të të dhënave të publikuara dhe informacioneve zyrtare që mund të përftojme mund të nxjerrim cilat janë shkaqet e vonesës, roli i aktorëve, kompleksiteti i çështjes etj.

MODULI 2

ZHVILLIMI I GJYKIMIT BREND A NJË AFATI TË ARSYESHËM NË PROCESIN PENAL

1. Hyrje

Parimet, rregullat dhe afatet për zhvillimin e një procesi penal nga momenti i hetimit deri në fazën e ekzekutimit parashikohen në Kodin e Procedurës Penale. Ky kod është miratuar në vitin 1995 dhe i është nënshtruar ndryshimeve të herëpashershme, por reformimi rrënjësor iu bë në mars të vitit 2017, ndryshime të cilat hynë në fuqi në gusht të vitit 2017.

Në analizën e sistemit të drejtësisë u konstatuan disa problematika në lidhje me respektimin e parimit të procesit të rregullt ligjor në procesin penal dhe efikasitetit të gjyqësorisë, faktorë që ndikuan dhe në ndërmarrjen e disa ndryshimeve thelbësore.²⁴

Në K.Pr.Penale nuk është parashikuar në mënyrë të shprehur parimi i procesit të rregullt ligjor dhe i gjyqësorisë brenda afatit të arsyeshëm, por nga analiza e dispozitave dhe afateve të parashikuara brenda të cilave duhet të zhvillohen veprimet procedurale hetimore, gjyqësore, afatet e shpalljes dhe arsyetimit të vendimit, konkludojmë që qëllimi i ligjvënësisë është gjykimi i çështjes brenda një afati të shpejtë dhe të arsyeshëm.

Një nga parimet që përshkon Kodin është zhvillimi i gjyqësorisë të pandërprerë, i parashikuar në nenin 342 të K.Pr.Penale: *“1. Kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të përfundojë në një seancë të vetme, gjykata vendos që të vazhdojë ditën e mëpasme të punës. 2. Gjykata mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor, vetëm për arsye të veçanta, deri në pesëmbëdhjetë ditë”*.

Referuar dispozitës së mësipërme është parashikuar që çështja penale të përfundojë në një seancë të vetme dhe vetëm në raste të veçanta mund të shtyhet deri në një afat 15-ditor. Nëse i referohemi praktikës së gjykatave konkludojmë që ky parim nuk respektohet, përkundrazi gjykatat e interpretojnë në mënyrë të kundërt dispozitën, ku në parim i vendosin seancat në një afat 15-ditor dhe vetëm në raste përjashtimore çështja mund të përfundojë me një seancë të vetme.

24. Shih Relacionin për ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale, aksesuar në linkun: <https://www.aksesdrejtesi.al/dokumenta/1597827373RELACION-SHTESA-E-NDRYSHIME-7905-KODI-I-PROCEDURES-PENALE-Resized.pdf>

2. Zbatimi i afateve procedurale gjatë hetimeve paraprake

Hetimet paraprake është faza procedurale që zhvillohet nga organi i akuzës për verifikimin dhe mbledhjen e provave për vërtetimin e kryerjes së një vepre penale, me qëllim vendosjen përpara përgjegjësisë penale të autorit që e ka kryer veprën.

Në Kodin e Procedurës Penale janë parashikuar disa afate strikte për kryerjen e hetimeve, mosrespektimi i të cilëve sjell papërdorshmërinë e provave. Pra, nëse prokuroria mbledh prova pas afatit të parashikuar në ligj, këto prova nuk mund të përdoren për dënimin e personit që ka kryer veprën penale, edhe nëse këto prova janë shumë të rëndësishme.

Në parim afati për kryerjen e hetimeve paraprake (neni 323 K.Pr. Penale) është:

- a) 3 muaj për të gjithë veprat penale (vrasja, plagosja e rëndë, vjedhja etj); ky afat nuk zbatohet për veprat penale të parashikuara në pikën b);
- b) 6 muaj për krimet e parashikuara në nenin 75 pika a dhe b të K.Pr. Penale²⁵ (p.sh. vepra me qëllime terroriste; korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë, ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike etj.)

Në rast se organi i akuzës nuk arrin të mbyllë hetimet brenda afateve të mësipërme, mund të kërkojë zgjatjen e afateve të hetimeve. Për veprat penale të parashikuara në pikën a) të sipërcituar, afati i zgjatjes është 3 muaj, ndërsa për veprat penale të parashikuara në pikën b) është 6 muaj.

Në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur, afati mund të shkojë deri në 2 vite. Në rastet e akuzave për krim të organizuar dhe për krime të rënda, afati i hetimit mund të zgjatet vetëm me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm ose Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme deri në 1 vit. Zgjatja e afateve të hetimit nuk mund të cenojë afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit (neni 324 i K.Pr. Penale).

3. Zbatimi i afateve procedurale gjatë zhvillimit të gjykimit në shkallë të parë

3.1 Afatet procedurale për shqyrtimin dhe caktimin e masave të sigurimit personal

Çdo person i arrestuar ose i ndaluar, në kushtet e parashikuara në nenin 5, të KEDNj-së, ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në pritje të gjykimit (Neni 5/3) të KEDNj-së).

GjEDNj në një sërë vendimesh ka konsoliduar qëndrimin në lidhje me respektimin e afatit të arsyeshëm në rastet kur shqyrtohen masat e sigurimit personal. Shprehja "*brenda një*

25. Neni 233, 234, 234/a, 234/b, 244, paragrafi 2, 244/a, 245, 245/1, paragrafët 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 328 dhe 328/b të Kodit Penal; çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;

afati të shkurtër” nuk mund të përkufizohet në mënyrë abstrakte. Gjithashtu për kërkesën për *“afat të arsyeshëm”* që figuron në nenet 5 § 3 dhe 6 § 1, nevojitet të bëhet një vlerësim në dritën e rrethanave të çështjes. Për të verifikuar nëse është respektuar kërkesa për afat të shkurtër mund të merren në konsideratë disa elemente të krahasueshme me ato që luajnë rol në shqyrtimin e kërkesës për proces brenda një afati të arsyeshëm, për shembull shpejtësia e treguar nga autoritetet, zvarritjet e shkaktuara nga i ndaluari, si edhe çdo lloj elementi tjetër që ka sjellë një vonesë e që nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi (*Mooren k. Gjermanisë [DhM], § 106; Kolompar k. Belgjikës, § 42*). Sa herë që luhet me lirinë e një individi, Gjykata zbaton kritere shumë të rrepta për të përcaktuar nëse shteti, ashtu siç e ka për detyrim, ka marrë vendim brenda një afati të shkurtër rreth ligjshmërisë së ndalimit (*shih, për shembull, Kadem k. Maltës, §§ 44-45*), ku Gjykata e ka gjykuar si të tepruar një afat prej shtatëmbëdhjetë ditësh të përdorur për të marrë vendim rreth ligjshmërisë së ndalimit të paditësit dhe *Mamedova k. Rusisë, § 96*, ku afatet e shqyrtimit në apel ndër të tjera, prej njëzet e gjashtë ditësh, janë gjykuar në kundërshtim me kërkesën për *“shpejtësi”*).²⁶

Në Kodin e Procedurës Penale janë vendosur afate strikte për vleftësimin e masës së sigurimit, ndryshimin, revokimin, ankimin ndaj masës së sigurimit, mosrespektimi i të cilëve sjell humbjen e fuqisë së masës së sigurimit.

Në Kod janë parashikuar dy procedura për caktimin e masave të sigurimit:

1. *Kur personi ndalohet ose arrestohet në flagrancë*

Në këtë rast ndaj personit nuk është marrë ende një vendim për kufizimin e lirisë, por ndalimi ose arrestimi i personit ka ardhur për shkak se ai është kapur duke kryer veprën penale (p.sh. gjatë patrullimit të zonës, policia arreston në flagrancë shtetasin A pasi u konstatua që po vidhte magazinën e shtetasit B).

Brenda 48 orëve nga momenti i ndalimit ose arrestimit në flagrancë të një personi, organi i akuzës duhet të dërgojë në gjykatë kërkesën për vleftësimin e ndalimit ose arrestimit dhe caktimit të masës së sigurisë. Nëse nuk respektohet ky afat, personi duhet të lirohet menjëherë (Neni 258 K.Pr.P). Gjykata brenda 48 orëve nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykatë duhet të shpallë vendimin, në të kundërt personi duhet të lirohet menjëherë (Neni 259/5 K.Pr.P).

2. *Organi i akuzës kërkon vendosjen e masës së sigurimit ndaj një personi, pasi dyshohet se ka kryer një vepër penale*

Gjatë hetimeve, prokuroria mund të konstatojë që personi që dyshohet se ka kryer veprën penale, mund të largohet nga vendi, mund të prishë provat, mund të kryejë një vepër tjetër penale, si rrjedhojë kërkon në gjykatë vendosjen e masës së sigurimit *“arresti në burg”*.

26. Shih Udhëzues rreth nenit 5 të Konventës, *“E drejta për lirinë dhe sigurinë personale”*, Këshilli i Evropës/Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2014, fq.35.

Në rast se gjykata vendos masën e arrestit në burg ose në shtëpi, jo më vonë se 3 ditë nga zbatimi i masës, gjykata e merr në pyetje personin për të cilin ka vendosur masën. Për masat e tjera të sigurimit, shtrënguese ose ndaluese (p.sh. detyrim paraqitje, ndalimi për t'u larguar jashtë vendit etj.), gjykata procedon me marrjen në pyetje brenda 5 ditëve nga zbatimi i masës (Neni 248 i K.Pr.P).

Kundër vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit, mospranimin ose rrëzimin e saj, lejohet ankim brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit të gjykatës. Gjithashtu, kundër vendimit të gjykatës për vazhdimin, revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit, prokurori, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të bëjnë ankim brenda 5 ditëve. Ankimi shqyrtohet brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e akteve. Gjkata vendos, sipas rastit shfuqizimin, ndryshimin ose miratimin e vendimit edhe për arsye të ndryshme nga ato që janë parashtruar ose nga ato që tregohen në pjesën arsyetuese të vendimit. Gjkata depoziton vendimin e arsyetuar brenda 10 ditëve (neni 249 K.P.P).

Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit, shqyrtohet nga gjykata ku ndodhen aktet brenda 5 ditëve nga depozitimi i saj. (Neni 260/4 K.P.P)

Në praktikë konstatohet që afatet e sipërcituara respektohen nga ana e prokurorisë dhe gjykatës, por problematikat lidhen me tejzgjatjen e afateve të masave të sigurimit (kohës së qëndrimit në paraburgim) të parashikuara në ligj deri në shqyrtimin e themelit të çështjes, pra dhënies së një vendimi përfundimtar nga gjykata. Masa e sigurimit ka për qëllim kufizimin e lirisë së një personi për qëllime të drejtësisë, por kjo masë nuk mund të qëndrojë në fuqi për një afat të papërcaktuar. Në nenin 263 të K.P.Penale parashikohen afate për kohëzgjatjen e paraburgimit, përfundimi i të cilave sjell automatikisht lirimin e personit edhe nëse ende nuk është shqyrtuar çështja në themel.

3.2 Afatet procedurale gjatë zhvillimit të seancës paraprake

Seanca e veprimeve paraprake, si një fazë e ndërmjetme midis hetimeve paraprake dhe gjykimit të çështjes në themel, është parashikuar në Kodin e Procedurës Penale në ndryshimet që pësoi ky kod në vitin 2017. Ky ndryshim erdhi si rezultat i reformimit të sistemit dhe problematikave që u konstatuan, pasi veprimet e kryera nga prokurori në përfundim të hetimeve mbeteshin të pakontrolluara, duke marrë në konsideratë këtu edhe decentralizimin e institucionit të prokurorisë dhe pavarësinë totale të prokurorit mbi çështjen. Për të rregulluar këtë situatë, është parë e domosdoshme përfshirja në kod e figurës së gjyqtarit të seancës paraprake, i cili është gjyqtari që do të kontrollojë veprimet dhe vendimmarrjen e prokurorit mbi fatin e çështjes.²⁷

Prokurori pasi përfundon hetimet sipas afateve të analizuara në pikën 2, përgatit kërkesën

27. Shih Relacionin për projekt ndryshimet për Kodin e Procedurës Penale, aksesuar në linkun: <https://www.aksedrejttesi.al/dokumenta/1597827373RELACION-SHTESA-E-NDRYSHIME-7905-KODI-I-PROCEDURES-PENALE-Resized.pdf>

për dërgimin e çështjes në gjykim ose për pushimin e saj, e cila shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake.

Në nenin 332 të K.Pr. Penale janë parashikuar disa afate procedurale të kryerjes së veprimeve nga gjyqtari i seancës paraprake dhe afati maksimal brenda të cilit duhet të përfundojë shqyrtimi i kërkesës.

Sa më sipër brenda 5 ditëve nga depozitimi i kërkesës për dërgimin e çështjes në gjykim ose për pushimin e saj, gjyqtari i seancës paraprake cakton datën e zhvillimit të saj. Nga data e depozitimit të kërkesës, deri në datën e seancës nuk duhet të kalojë një afat më i gjatë se 10 ditë.

Gjyqtari i seancës paraprake duhet të shqyrtojë dhe të marrë vendim mbi këtë lloj kërkesë brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të saj. Vendimi depozitohet në sekretari brenda 10 ditëve nga shpallja e tij.

3.3 Afatet procedurale për zhvillimin e seancës gjyqësore

Ndonëse seanca paraprake është caktuar si një seancë për kontrollimin dhe verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga prokurori gjatë hetimeve paraprake, kjo seancë mund të kthehet dhe në një seancë gjykimi në themel të çështjes dhe dhënies së vendimit përfundimtar për deklarimin fajtor ose të pafajshëm të personit. (Neni 332/dh K.P.P)

Gjyqtari i seancës paraprake mund të vijojë me gjykimin në themel të çështjes kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit ose në rastin e pranimit të kërkesës për zhvillimin e gjykimit me ritin e shkurtuar. Në rastin e zhvillimit të gjykimit të shkurtuar palët kanë të drejtë të kërkojnë një afat për t'u përgatitur, jo më të gjatë se 15 ditë. Në këtë rast duke marrë në analizë afatet e sipërcituara dhe afatin maksimal që mund të kërkojnë palët, një çështje penale me gjykim të shkurtuar mund të mbyllet brenda 45 ditëve.

Në raste të tjera, kur gjyqtari i seancës së veprimeve paraprake vendos dërgimin e çështjes në gjyq, vendimi së bashku me fashikullin e gjykimit dhe me aktet e masave të sigurimit, depozitohen pa vonesë në sekretarinë e gjykatës kompetente dhe në çdo rast jo më vonë se 10 ditë.

Brenda 10 ditëve nga depozitimi i kërkesës së prokurorit ose të viktimës akuzuese, kryetari i trupit gjykues, i ngarkuar për gjykimin e çështjes cakton datën e seancës gjyqësore. Data e seancës i njoftohet prokurorit, të pandehurit, mbrojtësit, viktimës, palëve private dhe përfaqësuesve të tyre të paktën dhjetë ditë para datës së caktuar për gjykim (neni 333 të K.P. P).

Në Kod nuk është parashikuar një afat specifik brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi në shkallë të parë, megjithëse duke iu referuar afateve të shpejta procedurale për caktimin e seancës (10 ditë nga depozitimi i kërkesës) dhe parimit të vijimit të gjykimit në mënyrë të pandërprerë, gjykimet penale duhet të shqyrtohen në afate shumë të shpejta dhe të arsyeshme.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes gjykata shpall vendimin e arsyetuar. Kur vendimi shpallet i përmbledhur, gjykata e arsyeton në mënyrë të plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Ky afat mund të zgjatet për një periudhë tjetër 30-ditore nëse çështja është gjykuar në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në rastet kur ndaj personit të dënuar është vendosur masë sigurimi personal “arresti në shtëpi” ose “arresti në burg” vendimi arsyetohet brenda 15 ditëve nga data në të cilën është shpallur ose brenda 30 ditëve kur është gjykuar nga Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (Neni 382 K.P.P).

Kodi ka parashikuar zgjatjen e afateve të sipërcituara për shkaqe të përligjura, pa specifikuar cilat janë këto shkaqe. Ndonëse janë parashikuar afate për arsyetimin e plotë të vendimit, në praktikë ndodh që shpallet dispozitivi, ndërsa arsyetimi i vendimit tejkalon afatet e sipërcituara, duke cenuar dhe të drejtat e personave në proces.

3.4 Afatet procedurale për zhvillimin e gjykimeve të posaçme

Prej vitit 1995, vit në të cilin ka hyrë në fuqi Kodi i Procedurës Penale, njiheshin dy forma procedimi të posaçme, të cilat bënë përjashtim nga gjykimi i zakonshëm, siç është gjykimi i drejtpërdrejtë dhe gjykimi i shkurtuar. Në kuadër të reformimit të sistemit të drejtësisë në Shqipëri, gjatë analizës që iu bë sistemit të drejtësisë,²⁸ u konstatua se gjykimi i shkurtuar zbatohet pa asnjë kufizim për të gjithë kategoritë e veprave penale dhe për të gjithë autorët, ndërsa gjykimi i drejtpërdrejtë është zbatuar më pak.

Lehtësimi i procedurave gjyqësore, është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me rekomandimet e Këshillit të Evropës²⁹, të cilat parashikojnë se procedurat penale duhet të lehtësohen kur kemi të bëjmë me vepra penale jo shumë të rrezikshme, me qëllim pasjen e një sistemi drejtësie efikas dhe brenda një afati të shkurtër.

Me ndryshimet që iu bënë K.P. Penale, përveç gjykimit të shkurtuar dhe gjykimit të drejtpërdrejtë, u shtuan dhe dy lloje të reja të gjykimeve të posaçme, gjykimi me marrëveshje dhe urdhri penal, të cilat do të analizohen në vijim.

3.4.1 Gjykimi i shkurtuar

Gjykimi i shkurtuar është një gjykim i posaçëm, i cili kërkohet për t’u aplikuar nga vetë i pandehuri ose përfaqësuesi i tij kur ky tagër është dhënë me prokurë të posaçme, duke pranuar zhvillimin e gjykimit mbi gjendjen që janë provat, pra duke hequr dorë nga e drejta për të sjellë prova të reja, për të kundërshtuar për shembull vlefshmërinë e aktit të ekspertimit, papërdorshmërinë e provave etj.

28. Shih “*Analiza e Sistemit të Drejtësisë*”, hartuar nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Qershor 2015, fq 149; Terihati.F, Kurti.A “*Risitë dhe sfidat e përfshirjes së llojeve të reja të gjykimeve të posaçme në Kodin e Procedurës Penale*”, Interantional Scientific Conference, Universiteti i Tiranës, 7 Dhjetor 2017.

29. Shih Rekomandimi nr. (87)18E i Komitetit të Ministrave pranë Këshillit të Evropës, 1987 “*Në lidhje me lehtësimin e procedurave në sistemin e drejtësisë penale*”.

Gjykimi i shkurtuar rregullohet nga neni 403 deri në nenin 406 të K.Pr.Penale. Si rregull, kërkesa për gjykim të shkurtuar paraqitet gjatë seancës së veprimeve paraprake dhe është gjyqtari i seancës paraprake që vendos pranimin ose rrëzimin e saj. Nëse pranohet kërkesa, është gjyqtari i seancës paraprake që do të gjykojë dhe themelin e çështjes, në rastet kur maksimumi i dënimit të veprës penale është deri në 10 vjet. Kur i pandehuri akuzohet për kryerjen e një vepre penale për të cilën parashikohet dënim me burgim në maksimum mbi 10 vjet, gjykata cakton datën e seancës dhe njofton kryetarin për të kryer plotësimin e trupit gjykues sipas ligjit (shiko pikën 3.2 të këtij moduli).

Duke iu referuar afateve të parashikuara në nenin 332 dhe 332/c, gjykimi mund të përfundojë brenda afatit 45-ditor. Në rast se aplikohet gjykimi i shkurtuar, gjykata kur jep vendimin e ul dënimit me burgim ose me gjobë me 1/3 (neni 406 të K.Pr.Penale).

3.4.2 Gjykimi i drejtpërdrejtë

Një tjetër gjykim i posaçëm është gjykimi i drejtpërdrejtë, i cili zbatohet kur i pandehuri është arrestuar në flagrancë dhe hetohet për kryerjen e një vepre penale që gjykohet nga një gjyqtar. Kur prokurori çmon se nuk ka nevojë për hetime të mëtejshme, paraqet brenda 48 orëve nga arrestimi kërkesën për gjykim të drejtpërdrejtë, së bashku me kërkesën për vleftësimin e arrestimit (neni 400 K.P.P.).

Në qoftë se arrestimi vleftësohet i ligjshëm dhe nuk ka nevojë për hetime të tjera, procedohet menjëherë me gjykim, ndërsa kur ai nuk gjendet i bazuar aktet e kthehen prokurorit. Por edhe në rastin e fundit, kur i pandehuri dhe prokurori japin pëlqimin gjykata procedon në gjykimin e drejtpërdrejtë.

Kur i pandehuri është arrestuar në flagrancë dhe ai vleftësohet i ligjshëm, si dhe kur gjykata vendos njëri nga masat e sigurimit “arresti në shtëpi”, “arresti në burg” ose “shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik”, prokurori paraqet në gjykatë kërkesën për gjykimin e drejtpërdrejtë, jo më vonë se tridhjetë ditë nga data e arrestimit, me përjashtim të rastit kur duhet të kryhen hetime të mëtejshme (neni 400/3 K.P.P.).

Ndryshe nga gjykimi i shkurtuar, i cili ka të plotë procedurën e hetimeve, por shqyrtimi gjyqësor është i kufizuar (vetëm mbi gjendjen që janë provat e sjella nga prokuroria gjatë fazës së hetimeve paraprake), në rastin e gjykimit të drejtpërdrejtë faza procedurale e hetimeve paraprake është e suprimuar dhe “hetimi” zhvillohet gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në Kod nuk është parashikuar një afat brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i drejtpërdrejtë.

3.4.3 Gjykimi me marrëveshje

Gjykimi me marrëveshje zhvillohet mbi bazën e një marrëveshjeje që lidhet midis organit të akuzës dhe të pandeurit. Në mënyrë që marrëveshja të jetë e vlefshme, duhet të përmbushen kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

- Vullneti dhe pëlqimi i të pandehurit;
- Vepra penale për të cilën akuzohet personi dënohet në maksimum jo më shumë se 7 vjet burgim.

Marrëveshja duhet të përmbajë elementet e përcaktuara në pikën 3 të nenit 406, konkretisht:

- Përshkrimi i qartë i faktit penal, për të cilin akuzohet i pandehuri;*
- Cilësimi juridik i faktit;*
- Deklarimi i pohimit të fajësisë nga ana e të pandehurit;*
- Lloji dhe masa e dënimit penal kryesor, dënimit plotësues;*
- Mënyra e ekzekutimit të tyre, për të cilat palët kanë rënë dakord;*
- Disponimet për provat materiale dhe sendet që i përkasin veprës penale, si dhe për konfiskimin e mjeteve e produkteve të veprës penale, sipas nenit 36 të Kodit Penal;*
- Në rastin kur është legjitimuar paditësi civil, pëlqimin e tij me shkrim për masën e shpërblimit të dëmit nga i pandehuri;*
- Shuma e shpenzimeve procedurale;*
- Nënshkrimet e palëve dhe të mbrojtësit.*

Marrëveshja duhet të lidhet përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Nga çasti i regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor, prokurori, i pandehuri, ose përfaqësuesi i tij i posaçëm mund të propozojnë arritjen e një marrëveshjeje mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes nga i pandehuri, avokati dhe prokurori, ky i fundit e dërgon atë për miratim në gjykatë, së bashku me të gjitha aktet e hetimeve paraprake.

Marrëveshja mund të paraqitet:

- *Në seancë paraprake* - në këtë rast marrëveshja miratohet nga gjyqtari i seancës paraprake. Referuar afateve të parashikuara për zhvillimin e seancës paraprake vlerësojmë që shqyrtimi i marrëveshjes duhet të përfundojë brenda 30 ditëve;
- *Në seancë gjyqësore* - Gjykata e shqyrton kërkesën në seancë gjyqësore brenda tridhjetë ditëve nga paraqitja e saj.

Në përfundim të hetimit gjykata vendos miratimin e marrëveshjes ose refuzimin e saj. Në rastet kur vendoset refuzimi, gjykata vendos në eventualitet pushimin e çështjes ose kthimin e akteve prokurorisë për hetime të mëtejshme (neni 406/ë K.P.C).

3.4.4 Urdhri penal

Një tjetër procedurë e posaçme, që shmang gjykimin e zakonshëm, është gjykimi nëpërmjet urdhrit penal të dënimit. Parashikimi i këtij lloj gjykimi ka për qëllim³⁰:

1. *Ekonominë gjyqësore, nëpërmjet shkurtimit të shpenzimeve gjyqësore;*
2. *Uljen e ngarkesës në punë të gjykatave dhe prokurorive, që lidhet me veprat penale të një rrezikshmërie të ulët;*
3. *Uljen e numrit të të burgosurve në burgjet shqiptare.*

Urdhri penal i dënimit³¹, është një procedurë që i lë një hapësirë shumë të madhe prokurorit, i cili vepron si një organ “quazi gjyqësor”, pasi ka të drejtën të “vendosë” nxjerrjen e urdhrit penal, kur konstaton përmbushjen e kushteve dhe kriterëve për nxjerrjen e tij.

Kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen për zbatimin e procedurës, për nxjerrjen e urdhrit penal janë:³²

1. *Për vepra penale që përbëjnë kundërvajtje penale;*
2. *Kur prokurori mbi aktet që ka në dosje, krijon bindjen që dënimi që duhet të jepet është me gjobë dhe jo burg;*
3. *Urdhri penal duhet të nxirret brenda 3 muajve nga regjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale.*

Në përfundim të hetimeve, kërkesa për miratimin e urdhrit penal depozitohet në sekretarinë e gjykatës, së bashku me të gjitha aktet e fashikullit të hetimeve paraprake (Neni 406/a). Gjykata e shqyrton kërkesën pa praninë e palëve dhe vendos brenda dhjetë ditëve nga depozitimi i saj (neni 406/b).

Nëse u referohemi afateve të mësipërme, në rastin e një kundërvajtjeje penale, nëse prokurori operon me urdhër penal, çështja mbyllet nga faza e hetimeve deri në shkallë të parë brenda një afati 100 ditë.³³

Kur kushtet dhe kriteret janë përmbushur, gjykata vendos miratimin e urdhrit penal, ose kthimin e akteve për hetime të mëtejshme kur konstaton se nuk janë përmbushur kriteret për dhënien e urdhrit penal.

30. Shih “Analiza e Sistemit të Drejtësisë”, hartuar nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Qershor 2015, fq.35; Terihati.F, Kurti.A “Risitë dhe sfidat e përfshirjes së llojeve të reja të gjykimeve të posaçme në Kodin e Procedurës Penale”, Interantional Scientific Conference, Universiteti i Tiranës, 7 Dhjetor 2017.

31. Shi nenet 406/a deri në nenin 406/ç të Kodit të Procedurës penale.

32. Terihati.F, Kurti.A “Risitë dhe sfidat e përfshirjes së llojeve të reja të gjykimeve të posaçme në Kodin e Procedurës Penale”, Interantional Scientific Conference, Universiteti i Tiranës, 7 Dhjetor 2017.

33. Po aty.

4. Zbatimi i afateve procedurale gjatë gjykimit në apel

Ndaj vendimeve të gjykatës së shkallës së parë, pala mund të ushtrojë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit, të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Ndaj vendimeve të ndërmjetme ose jopërfundimtare (pushimi i çështjes, vendimi për caktimin e masës së sigurimit personal) afati i ankimit është 5 ditë, ndërsa afati ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës (deklarim fajtor; i pafajshëm) është 15 ditë. Afati fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar (neni 415 i K.Pr.P). Pala që nuk ka bërë ankim mund të bëjë apel kundërshtues brenda afatit 5-ditor nga data e njoftimit të ankimit të palës tjetër (neni 423 të K.Pr. P).

Pas regjistrimit të çështjes në apel, çështja hidhet në short për caktimin e gjyqtarit relator. Gjyqtari relator cakton datën dhe orën e gjykimit në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën sipas kohës së regjistrimit të dosjes në gjykatën e apelit.

Çështjet që lidhen me ekstradimet për jashtë shtetit, çështjet në të cilat i pandehuri është i paraburgosur dhe çështjet për të cilat Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë, shqyrtohen me përparësi. Për shqyrtimin e çështjes në themel apel nuk është përcaktuar një afat procedural, brenda të cilit duhet të përfundoj shqyrtimi i çështjes.

Ndërsa për gjykimin e ankimeve ndaj vendimeve jopërfundimtare ose të ndërmjetme janë parashikuar afate p.sh. ankimet ndaj masave të sigurimit duhet të gjykohen brenda 10 ditëve, ankimet kundër vendimit për zgjatjen e hetimeve (neni 249, neni 325 K.P.P), brenda 15 ditëve ankimi kundër pushimit të çështjes (neni 329 /7 K.P.P) etj.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqsor në seancë gjyqësore ose në seancë këshillimore gjykata shpall vendimin, që nënkupton leximin e dispozitivit ose çfarë ka vendosur gjykata psh. lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë etj.

Kodi ka parashikuar një afat 30-ditor për arsyetimin e vendimit nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit Përgjithshëm Tiranë dhe 60-ditor për Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ky afat mund të zgjatet nga gjykata në rrethana të caktuara (neni 430/1 K.Pr. P).

Ndonëse janë parashikuar afate brenda të të cilave duhet të bëhet arsyetimi i vendimeve, në praktikë rezulton që ka vendime të cilat arsyetohen tej afatit të mësipërm, shpeshherë duke cenuar dhe të drejtat e palëve.

5. Zbatimi i afateve procedurale gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë

Ndaj vendimit të apelit mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda 45 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të gjykatës së apelit. Pala kundër së cilës është paraqitur rekurs mund ta kundërshtojë atë me kundërrekurs brenda 20 ditëve nga dita kur ka marrë njoftimin për rekursin e palës tjetër. Në rastin kur rekursi është paraqitur kundër një vendimi të gjykatës së apelit me të cilin është vendosur prishja e vendimit dhe kthimi i akteve gjykatës së shkallës së parë, afati për paraqitjen e kundërrekursit është 10 ditë (Neni 435/ 435/a të K.Pr. P).

Afati për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Lartë është jo më vonë se dy muaj nga momenti i regjistrimit të saj në sekretarinë gjyqësore. Siç e konstatojmë në nenin 435 të K.P. Penale është parashikuar një afat brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi në këtë shkallë të sistemit gjyqësor.

Pas mbarimit të seancës gjyqësore, gjykata merr vendimin. Në rastet kur çështja është e ndërlikuar ose ka një rëndësi të veçantë, shpallja e vendimit mund të caktohet dhe në një ditë tjetër.

Vendimi mund të shpallet i plotë ose i përmbledhur, duke treguar shkaqet kryesore mbi të cilat bazohet vendimi. Në rastet kur vendimi shpallet i përmbledhur, vendimi arsyetohet brenda 60 ditëve nga shpallja e tij. Ky afat mund të zgjatet për një periudhë tjetër 30-ditore nëse çështja është gjykuar nga Kolegjet e Bashkuara. Në raste përjashtimore, për shkaqe të përligjura afati për arsyetimin e vendimit mund të zgjatet. Në Kod nuk është parashikuar një afat maksimal i zgjatjes, duke lënë në diskrecion të gjyqtarëve zgjatjen e afateve (neni 448/1 K.P.P).

6. Indikatorët për monitorimin e respektimit të afatit të arsyeshëm në një proces penal

Me qëllim monitorimin e respektimit të afatit të arsyeshëm në proceset penale, monitorimi duhet të orientohet drejt indikatorëve cilësorë dhe sasiorë. Disa nga indikatorët mund të jenë:

	Treguesit e realizimit/indikatorët	Po/Jo
Hetimet paraprake/masat e sigurimit		
	A janë realizuar hetimet paraprake brenda afatit 3-mujor?	
	A janë realizuar hetimet paraprake nga SPAK brenda afatit 6-mujor?	
	A janë realizuar hetimet paraprake për çështjet komplekse brenda afatit 2 vjeçar +1 vjeçar?	
	A është kërkuar nga prokurori vleftësimi i masës në gjykatë brenda 48 orëve nga arrestimi në flagrancë ose ndalimi i të dyshuarit për një krim?	
	A është zhvilluar seanca gjyqësore për vleftësimin e ndalimit/arrestit brenda 48 orëve nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykatë?	

	A është marrë në pyetje nga gjykata personi për të cilin ka vendosur masën e arrestit në burg ose në shtëpi, jo më vonë se 3 ditë nga zbatimi i masës?	
	A është marrë në pyetje nga gjykata personi për të cilin është vendosur një nga masat e tjera të sigurimit, jo më vonë se 5 ditë nga zbatimi i saj?	
	A është shqyrtuar nga gjykata e apelit ankimi kundër vendimit që cakton masën e sigurimit brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e akteve?	
	A është shqyrtuar kërkesa e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjykim brenda afatit 30-ditor?	
Gjykimi në shkallë të parë		
	A ka pasur kërkesa për shtyrje të seancave nga gjykata ose nga palët ndërgjyqëse?	
	A janë marrë masa nga gjykata në rast të shtyrjes së seancave nga palët pa shkak të arsyeshëm/objektiv?	
	A ka pasur shtyrje të seancave për shkak të problematikave/ apo mosnjoftimit të rregullt të palëve?	
	A është shqyrtuar gjykimi i shkurtuar brenda afatit 30-ditor nga momenti i pranimit të kërkesës?	
	A është shqyrtuar verifikimi i Marrëveshjes brenda 30 ditëve nga momenti i depozitimit në gjykatë?	
	A është shqyrtuar miratimi i Urdhrit Penal brenda 10 ditëve nga depozitimi i kërkesës?	
	A ka përfunduar gjykimi i krimeve brenda afatit 2-vjeçar?	
	A ka përfunduar gjykimi i kundravajtjeve brenda afatit 1-vjeçar?	
	A është arsyetuar vendimi brenda afatit 30-ditor nga gj.shk.1?	
	A është arsyetuar vendimi nga GjKKO brenda afatit 60-ditor?	
	A është arsyetuar vendimi brenda afatit 15-ditor nga gj.shk.1 në rastet kur i pandehuri është me masë sigurimi “arresti në burg” ose “arresti në shtëpi”?	
	A është arsyetuar vendimi brenda afatit 30-ditor nga GjKKO në rastet kur i pandehuri është me masë sigurimi “arresti në burg” ose “arresti në shtëpi”?	

	A janë marrë masa për të siguruar një shpërndarje të drejtë dhe efikase të ngarkesës ndërmjet gjyqtarëve (d.m.th. monitorimi i ecurisë së proceseve gjyqësore, shpërndarja e drejtë e numrit të çështjeve që i janë caktuar secilit gjyqtar, pjesëmarrja e gjyqtarëve në aktivitete të tjera, etj.) ?	
	A i është njoftuar vendimi i arsyetuar palëve në afate të shpejta nga administrata gjyqësore?	
	A është depozituar çështja në apel brenda afateve të shpejta?	
Gjykimi në apel		
	A është shpallur vendimi i arsyetuar menjëherë pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e apelit?	
	Nëse shpallja e vendimit të arsyetuar të vendimit nuk është bërë menjëherë pas përfundimit të procesit, a është shpallur vendimi i arsyetuar brenda afatit 30-ditor nga gjykata e apelit?	
	A kanë paraqitur palët kërkesë për përshpejtimin e gjykimit?	
	A kanë paraqitur palët dokumentacion shkresor për të provuar shkakun e pretenduar për përshpejtimin e gjykimit?	
	A është shqyrtuar kërkesa e palës për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes nga gjyqtari relator, jo më vonë se 30 ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës?	
	A ka qenë gjykata përpara rasteve të parashikuara në ligj për të vendosur përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes?	
	A është shqyrtuar ankimi brenda afatit të përcaktuar në vendimin i cili ka pranuar kërkesën për përshpejtimin e gjykimit të çështjes?	
	A janë ndërmarrë inspektime nga ILD lidhur me moszbatimin nga gjykatat të kalendarit për gjykimin e çështjeve sipas radhës së regjistrimit?	
	A janë marrë masa për të siguruar një shpërndarje të drejtë dhe efikase të ngarkesës ndërmjet gjyqtarëve (d.m.th. monitorimi i ecurisë së proceseve gjyqësore, shpërndarja e drejtë e numrit të çështjeve që i janë caktuar secilit gjyqtar, pjesëmarrja e gjyqtarëve në aktivitete të tjera, etj.)?	
Gjykimi në Gj.Lartë		
	A është shqyrtuar çështja në Gjykatën e Lartë brenda 2 muajve nga momenti i regjistrimit të çështjes në gjykatë?	

	Nëse zbardhja e vendimit të arsyetuar nuk është bërë menjëherë pas përfundimit të procesit, a është shpallur vendimi i arsyetuar brenda afatit 60-ditor nga Gjykata e Lartë?	
	A kanë paraqitur palët kërkesë për përsheptimin e gjykimit?	
	A kanë paraqitur palët dokumentacion shkresor për të provuar shkakun e pretenduar për përsheptimin e gjykimit?	
	A e ka shqyrtuar Gjykata e Lartë kërkesën për përsheptimin e gjykimit dhe a ka marrë një vendim për të?	
	A është shqyrtuar kërkesa e palës për përsheptimin e shqyrtimit të çështjes nga gjyqtari relator, jo më vonë se 30 ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës?	
	A ka qenë gjykata përpara rasteve të parashikuara në ligj për të vendosur përsheptimin e shqyrtimit të çështjes?	
	A është shqyrtuar rekursi brenda afatit të përcaktuar në vendimin i cili ka pranuar kërkesën për përsheptimin e gjykimit të çështjes?	
	A janë ndërmarrë inspektime nga ILD lidhur me moszbatimin nga gjykatat të kalendarit për gjykimin e çështjeve sipas radhës së regjistrimit?	
	A janë marrë masa për të siguruar një shpërndarje të drejtë dhe efikase të ngarkesës ndërmjet gjyqtarëve (d.m.th. monitorimi i ecurisë së proceseve gjyqësore, shpërndarja e drejtë e numrit të çështjeve që i janë caktuar secilit gjyqtar, pjesëmarrja e gjyqtarëve në aktivitete të tjera, etj.)?	

<i>Treguesit e realizimit/indikatorët</i>	Përqindje (%)/Shifër
Sa % e çështjeve të regjistruara për vitin X organi i akuzës e ka përfunduar hetimin brenda afatit 3-mujor?	
Në sa % të çështjeve organi i akuzës ka kërkuar shtyrjen e hetimeve?	
Në sa % të çështjeve hetimi ka zgjatur për një afat 2-vjeçar?	
Sa % e çështjeve janë shqyrtuar me gjykim të shkurtuar?	
Cila është mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit të çështjeve me gjykim të shkurtuar në gjykatën e shkallës së parë?	

Sa % e çështjeve janë shqyrtuar me marrëveshje?	
Cila është mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit të çështjeve me marrëveshje në gjykatën e shkallës së parë?	
Sa % e çështjeve janë shqyrtuar me miratimin e urdhrit penal?	
Cila është mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit të çështjeve me miratim të urdhrit penal në gjykatën e shkallës së parë?	
Sa % e vendimeve shpallen të arsyetuara menjëherë sapo përfundon shqyrtimi gjyqësor?	
Sa % e vendimeve shpallen të arsyetuara brenda afatit 30-ditor nga gjykata e apelit?	
Sa % e vendimeve shpallen të arsyetuara brenda afatit 60-ditor nga GjKKO?	
Cila është mesatarja e kohëzgjatjes së shqyrtimit të çështjeve në shk. të I për vitin X?	
Cila është mesatarja e kohëzgjatjes së shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit për vitin X?	
Sa % e çështjeve ka përfunduar brenda afatit 2-mujor në Gjykatën e Lartë për vitin X?	
Cila është mesatarja e kohëzgjatjes së shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë për vitin X?	
Sa është niveli i kënaqësisë së palëve lidhur me afatet për përfundimin e hetimeve paraprake?	
Sa është niveli i kënaqësisë së palëve lidhur me afatet për përfundimin e gjykimit në shkallë të parë?	
Sa është niveli i kënaqësisë së palëve lidhur me afatet për shqyrtimin e ankimeve/rekurseve në gjykatat e apelit dhe Gjykatën e Lartë?	
Sa është niveli i kënaqësisë së palëve lidhur me afatet për shpalljen e arsyetuar të vendimeve të gjykatave?	

MODULI 3

ZHVILLIMI I GJYKIMIT BREND A NJË AFATI TË ARSYESHËM NË PROCESIN CIVIL

1. Hyrje

Reformimi i sistemit të drejtësisë dhe ndryshimet thelbësore që pësuan aktet më të rëndësishme që rregullojnë zhvillimin e një procesi gjyqësor, sollën një sërë dinamikash, duke ndikuar në cenimin e procesit të rregullt ligjor, në mënyrë të veçantë në cenimin e parimit të zhvillimit të një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. GjEDNj është shprehur se u përket shteteve palë që të organizojnë sistemet e tyre ligjore në një mënyrë të tillë që gjykatat të mund të garantonin të drejtën e çdokujt dhe brenda afatit të arsyeshëm, të kishte një vendim përfundimtar në lidhje me mosmarrëveshje mbi të drejta dhe detyrime me karakter civil.³⁴

Me qëllim zhvillimin e një procesi brenda një afati të arsyeshëm, u reformua procedura e zhvillimit të një procesi gjyqësor civil, ku për herë të parë u parashikua zhvillimi i procedurës së posaçme në rastin e padive me vlerë të vogël, por që për shkak të situatës së krijuar ende nuk janë parë efektet pozitive të këtyre ndryshimeve.

Në K.P.Civile parashikohet detyrimi i gjykatës për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor (neni 14) dhe marrjen e vendimeve për të gjitha kërkesat që parashtrohen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm (neni 28).

Në K.P.Civile nuk janë parashikuar afate specifike brenda të cilave duhet të zhvillohet gjykimi i një çështjeje, por janë parashikuar parimet kryesore mbi të cilat shtrihet një proces i rregullt ligjor, afatet procedurale për kryerjen e veprimeve, të cilat nëse zbatohen në mënyrë rigoroze nga gjykata, palët dhe përfaqësuesit e tyre, procesi mund të zhvillohet brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme.

2. Zbatimi i afateve procedurale gjatë zhvillimit të gjykimit në shkallë të parë

2.1 Gjykimi i masave të sigurimit

Masa e sigurimit është një mjet i posaçëm me anë të të cilës mund të garantohet një mbrojtje e përkohshme e të drejtës që pretendohet që është cenuar. Sigurimi i padisë si institut juridik procedural nënkupton një vlerësim paraprak dhe sipërfaqësor të fakteve të çështjes

34. Shih Bianku. Ledi “*Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut*”; Çështja Rajak vs. Kroacisë, kërkesa nr.49706/99 Tiranë 2005, fq 343.

nga gjykata, e cila nëse krijon bindjen se, ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit të themelit do të shkaktonte një dëm të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin e të drejtat e tij, dhe njëkohësisht nuk duhet të cenohet rëndë interesi publik, lejon marrjen e saj. Ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në shkresa, për mundësinë e shkakut të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin dhe mungesa e cenimit të interesit publik janë kushte kumulative, të cilat përlligjin nevojën për marrjen e masës së sigurimit të padisë.³⁵

Nëse njëra nga palët ndërgjyqëse (kryesisht paditësi) paraqet përpara gjykatës një kërkesë për marrjen e masës së sigurimit të padisë, gjykata duhet të marrë një vendim me efekt të përkohshëm, nëse është urgjentisht e nevojshme në mënyrë që të parandalohen dëme të rënda, apo për çfarëdo arsye tjetër që është thelbësore në funksion të së mirës publike. Në këtë rast gjykatës i nevojitet të vendosë në një balancë pasojat që mund të vijnë nëse masa e kërkuar nuk merret prej saj dhe në përfundim do të rezultojë se ankimi është i suksesshëm, përkundrajt dëmeve që do të ndodhin në rastin kur masa e përkohshme do të merrej, por në përfundim të gjykimit kërkesa do të rrëzohej. Një vendim gjyqësor për marrjen e masës së përkohshme jepet në atë rast kur, pa dhënien e një vendimi të tillë, ekziston një rrezik i drejtpërdrejtë që i tërë procesi i shqyrtimit të çështjes, do të bëhej i pakuptimtë ose, për më tepër, absurd.³⁶

Nëse pala paraqet kërkesë për marrjen e masës së sigurimit, kërkesa duhet të shqyrtohet brenda një afati 5-ditor (neni 202 K.P.C). Kërkesa, si rregull, shqyrtohet në prani të palëve, por në raste të veçanta ose të ngutshme, mund të shqyrtohet edhe në dhomë këshillimi (205 prg.2 K.P.C).

Sigurimi i padisë mund të kërkohet edhe përpara ngritjes së padisë në gjykatën e vendit ku ka banimin paditësi ose ku ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia. Në këtë rast gjykata cakton një afat jo më shumë se pesëmbëdhjetë ditë, brenda të cilit duhet të paraqitet padia në gjykatë. (Neni 204 K.P.C).

2.2 Gjykimi zakonshëm

Në nenin 158/a të K.P.Civile parashikohet procedura që nga momenti që një çështje regjistrohët në gjykatë, shortimi i çështjes dhe veprimet paraprake që kryhen nga gjyqtari, i cili është caktuar për shqyrtimin e çështjes. Pas marrjes së dosjes gjyqtari bën verifikimin nëse padia përmbush të gjitha elementet dhe kushtet e parashikuara në ligj, në të kundërt njofton palën për të plotësuar të metat. Nëse padia është e plotë, gjykata duhet t'ia njoftojë padinë dhe provat palës së paditur dhe personit të tretë nëse ka, duke i vendosur një afat brenda të cilit kjo palë duhet të bëjë deklaratën e mbrojtjes.

Afati maskimal për depozitimin e deklaratës së mbrojtjes nga pala e paditur është 30 ditë. Ky afat fillon në momentin që i njoftohet padia palës së paditur, ose personave të tretë.

35. Vendim i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr.52/2020.

36. Vendimi nr.1177, datë 02.07.2021 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

Para hyrjes në fuqi të ndryshimeve, për një proces gjyqësor zhvillohen një sërë seancash përgatitore në praninë e palëve. Me procedurën e re, në parim gjithçka zhvillohet në bazë të shkresave dhe shqyrtohet në dhomë këshillimi nga gjykata, e cila pasi bindet që dosja gjyqësore është e plotë dhe palët nuk kanë kërkesa paraprake dhe prova të tjera, cakton zhvillimin e seancës gjyqësore, ku zhvillohet dhe debati gjyqësor. Parashikimi i kësaj procedure ka për qëllim eliminimin e seancave gjyqësore joproduktive dhe gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm.³⁷

Ndonëse këto ndryshime kanë hyrë në fuqi në nëntor të vitit 2017, për shkak të mungesës së dijënisë dhe mosnjohjes në mënyrë të plotë të procedurës së re nga palët, gjykatat ende po zhvillojnë një procedurë mikse dhe nuk janë strikte ndaj procedurës së përcaktuar, pasi zhvillohen një sërë seancash përgatitore, duke u dhënë mundësi palëve që të sjellin prova ose të bëjnë kërkesa para caktimit të seancës gjyqësore, faktorë që ndikojnë në zgjatjen e afateve dhe procedurave për zhvillimin e gjykimin.

Pasi të jenë shqyrtuar të gjitha provat që gjykata ka pranuar të administrohen, pyeten palët nëse kanë kërkesa të tjera në dobi të gjykimin të çështjes dhe në rast se ato nuk pranohen, gjykata i jep fund hetimit gjyqësor dhe fton palët të parashitrojnë pretendimet përfundimtare të tyre rreth çështjes në gjykim. Si rregull, ato i parashitrohen gjykatës me shkrim. Me kërkesën e palëve, kur kjo shihet me vend, gjykata u jep atyre një afat deri në 5 ditë, për të përgatitur parashtrimet përfundimtare (Neni 302 K.Pr.C).

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes dhe pas depozitimit të parashtrimeve përfundimtare nga palët ndërgjyqëse, gjykata shpall vendimin. Gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se njëzet ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në 20 ditë. Arsyetimi i vendimit bëhet nga kryetari i seancës, përveç kur ai del në pakicë (neni 308 K.Pr.C).

2.3 Gjykimi i posaçëm

Për të lehtësuar procedurat gjyqësore dhe zhvillimin e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, krahas procedurës të zhvillimit të gjykimin të zakonshëm, në K. Pr. Civile u parashikua dhe një procedurë e posaçme, për gjykimin e çështjeve civile dhe tregtare me objekt deri në 150 000 lekë.³⁸

Aplikimi i një procedure të veçantë në rastet e çështjeve me vlerë të vogël zbatohet në disa vende të Bashkimit Evropian. Madje BE-ja e ngriti në një standard për të gjitha shtetet anëtare aplikimin e një procedure të veçantë nëpërmjet miratimit të Rregullores (KE) nr. 861/2007³⁹.

Konkretisht në Rregulloren (KE) parashikohet se⁴⁰: *“Shumë Shtete Anëtare kanë parashikuar procedura civile të thjeshta për kërkesa të vogla që nga shpenzimet, vonesat dhe kompleksitete lidhur me proceset gjyqësore jo domosdoshmërisht ulen proporcionalisht me vlerën e kërkesës.*

37. Raporti: *“Studim dhe Monitorim i Gjykatës së Rrethit Tropojë”*, përgatitur nga Qendra Integrim dhe Zhvillim Demokratik”, Viti 2019.

38. Shih *“Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”*, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Qershor 2015, fq.88. dhe Relacionin *“Projektligjin për Kodin e Procedurës Civile”*, aksesuar në:

<http://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/RELACION-KODI-PROCEDURAVE-CIVILE-1.pdf>

39. Shih Rregulloren (KE) nr. 861/2007 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 11 Korrik 2007.

40. Po aty, paragrafi 7.

Pengesat për të bërë një gjykim të shpejtë dhe të lirë janë përkeqësuar në rastet ndërkuftare. Prandaj është e domosdoshme të krijohet një procedurë evropiane për kërkesat e vogla (Procedura Evropiane për Kërkesat e Vogla). Qëllimi i një procedure të tillë duhet të jetë për të lehtësuar qasjen në drejtësi. Shtrembërimi i konkurrencës në tregun e brendshëm për shkak të pabarazive në lidhje me funksionimin e procedurës, mjeteve të ndryshme që u ofrohen kreditorëve në Shtetet Anëtare, nënkuptojnë nevojën e një legjislacioni të Komunitetit që garanton një fushë loje të barabartë për kreditorët dhe debitorët në të gjithë Bashkimin Evropian. Duhet të mbahen parasysh parimet e thjeshtësisë, shpejtësisë dhe proporcionaliteti kur përcaktohet shqyrtimi i çështjes sipas Procedurës Evropiane për Kërkesa të Vogla. Është e përshtatshme që të bëhen publike detajet e kostove, si dhe mënyra për caktimin e këtyre kostove duhet të jenë transparent”.

Referuar nenit 162/a të K.Pr. Civile gjykimi i shkurtuar zbatohet kur plotësohen dy kushte:

7. *Padia me vlerë deri në 150 000 lekë;*
8. *Detyrimi duhet të rrjedhë nga marrëdhënie kontraktore.*

Nga një interpretim “*a contrario*” i dispozitës, nuk mund të bëhet gjykim i shkurtuar në rastet kur një detyrim rrjedh nga një marrëdhënie jokontraktore, p.sh. begatimi pa shkak, shpërblimi i dëmit jashtëkontraktor, detyrimi për ushqim etj. Në këto raste, pavarësisht vlerës së padisë, gjykimi do të zhvillohet sipas procedurës së zakonshme.⁴¹

Gjykimi i shkurtuar në parim zhvillohet në dhomë këshillimi nga gjykata, që do të thotë që gjykata shqyrton çështjen mbi pretendimet me shkrim të palëve ndërgjyqëse. Megjithëse gjykata ka diskrecionin për të zhvilluar dhe seancë gjyqësore, në të cilën fton palët për të shpjeguar pretendimet dhe prapësimet. Kodi nuk ka parashikuar rastet kur mund të zhvillohet seanca dëgjimore në gjykimin e shkurtuar, duke e lënë gjykimin rast pas rasti, në varësi të bindjes që krijon gjykata, psh. disa nga rastet kur gjykata mund të zhvillojë seancë gjyqësore kur provat nuk janë bindëse, gjykata ka nevojë të sqarohet më shumë, pretendimet janë kontradiktore etj.

3. Gjykimi i kërkesave për konstataimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit

Në pikën 4 të Modullit 1 analizuam afatet e përcaktuara në nenin 399 të K.Pr. Civile, të cilat konkretizojnë afatet tavan brenda të cilave duhet të zhvillohen gjykimet penale, civile, administrative në secilën shkallë gjykimi.

Nga neneni 399/1-399/12, parashikohet procedura dhe mjetet për të kërkuar konstataimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimin të çështjes, si dhe të drejtën për të kërkuar dëmshpërblimin e dëmit të shkaktuar.

41. Shih “*Risitë dhe sfidat e ndryshimeve në Kodin e Procedurës Civile në lidhje me gjykimin e çështjeve me vlerë të vogël*”, Konferenca Shkencore Kombëtare, Universiteti i Tiranës, 23 Nëntor 2018

3.1 Procedura dhe mjetet për të kërkuar konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit të çështjes

i. Kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave i drejtohet gjykatës kompetente, si më poshtë:

1. Gjykata e shkallës së parë:

- Në rastet kur *çështja*, në të cilën pretendohet të ketë shkelje, *është* në fazën e hetimeve;
- Në rastet kur *çështja*, në të cilën pretendohet të ketë shkelje, *është* në procedurë ekzekutimi pranë gjykatës kompetente për ekzekutimin.

2. Gjykata e Apelit Juridiksioni i Përgjithshëm/Administrative:

- Në rastet kur *çështja*, në të cilën pretendohet të ketë shkelje, *është* në gjykim në shkallë të parë (civile/penale) - kërkesa i drejtohet GjAJP-së;
- Në rastet kur *çështja* administrative, në të cilën pretendohet të ketë shkelje, *është* në gjykim në gjykatën administrative të shkallës së parë - kërkesa i drejtohet GjAA-së.

3. Gjykata e Lartë:

- Në rastet kur *çështja* civile, në të cilën pretendohet të ketë shkelje, *është* në gjykim në gjykatën e apelit - kërkesa i drejtohet KCGjL-së;
- Në rastet kur *çështja* penale, në të cilën pretendohet të ketë shkelje, *është* në gjykim në gjykatën e apelit - kërkesa i drejtohet KPGjL-së;
- Në rastet kur *çështja* administrative, në të cilën pretendohet të ketë shkelje, *është* në gjykim në gjykatën e apelit - kërkesa i drejtohet KAGjL-së;
- Në rastet kur *çështja* në të cilën pretendohet të ketë shkelje, *është* në gjykim në gjykatën e lartë - kërkesa shqyrtohet nga një kolegji tjetër. P.sh. nëse afati pretendohet se *është* cenuar nga KAGjL, kërkesa shqyrtohet nga KCGjL.

ii. Kërkesa depozitohet në sekretarinë e gjykatës dhe duhet të përmbajë:

- a) *palët ndërgjyqëse;*
- b) *organin që pretendohet se ka kryer shkeljen: prokuroria, gjykata, palët që pengojnë ekzekutimin;*
- c) *objektin e mosmarrëveshjes ose të ekzekutimit;*
- d) *paraqitjen e përmbledhur të fakteve të çështjes;*
- e) *shkaqet për të cilat kërkohet konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave;*
- f) *masat që kërkohen të merren.*

iii. Kërkesës duhet t'i bashkangjiten disa prova:

- a) *aktet me të cilat provohet tejkalimi i afatit të arsyeshëm;*
- b) *procesverbale dhe vendime të ndërmjetme;*
- c) *aktet e praktikës përmbartimore, sipas rastit;*
- ç) *prokura, nëse kërkesa është bërë nga avokati ose nga përfaqësuesi i ankuesit.*

iv. Gjykimi i kërkesës:

Brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës, organi që pretendohet se ka kryer shkeljen, i dërgon kopje të dosjes dhe mendimin me shkrim, gjykatës që shqyrton kërkesën. Gjykimi i kërkesës bëhet në dhomë këshillimi dhe gjykata që shqyrton çështjen merr vendim brenda 45 ditëve, nga paraqitja e kërkesës.

Në nenin 399/7 të K.Pr.C parashikohet se në rast se gjatë shqyrtimit të kërkesës organi që po kryen veprimet, ndërmerr hapat që po kërkohen nga pala, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, pushon shqyrtimin e kërkesës.

3.2 Procedura dhe gjykimi i padisë për shpërblimin e dëmit për cenim të afatit të arsyeshëm

Kur ka një vendim të formës së prerë për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurës, subjekti kërkues mund të paraqesë padi për shpërblimin e dëmit. Kërkesëpadia i drejtohet gjykatës civile të shkallës së parë kompetente, sipas rregullave të përgjithshme, vetëm pasi procedura e konstatimit të shkeljes dhe përshpejtimin të procedurës është ezauruar dhe nuk është ekzekutuar nga organi që ka kryer shkeljen. Të paditur në gjykim thirren Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave, ose shërbimi përmbartimor privat përgjegjës.

Gjykimi i kërkesëpadiisë bëhet sipas rregullave të zakonshme të gjykimit brenda një afati 3-mujor nga depozitimi i kërkesëpadiisë.

Në përfundim të shqyrtimit, gjykata vendos shpërblimin e dëmit nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë, për çdo vit, ose muaj në raport me vitin, përtej afatit të arsyeshëm. Në caktimin e shpërblimit gjykata mban parasysh:

- *Vështirësinë e procesit, në të cilin është verifikuar shkelja;*
- *Sjelljen e trupit gjykues ose përmbartuesit dhe të palëve;*
- *Natyrën e interesave në çështjes;*
- *Vlerën dhe rëndësinë e çështjes në lidhje me objektin e mosmarrëveshjes ose ekzekutimit, e vlerësuar edhe në raport me kushtet personale të palëve.*

3.3 Problematikat në lidhje me aplikimin e neneve 399/1-399/12 të K.P.C

Ndonëse kuadri ligjor siç u analizua më lart ka parashikuar disa afate maksimale për konkretizimin e respektimit të “afatit të arsyeshëm” dhe mjetet procedurale për të kërkuar konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm, Gjykata e Lartë me një sërë interpretimesh dhe mekanizmash që po zbaton ka vendosur rrëzimin ose pushimin e kërkesave për cenim të afatit të arsyeshëm, me argumentin se mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit.

Gjykata e Lartë shprehet se në rastet kur gjykata është në kushtet e pamundësisë objektive për shkak të ngarkesës së madhe, nuk mund t’i kërkojë gjykatës që të marrë masa për përshpejtim të procedurave, kur konstaton se gjykata ndjek kritere transparente dhe objektive në përcaktimin e radhës së gjykimit të çështjeve. Një interpretim i kundërt, i cili nuk do të merrte në konsideratë volumin shumë të madh të çështjeve dhe do ta detyronte gjykatën të përshpejtonte procedurat pa u mbështetur në kritere objektive, do të shkaktonte pabarazi në radhën e trajtimit të çështjeve të cilat janë në rrethana të njëjta. Në rastin konkret, Kolegjit i rezultoi se gjyqtari relator ka marrë të gjitha masat e nevojshme organizative duke përcaktuar kritere transparente dhe objektive për marrjen në gjykim të çështjeve sipas radhës së vjetërsisë të çështjeve që i janë ngarkuar në cilësinë e gjyqtarit relator. Kolegji vlerëson se parimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk duhet të keqkuptohet, pasi shpejtësia e kryerjes së veprimeve procedurale nuk e përjashton, përkundrazi, e nënkupton kryerjen me cilësi të këtyre veprimeve të gjykatës. Duke qenë elemente të një procesi të rregullt, në çdo rast duhet të vendoset një ekuilibër i drejtë mes cilësisë së procesit dhe të vendimmarrjes së gjykatës me afatin e arsyeshëm apo edhe ekonominë gjyqësore në tërësi duke mos dëmtuar cilësinë⁴².

Gjykata e Lartë vlerëson se vonesat aktuale në gjykimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë (përfshirë mosmarrëveshjen konkrete objekt gjykimi), janë rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret. Përbën një fakt të njohur botërisht se reforma në drejtësi ka shkarkuar/pezulluar një numër të konsiderueshëm gjyqtarësh në Republikën e Shqipërisë. Ky proces natyreshëm ka krijuar kosto për qytetarët në tejzgjatjen e afateve për gjykimin e çështjeve gjyqësore. Këto vështirësi janë përgjithësisht proporcionale në raport me të mirën e përgjithshme që padyshim krijon procesi i reformës.

Komisioni i Venecias ka theksuar se reforma në drejtësi, procesi i verifikimit të gjyqtarëve/prokurorëve në Shqipëri, ishte e domosdoshme edhe nëse do të sillte pasoja të paparashikuara. Përveç aspekteve të padyshimta pozitive mbi cilësinë e gjyqësorit në planin afatgjatë, në një periudhë afatshkurtër procesi i verifikimit ndikon në numrin e gjyqtarëve aktivë në sistem duke shkaktuar probleme të përkohshme praktike derisa të bëhet zëvendësimi i tyre.⁴³

Gjykata e Lartë ka theksuar në disa vendimmarrje të mëparshme se vlerëson se konsideratat

42. Vendimi nr. 00-2023-2493, datë 08.06.2023 i Kolegjit Administrativ i Gjykatës së Lartë.

43. Shih Vendimin nr. 33/2, datë 17.01.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

e mësipërme janë pasur në vëmendje edhe nga legjislatori në kohën e parashikimit të rregullimeve ligjore specifike të Kodit të Procedurës Civile parashikuar në Kreun X, të Titullit III, të Pjesës së Dytë, të emërtuar *“Gjykimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit”*. Neni 399/2 pika 3 e Kodit të Procedurës Civile parashikon: *“Në kohëzgjatjen e gjykimit ose të procedimit, nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, sipas këtij kreu, ose kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim.”*

Kësisoj, Kolegji vlerëson se ligjvënësi, me ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile përmes ligjit nr. 38/2017, ka parashikuar rrethanat e “pamundësisë objektive për procedim”, si kusht për mosllogaritjen e afateve që kalojnë për sa kohë vepron kjo gjendje. Në kohëzgjatjen e gjykimit, nuk llogaritet koha e pamundësisë objektive për procedim, duke përjashtuar zbatimin e nenit 399/2, pika 2 të Kodit të Procedurës Civile, nëse gjykata vlerëson se ndodhet në këto kushte, çka nuk është rasti konkret i kërkuësve. Rasti klasik për sa më sipër, është pezullimi dymujor (mars-maj) në vitin 2020 i veprimtarisë gjyqësore për shkak të pandemisë Covid 19 (si rrjedhojë e aktit normativ nr. 9, datë 25.03.2020, i ndryshuar me aktin normativ nr. 21, datë 27.05.2020). Por, në këndvështrimin e Kolegjit, pamundësi objektive për procedim përbën edhe mospasja e përkohshme e kapaciteteve njerëzore të nevojshme për përballimin brenda limiteve të arsyeshme të stokut të çështjeve, të mbetura pa gjykuar për një kohë të gjatë.⁴⁴

Mbingarkesa e gjykatave dhe tejkzgjatja e afateve të gjykimit të çështjeve, e shkaktuar nga reformimi i sistemit gjyqësor, është bërë objekt shqyrtimi dhe i GjEDNj-së, e cila ka konstatuar shkelje të afatit të arsyeshëm (neni 6/1 KEDNj), duke u shprehur se: *“duke mos shpërfillur vonesën e kuptueshme që rrjedh nga reformat gjithëpërfshirëse të sistemit të drejtësisë dhe procesi i vetingut, shtetet kanë një detyrim të përgjithshëm për të organizuar sistemet e tyre ligjore në mënyrë që të siguronin përputhjen me kërkesat e nenit 6/1, duke përfshirë atë të një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm. Për më tej, GjEDNj vuri në dukje se nga viti 2012 backlog-u i Gjykatës së Lartë ishte rritur gradualisht dhe kishte mbetur në vlerë mjaft domethënëse. Ndonëse nuk i takon GjEDNj-së të vendosë për interpretimin e duhur të ligjit të brendshëm, qasja e Gjykatës së Lartë në çështjen e kërkuësit të parë për të mos llogaritur efektet e reformave të vazhdueshme të sistemit të drejtësisë në funksionimin e tij në kohëzgjatjen e përgjithshme të procedurave, në këto rrethana, nuk do të ishte në përputhje me jurisprudencën e saj sipas nenit 6/1 mbi kërkesën e “afatit të arsyeshëm”, pasi mund të zhvendoste te palët individuale ndërgjyqëse barrën e plotë të çdo vonese të shkaktuar nga reformat në sistemin e drejtësisë. Në konkluzion ka shkelje të neneve 13 në lidhje me nenin 6/1”*.⁴⁵

Bazuar në arsyetimin e mësipërm, Gjykata Kushtetuese ka treguar një qasje më të kujdesshme në lidhje me tejkzgjatjen e afateve për shqyrtimin e çështjes, duke pasur parasysh ndryshimet që solli reforma në sistemin e drejtësisë në vendin tonë dhe efektet e saj, veçanërisht lidhur

44. Po aty.

45. Shih vendimin e GjEDNj-së “Bara dhe Kola kundër Shqipërisë”, aplikimet nr. 43391/18 dhe 17766/19, datë 12.10.2021; Vendimi nr. 10-2023, datë 23.03.2023.

me plotësimin e numrit të gjyqtarëve në gjykata dhe numrin e madh të çështjeve në pritje për t'u shqyrtuar. Megjithatë, ajo ka vënë re se parashikimi i një reforme të kësaj natyre nuk mund të justifikojë vonesat, pasi shteti është i detyruar të organizojë hyrjen në fuqi dhe zbatimin e masave që shmangin tejzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve në pritje. Në këtë drejtim, akumulimi i përkohshëm i çështjeve nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi, me kusht që ky i fundit të ketë ndërmarrë veprime të menjëhershme që synojnë përmirësimin e situatës për të zgjidhur një situatë të këtij lloji. Pavarësisht se ka disa metoda që mund të zbatohen nga gjykatat për të nxitur përkohësisht përsheptimin e gjykimit të çështjeve, nëse edhe një zgjidhje e tillë rezulton në tejzgjatje dhe kthehet në një problem të organizimit strukturor, atëherë shteti duhet të sigurojë miratimin e masave më efektive dhe të organizojë sistemin gjyqësor, në mënyrë që të garantohet e drejta për të marrë një vendim përfundimtar brenda një periudhe të arsyeshme.⁴⁶

Pavarësisht interpretimeve të gjykatave, afateve tavan të vendosura për gjykimin e çështjes brenda një afati, i cili konsiderohet i arsyeshëm, aktualisht numri i reduktuar i gjyqtarëve, reforma e vetingut, zbatimi i hartës së re gjyqësore, mungesa e infrastrukturës së gjykatave, po ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në tejzgjatjen e afateve dhe cenimin e procesit të rregullt ligjor. Për shembull një çështje me objekt marrëdhënie pune, është regjistruar në vitin 2019 dhe ka përfunduar shqyrtimi në korrik të vitit 2023, pra me një kohëzgjatje prej më shumë se 4 vjet.⁴⁷

4. Zbatimi i afateve procedurale në gjykimin në apel

Në nenin 443 të K.P. Civile parashikohen afatet brenda të cilave palët mund të ankimojnë vendimin e shkallës së parë në apel. Kodi ka parashikuar afate të veçanta (5 ditë) dhe afatin e përgjithshëm (15 ditë).

Për vendimet përfundimtare (pranim/rrëzim padie) afati i ankimit është 15 ditë, ndërsa në rastin e vendimeve të ndërmjetme ose jo përfundimtare (si vendimet e pushimit, kthimit të akteve, vendimet për caktimin e masës së sigurimit), afati i njoftimit është 5 ditë.

Bashkë me ankimin duhet të paraqiten: kopje të ankimit dhe të dokumenteve të tjera, aq sa janë personat që marrin pjesë në çështje si palë dhe prokura kur ankimi paraqitet nga avokati ose përfaqësuesi i palës. Në rast se ankimi nuk plotëson kushtet e mësipërme gjykata njofton palën që të ndreqë të metat brenda 5 ditëve, në të kundërt ankimi kthehet.

Pala që nuk ka bërë ankim apo pala kundër së cilës është bërë ankimi, mund ta kundërshtojë atë me kundër ankim brenda 5 ditëve nga dita që ka marrë njoftim për ankimin e palës tjetër (neni 456 K.P.C).

Çështjet gjykohen në apel në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën, sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit. Në Kod nuk janë parashikuar afate brenda të cilave duhet të përfundojë gjykimi në apel, në rastin e ankimeve

46. Shih Vendimin nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

47. Shih Vendimin nr.3384, datë 03.07.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Juridiksioni Përgjithshëm Tiranë.

ndaj vendimeve përfundimtare. Ndërsa ankimet kundër vendimeve jopërfundimtare shqyrtohen në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit të tyre (neni 471/a K.P.C).

Për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, pala mund të kërkojë nga gjykata shqyrtimin e çështjes në një afat më të shpejtë. Me vendimin nr.78, datë 30.05.2019, KLGj ka përcaktuar se në cilat raste mund të bëhet përsheptimi i gjykimit, të cilat për shkak të natyrës paraqesin emergjencë për t'u shqyrtuar si psh.:

- *çështjet që kanë për objekt të drejta të fëmijës apo që kanë ndikim te një fëmijë i mitur;*
- *çështjet me objekt zgjidhje ose pavlefshmëri martese;*
- *çështjet me objekt detyrim për ushqim; çështjet me objekt kujdestarinë;*
- *çështjet me objekt heqjen, kufizimin ose kthimin e zotësisë për të vepruar dhe ato që kanë për objekt të drejta të personave që iu është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar;*
- *çështjet me objekt birësimin;*
- *çështjet për të cilat gjykata e shkallës së parë është shprehur me vendim jopërfundimtar;*
- *çështjet për të cilat gjykata e shkallës së parë ka vendosur refuzimin e dhënies/lëshimit të urdhrit të ekzekutimit;*
- *çështjet me interes apo ndjeshmëri veçanërisht të lartë për opinionin publik apo ato që prekin interesa të komuniteteve të caktuara, në veçanti ato në nevojë;*
- *çështjet me objekt shpërblim dëmi nga zgjidhja e kontratës së punës.*

5. Zbatimi i afateve procedurale në gjykim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë

Afati për të bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, kundër vendimeve të gjykatës së apelit, është 30 ditë. Afati për të kërkuar rishikimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë është 30 ditë. Afati i ankimeve dhe rekurseve të veçanta është 5 ditë.

Së bashku me rekursin duhet të depozitohet: kopja e vërtetuar e vendimit të kundërshtuar dhe kur është rasti, edhe e njoftimit kur ky është bërë, prokura e posaçme, aktet dhe dokumentet mbi të cilat është bazuar rekursi në aq kopje sa janë palët.

Gjykata Lartë është gjykatë ligji, nuk mund të vendosë zgjidhjen e ndryshme të çështjes duke marrë prova të reja, por ka të drejtë vetëm ta kthejë për gjykim çështjen në gjykatën kompetente, vendimi i së cilës shfuqizohet. Gjykata e Kasacionit shqyrton dhe analizon ligjin dhe rrethanat e çështjes vetëm për aq sa i nevojitet asaj për të interpretuar ligjin ose një koncept të së drejtës, pa bërë një shqyrtim të ri të fakteve dhe provave. Në këtë kuptim, funksioni i Gjykatës së Lartë sot është të kontrollojë nëse ligji është interpretuar dhe zbatuar në mënyrë korrekte nga gjykatat më të ulta, vendimi i të cilave kundërshtohet. Gjykata

e Lartë nuk ka si thelb të veprimtarisë së saj shqyrtimin e fakteve dhe të provave në një çështje konkrete, por në raste të caktuara kjo në lidhje dhe për aq sa ndihmon Gjykatën të interpretojë ligjin e zbatueshëm.⁴⁸

Në K.P. Civile nuk janë parashikuar afate për shqyrtimin e çështjeve për të cilat është paraqitur rekurs ndaj vendimit përfundimtar, ndërsa rekursat kundër vendimeve jopërfundimtare shqyrtohen në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit të tyre në gjykatën më të lartë (neni 471/a K.P.C).

Lidhur me procedurën e shqyrtimit gjyqësor në GJL, nëpërmjet Urdhërit nr.284, datë 06.11.2017 të Kryetarit të GJL, janë përcaktuar rregullat për shqyrtimin e rekurseve dhe kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm ose për përsheptimin e procedurave të gjyqimit.

6. Indikatorët për monitorimin e respektimit të afatit të arsyeshëm në një proces civil

Me qëllim monitorimin e respektimit të afatit të arsyeshëm në procesin civil, monitorimi duhet të orientohet drejt indikatorëve cilësor dhe sasior. Disa nga indikatorët mund të jenë:

	Treguesit e realizimit/indikatorët	Po/Jo
Gjykimi në shkallë të parë		
	A është shqyrtuar kërkesa për marrjen e masës së sigurimit brenda afatit 5 ditor?	
	A ka pasur kërkesa për shtyrje të seancave nga gjykata, palët ndërgjyqëse?	
	A janë marrë masa nga gjykata në rast të shtyrjes së seancave nga palët pa shkak të arsyeshëm/objektiv?	
	A ka pasur shtyrje të seancave për shkak të problematikave/ apo mos njoftimit të rregullt të palëve?	
	A është arsyetuar vendimi i gjykatës brenda 20 ditëve nga data e shpalljes?	
	A është shqyrtuar çështja brenda afatit 2 vjeçar?	
	A është shqyrtuar brenda afatit 3 mujor kërkesëpadia për shpërblimin e dëmit në rastin kur është konstatuar shkelja e afatit?	
	A ka vendosur gjykata masën e shpërblimit të drejtë brenda kufijve të parashikuara në ligj?	

48. Shih "Udhëzues për paraqitjen dhe shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë", aksesuar në linkun http://www.gjykataelarte.gov.al/web/rregullat_e_rekursit_ne_gjl_2021_5779.pdf

	A janë marrë masa për të siguruar një shpërndarje të drejtë dhe efikase të ngarkesës ndërmjet gjyqtarëve (d.m.th. monitorimi i ecurisë së proceseve gjyqësore, shpërndarja e drejtë e numrit të çështjeve që i janë caktuar secilit gjyqtar, pjesëmarrja e gjyqtarëve në aktivitete të tjera, etj.) ?	
	A i është njoftuar vendimi i arsyertuar palëve në afate të shpejta nga administrata gjyqësore?	
	A është depozituar çështja në apel brenda afateve të shpejta?	
	A i është përcjellë ILD-së vendimi i cili ka konstatuar shkeljen e afatit të arsyeshëm për përfundimin e gjykimit për të vlerësuar nëse vonesat e shkaktuara nga gjyqtarët përbëjnë shkelje disiplinore?	
Gjykimi në apel		
	A është shqyrtuar ankimi ndaj një vendimi jo përfundimtar brenda 30 ditëve?	
	A është shqyrtuar çështja brenda afatit 2 vjeçar?	
	A kanë paraqitur palët kërkesë për përshpejtimin e gjykimit?	
	A kanë paraqitur palët dokumentacion shkresor për të provuar shkakun e pretenduar për përshpejtimin e gjykimit?	
	A është shqyrtuar kërkesa e palës për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes nga gjyqtari relator, jo më vonë se 30 ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës?	
	A ka qenë gjykata përpara rasteve të parashikuara në ligj për të vendosur përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes?	
	A është shqyrtuar ankimi brenda afatit të përcaktuar në vendimin i cili ka pranuar kërkesën për përshpejtimin e gjykimit të çështjes?	
	A kanë paraqitur palët kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit dhe përshpejtimin e gjykimit?	
	A është marrë vendim nga gjykata për kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit dhe përshpejtimin e procedurave brenda afatit 45 ditor?	
	A janë ndërmarrë inspektime nga ILD lidhur me moszbatimin nga gjykatat të kalendarit për gjykimin e çështjeve sipas rradhës së regjistrimit?	

	A janë marrë masa për të siguruar një shpërndarje të drejtë dhe efikase të ngarkesës ndërmjet gjyqtarëve (d.m.th. monitorimi i ecurisë së proceseve gjyqësore, shpërndarja e drejtë e numrit të çështjeve që i janë caktuar secilit gjyqtar, pjesëmarrja e gjyqtarëve në aktivitete të tjera, etj.) ?	
Gjykimi në Gj. Lartë		
	A është shqyrtuar çështja në Gjykatën e Lartë brenda 2 viteve nga momenti i regjistrimi i çështjes në gjykatë?	
	A është shqyrtuar ankimi ndaj një vendimi jo përfundimtar brenda 30 ditëve?	
	A kanë paraqitur palët kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit dhe përshpejtimin e gjykimit?	
	A është marrë vendim nga gjykata për kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit dhe përshpejtimin e procedurave brenda afatit 45 ditor?	
	Nëse është paraqitur kërkesa për përshpejtim të gjykimit dhe konstatimit të shkeljes së afatit të arsyeshëm, a ka pasur raste që gjykata ka caktuar datën dhe orën e gjykimit brenda 30 ditëve, si rrjedhojë ka pushuar kërkesën?	
	Duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes të gjykimit, sjelljen e organit që ka kryer procedurat, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen, a është vendosur konstatimi i tejzgjatjes së procedurave gjyqësore, pavarësisht se nuk janë tejkaluar afatet e përcaktuara në ligj?	

Treguesit e realizimit	Përqindja (%)
Cili është raporti i rasteve të pranimit/rrëzimit të kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit/përshpejtimin e procedurave/shpërblimin e dëmit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm?	
Cili është raporti i rasteve të pranimit/rrëzimit të kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit/përshpejtimin e procedurave/shpërblimin e dëmit nga GJK?	
Cili është raporti i rasteve të pranimit/rrëzimit të kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit/përshpejtimin e procedurave/shpërblimin e dëmit nga GJEDNJ?	

Cili është raporti i rasteve në të cilat gjatë shqyrtimit të kërkesës organi që ka qenë duke kryer veprimet ka ndërmarrë hapat që kërkoheshin nga pala brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës dhe është pushuar shqyrtimi i kërkesës?	
Cili është raporti i rasteve në të cilat i është përcjellë ILD-së vendimi i cili ka konstatuar shkeljen e afatit të arsyeshëm për përfundimin e gjyqimit dhe vonesat e shkaktuara nga gjyqtarët janë konsideruar shkelje disiplinore?	
Cila është mesatarja e kohëzgjatjes së shqyrtimit të çështjeve në shk. të I për vitin X?	
Cila është mesatarja e kohëzgjatjes së shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit për vitin x?	
Sa % e çështjeve kanë përfunduar brenda afatit 2 vjeçar në gjykatën e shkallës së parë për vitin X?	
Sa % e çështjeve kanë përfunduar brenda afatit 2 vjeçar në Gjykatën e Apelit për vitin X?	
Sa % e çështjeve përfundojnë brenda afatit 2 vjeçar në Gjykatën e Lartë për vitin X?	
Sa është niveli i kënaqësisë së palëve lidhur me afatet për shpalljen e arsyetuar të vendimeve të gjykatave?	
Sa është niveli i kënaqësisë së palëve lidhur me afatet për shqyrtimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë?	
Sa është niveli i kënaqësisë së palëve lidhur me afatet për shqyrtimin e ankimeve/rekurseve në gjykatat e apelit dhe Gjykatën e Lartë?	

MODULI 4

ZHVILLIMI I GJYKIMIT BRENDA NJË AFATI TË ARSYESHËM NË PROCESIN ADMINISTRATIV

1. Hyrje

Regullat dhe procedurat për shqyrtimin e një çështje me natyrë administrative parashikohen në ligjin nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, në bazë të të cilit është ngritur dhe funksionon gjykata administrative e shkallës së parë, Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

Një nga parimet thelbësore që parashikohet në ligjin e sipërcituar është shqyrtimi i gjykimit nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme (pika 1 e nenit 3 të ligjit nr.49/2012).

Për shkak të natyrës dhe specifikave që paraqesin çështjet administrative, duke pasur si qëllim mbrojtjen juridike të të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë të subjekteve, që mund të çenohen si pasojë e ushtrimit ose jo të funksioneve publike nga ana e organeve të administratës publike ligjvënësi ka vendosur afate procedurale specifike për zhvillimin e gjykimit administrativ.

Ndryshe nga parashikimet në Kodin e Procedurës Civile dhe në Kodin e Procedurës Penale, të cilat nuk parashikojnë një afat konkret brenda të cilave duhet të zhvillohet një gjykim, në ligjin e sipërcituar, parashikohen afate konkrete të përfundimit të gjykimit në shkallë të parë, në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë.

Gjykatat administrative u ngritën dhe filluan funksionimin në nëntor të vitit 2013, në fillim ishin 6 Gjykata Administrative të Shkallës së Parë, një Gjykatë Administrative Apeli, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ndërsa sot pas hartës së re gjyqësore, gjykatat administrative të shkallës së parë janë bashkuar dhe aktualisht kryejnë funksionin e gjykatës administrative të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnje⁴⁹.

Lidhur me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative brenda afateve të arsyeshme dhe të shpejta, Gjykata Kushtetuese ka konsoliduar qëndrimin duke u shprehur se neni 3 i ligjit nr.49/2012 të lartpërmendur ndër parimet e gjykimit administrativ, ka përcaktuar

49. Shih “Një hartë e re gjyqësore për Shqipërinë”, Raport vlerësimi nga KLGJ – Shtator 2021, aksesuar në linkun: <https://klgj.al/wp-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>

sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësit në krijimin e këtyre gjykatave. Kështu, në relacionin bashkëlidhur projektligjit nr.49/2012⁵⁰ thuhet se ligji synon thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative dhe se në këtë drejtim qëllimi i krijimit të Gjykatës Administrative është garantimi i mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme⁵¹.

Ndonëse qëllimi i ligjit ishte shqyrtimi i çështjeve administrative brenda afateve të arsyeshme dhe të shpejta, në praktikë ky qëllim nuk u konkretizua pasi shqyrtimi i një çështjeje nga gjykata e shkallës së parë deri në Gjykatën e Lartë mund të zgjasë mesatarisht 7 vite (pa marrë në analizë çështjet që kthehen për rigjykim).

Gjykata e administrative e shkallës së parë paraqet një kohë relativisht më të shpejtë të gjykimit të çështjeve. Referuar raportit vjetor të vitit 2021, 86% e çështjeve gjykohen brenda një afati 6 muaj, 11% e çështjeve gjykohen brenda një afati 6 muaj -2 vite, ndërsa 1 % shqyrtohen përtej afatit 2 vjeçar⁵².

Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë shfaqin një vonesë të konsiderueshme në shqyrtimin e çështjeve, ndonëse ligji ka parashikuar afate strikte për përfundimin e shqyrtimit të dosjes në këto shkallë gjykimi. Nëse i referohemi statistikave të publikuara në faqen zyrtare të gjykatës, konstatohet që 56% e çështjeve shqyrtohen përtej 721 ditëve ose përtej afatit 2 vjeçar, ndërkohë që afati i përcaktuar nga ligji është 30 ditë⁵³.

2. Zbatimi i afateve procedurale gjatë zhvillimit të gjykimit në shkallë të parë

Në ligjin nr.49/2012 janë parashikuar afate procedurale për kryerjen e veprimeve nga ana e gjykatës, afate të cilat fillojnë nga momenti i regjistrimit të padisë në gjykatë. Në varësi të llojit dhe emergjencës së shqyrtimit të çështjes, ligjvënësi ka parashikuar dhe disa afate të shkurtra, si psh. shqyrtimi i kërkesave për sigurimin e padisë.

2.1 Respektimi i afateve procedurale për shqyrtimin e kërkesave për sigurimin e padisë;

Nga vetë natyra urgjente që ka kërkesa për marrjen e masës së sigurimit, ligjvënësi ka parashikuar afate të shpejta për shqyrtimin e kërkesës nga ana e gjykatës. Kërkesa për sigurimin e padisë, duhet të shqyrtohet brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës në gjykatë. Si rregull kërkesa shqyrtohet në prani të palëve, por, në raste të ngutshme, mund të

50. Shih Relacionin për projektligjin nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

51. Vendimi nr.59, datë 16.09.2016 i GJK; Vendimi nr. 26 datë 27.03.2017 i GJK; Vendimin nr. 46 datë 03.07.2017 i GJK;

52. Shih Raporti Vjetor për vitin 2021 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, aksesuar në linkun <https://www.gjykata.gov.al/gjykata-administrative-e-shkalles-se-pare-tiran%C3%AB/gjykata-administrative-tiran%C3%AB/njoftime-p%C3%ABr-publikun/>

53. <https://www.gjykata.gov.al/gjykata-administrative-e-apelit/gjykata-administrative-e-apelit/statistika/koh%C3%ABzgjatja-e-c%C3%ABshtj%C3%ABve/>

shqyrtohet edhe pa u thirrur palët (pika 3 e nenit 28 të ligjit 49/2012).

Llogaritja e afatit 5 ditor fillon nga momenti që është depozituar çështja në gjykatë dhe llogariten ditët kalendarike, duke përfshirë dhe ditët e pushimit. Për shembull nëse një kërkesë për marrjen e masës së sigurimit të padisë është paraqitur ditën e enjte, kërkesa duhet të shqyrtohet brenda ditës së hënë. Në rastet kur kërkesa paraqitet ditën e hënë ose të martë, ndonëse afati 5 ditor plotësohet ditën e shtunë ose ditën e dielë, seanca caktohet ditën e hënë.

Në praktikë ka raste kur afati procedural i sipërcituar nuk respektohet dhe kërkesa mund të shqyrtohet përtej afatit 5 ditor, duke vendosur në rrezik të drejtat e palës kërkuese.

2.2 Respektimi i afateve procedurale për zhvillimin e gjykimit të zakonshëm;

Në ligjin 49/2012, nuk është parashikuar një afat specifik brenda të cilit duhet të përfundohet gjykimi në shkallë të parë, por në disa dispozita gjejmë të parashikuara disa afate brenda të cilave duhet të kryhen veprimet përgatitore, të caktohet seanca gjyqësore, të merren provat, të cilat janë afate të shkurtra dhe nëse respektohen gjykimi mund të përfundojë në një afat shumë të shpejtë.

2.2.1 Afatet për kryerjen e veprimeve përgatitore;

Brenda 7 ditëve nga momenti paraqitjes së padisë (regjistrimit nga sekretaria gjyqësore), pas shortimit të çështjes, gjyqtari të cilit i ka rënë në short çështja, duhet të kryejë disa veprime (neni 25 i ligjit 49/2012):

- a. *I kërkon paditësit plotësimin e të metave të padisë, duke i caktuar atij një afat, deri në 10 ditë. Afati 10 ditor është afat maksimal, pasi gjyqtari mund të vendosë dhe një afat 3 ditor, 5 ditor etj. Nëse paditësi nuk plotëson të metat e padisë, brenda afatit të caktuar, gjyqtari jep vendim për kthimin e padisë dhe të akteve, që i bashkëlidhen asaj;*
- b. *I njofton të paditurit padinë dhe aktet shoqëruese të saj, duke i caktuar atij një afat, deri në 10 ditë nga data e marrjes së këtij njoftimi, për depozitimin në sekretari të prapësimeve me shkrim, të listës së personave, që i padituri kërkon të thirren në gjykim, me cilësinë e dëshmitarit apo të ekspertit dhe adresat e tyre, si dhe të akteve të plota shkresore, në të cilat është bazuar kryerja e veprimit administrativ dhe shqyrtimi i ankimit administrativ;*
- c. *Merr vendim për kryerjen e ekspertimit kur çmon se për zgjidhjen e çështjes ka nevojë për njohuri të posaçme.*

Në vendim e marrë sipas pikës c), gjyqtari përcakton fushën e ekspertimit, ekspertin nga lista e ministrisë, detyrat përkatëse, si dhe afatin e kryerjes së ekspertimit, i cili, si rregull, nuk mund të jetë më i gjatë se 20 ditë. Palët kanë të drejtë të tërheqin kopje të aktit të paktën 3 ditë para datës së seancës gjyqësore.

Referuar parashikimeve të mësipërme nëse marrim një çështje e cila kërkon akt ekspertimi,

padia është paraqitur me të meta (psh. nuk është paguar taksa gjyqësore), afati maksimal për realizimin e të gjitha veprimeve përgatitore është 47 ditë (duke llogaritur maksimumin e afateve të siëprcituara).

2.2.2 Afatet për zhvillimin e seancës gjyqësore;

Pas kryerjes së veprimeve përgatitore dhe nëse palët nuk kanë kërkesa të tjera procedurale, Gjykata nxjerr menjëherë urdhrin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Seanca gjyqësore nuk mund të caktohet përtej afatit 15 ditor (neni 27 i ligjit 49/2012). Me caktimin e seancës gjyqësore, prezumohet që janë kryer të gjitha veprimet procedurale/përgatitore, janë marrë të gjitha provat dhe është momenti për zhvillimin e debatit gjyqësor, i cili mund të zhvillohet në një seancë të vetme.

Në praktikë ndodh që çështja nuk përfundon me një seancë gjyqësore, por mund të zgjasë në dy ose më shumë seanca, pasi mund të ndodhë që seanca mund të shtyhet nga gjyqtari për shkaqe objektive (arsye shëndetësore), nga përfaqësuesit e palës për shkaqe objektive, ose mund të ndodhë që palët të kërkojnë që gjykata të marrë prova nga një institucion që është palë e paditur, nga një institucion tjetër, palët mund të paraqesin prova të reja, për të cilat nuk ka marrë njoftim pala tjetër, duke u bërë shkak për shtyrjen e seancës dhe caktimin e një seance tjetër.

Nëse seanca gjyqësore përfundon në datën e caktuar në urdhrin e gjykatës, kjo e fundit i kërkon palëve të parashtrojnë pretendimet përfundimtare dhe çfarë kërkojnë përfundimisht nga gjykata, pranimin e padisë (e kërkon paditësi) ose rrëzimin e padisë (e kërkon pala e paditur).

Palët mund të parashtrojnë qëndrimin e tyre në atë moment, ose mund të kërkojnë nga gjykata një afat për të paraqitur konkluzionet/prendimet përfundimtare. Afati maksimal është 5 ditë. Nëse llogarisim afatet e sipërcituara dhe procesi zhvillohet në një seancë gjyqësore afati për zhvillimin e procesit nga seanca gjyqësore deri në shpalljen e vendimit është 20 ditë.

Pas paraqitjes së pretendimeve përfundimtare nga palët, gjykata shpall vendimin. Vendimi si rregull duhet të shpallet i arsyetuar. Ligjvënësi ka parashikuar një afat maksimal deri në 5 ditë për shpalljen e arsyetuar të vendimit në rastet kur gjykata është në pamundësi absolute për të shallur vendimin menjëherë (neni 42 i ligjit 49/2012). Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore.

Në praktikë ndodh që ky afat nuk respektohet, vendimi mund të arsyetohet edhe pas disa javësh ose muajsh, duke cënuar afatet e parashikuara në ligj dhe duke shkatuar vonesa në depozitimin e ankimeve dhe dërgimin e çështjes në apel (në rastet kur ndaj vendimit paraqitet ankim).

3. Zbatimi i afateve procedurale në gjykimin në apel

Ndryshe nga zhvillimi i gjykimit në shkallë të parë, në rastin e gjykimit të çështjeve në apel, ligjvënësi ka parashikuar një afat specifik për përfundimin e gjykimit në këtë shkallë gjykimi.

Secila palë ka të dejtën e ankimit kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, përveç vendimeve të cilat janë të paankimueshme.⁵⁴ Ankimi paraqitet në gjykatën administrative të shkallës së parë. Pas verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore të ankimit dhe pas disponimit të gjykatës mbi ankimin, sekretaria gjyqësore i njofton palës tjetër ankimin, e cila brenda 5 ditëve nga e nesërmbja e njoftimit ka të drejtë të paraqesë apel kundërshtues⁵⁵.

Sekretaria e gjykatës brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të ankimit, dërgon në Gjykatën Administrative të Apelit (nenit 48 të ligjit):

- *Ankimin, së bashku me aktet që i bashkëlidhen atij;*
- *Vendimin e gjyqtarit për pranimin e ankimit;*
- *Aktet e komunikimit të ankimit;*
- *Dosjen e gjykimit.*

Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi. Gjykimi në apel admisnitativ si rregull zhvillohet në dhomë këshillimi, por në rastet kur gjykata çmon që është i nevojshëm zhvillimi i debatit gjyqësor, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore (neni 51 i ligjit). Ligjvënësi ka parashikuar një afat maksimal deri në 5 ditë për shpalljen e arsyetuar të vendimit në rastet kur gjykata është në pamundësi absolute për të shallur vendimin menjëherë (neni 55 i ligjit 49/2012). Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore.

4. Zbatimi i afateve procedurale në gjykimin pranë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

Ligjvënësi ka parashikuar afate specifike për shqyrtimin e çështjes në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Pala, kundër të cilës është bërë rekurs, mund kundërshtojë pretendimet e ngritura në rekurs brenda 15 ditëve nga komunikimi i rekursit (neni 59).

Gjykata që ka dhënë vendimin e kundërshtuar i dërgon rekursin, së bashku me aktet që i bashkëlidhen atij, vendimin e gjyqtarit për pranimin e rekursit, aktet e komunikimit të

54. Në nenin 45 të ligjit 49/2012 parashikohet se: Nuk lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt: a) kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi; b) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi; c) kundërshtimin e aktit administrativ që ka refuzuar dhënien e detyrimit në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi; ç) mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi.

55. Neni 456 K.P. Civile

rekursit, kundërrekursin, si dhe dosjen e gjykimit në Gjykatën e Lartë, brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të komunikimeve (neni 60). Gjykata e Lartë shqyrton çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit dhe akteve bashkëlidhur prej gjykatës ku është depozituar rekursi.

Shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi. Gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës, njofton sipas rregullave të përcaktuara për gjykimin në shkallë të parë dhe me shpallje, ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 21 ditë përpara (neni 61).

Gjyqtari relator përgatit relacionin, duke pasqyruar në të, veç të tjerave, edhe përmbajtjen e vendimit të ankimuar, pretendimet dhe shkaqet e ngritura në rekurs, prapësimet e paraqitura në kundërrekurs, shqyrtimin e fakteve që kanë rëndësi për marrjen e vendimit dhe propozimin e tij për zgjidhjen ligjore të çështjes.

Ligjvënësi ka parashikuar një afat maksimal deri në 10 ditë për shpalljen e arsyetuar të vendimit në rastet kur gjykata është në pamundësi absolute për të shallur vendimin menjëherë (neni 64 i ligjit 49/2012). Brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore.

5. Indikatorët për monitorimin e respektimit të afatit të arsyeshëm në një proces administrativ

Me qëllim monitorimin e respektimit të afatit të arsyeshëm në procesin administrativ, monitorimi duhet të orientohet drejt indikatorëve cilësor dhe sasior:

<i>Treguesit e realizimit/indikatorët</i>	Po/Jo
A është regjistruar padia në ditën e paraqitjes së padisë?	
A është shortuar çështja në ditën e paraqitjes së padisë?	
A është shqyrtuar kërkesa për marrjen e masës së sigurimit të padisë brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së padisë?	
A janë realizuar veprimet përgatitore brenda afatit 7 ditor nga ana e gjykatës nga momenti paraqitjes së padisë?	
A janë caktuar seancat gjyqësore brenda afatit 15 ditor nga gjykata e shk.1?	
A ka pasur kërkesa për shtyrje të seancave nga gjykata, palët ndërgjyqëse?	
A janë marrë masa nga gjykata në rast të shtyrjes së seancave nga palët pa shkak të arsyeshëm/objektiv?	

A është shpallur vendimi i arsyetuar menjëherë pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor?	
Nëse shpallja e vendimit të arsyetuar nuk është bërë menjëherë pas përfundimit të procesit, a është shpallur vendimi i arsyetuar brenda afatit 7 ditor?	
A është dërguar nga administrata gjyqësore dosja në Gjykatën e Apelit brenda afatit 15 ditor nga data e depozitimit të ankimit?	
A është shqyrtuar çështja në apel brenda 30 ditëve nga momenti i regjistrimit të çështjes në apel?	
A është shqyrtuar çështja në Gjykatën e Lartë brenda 60 ditëve nga momenti i regjistrimit të çështjes në Gjykatën e Lartë?	

<i>Treguesit e realizimit/in-dikatorët</i>	Shumë mirë	Mirë	Keq
Si e vlerësoni respektimin e afateve procedural nga ana e gjykatës në shqyrtimin e çështjeve në gjykatën e shkallës së parë?			
Si e vlerësoni rolin e administratës gjyqësore në komunikimin e akteve brenda afateve procedurale?			
Si e vlerësoni qëndrimin e palëve ndërgjyqëse në respektimin e afateve procedurale të vendosura me ligj?			

<i>Treguesit e realizimit/indikatorët</i>	Përqindje (%)/Shifër
Sa % e çështjeve të regjistruara për vitin X kanë përfunduar brenda afatit 6 mujor, 1 vjeçar gjatë gjykimit në shk. 1?	
Sa % e vendimeve shpallen të arsyetuara menjëherë sapo përfundon shqyrtimi gjyqësor?	
Sa % e vendimeve shpallen të arsyetuara brenda afatit 7 ditor?	

Cila është mesatarja e kohëzgjatjes së shqyrtimit të çështjeve në shk. të I për vitin X?	
Sa % e ankimeve të veçanta paraqiten në ditën e fundit të afatit 5 ditor?	
Sa % e ankimeve paraqiten në ditën e fundit të afatit 15 ditor?	
Sa % e çështjeve të regjistruara në gjykatën e apelit për vitin X kanë përfunduar brenda afatit 30 ditor?	
Cila është mesatarja e kohëzgjatjes së shqyrtimit të çështjeve në apel etj.?	
Sa % e çështjeve të regjistruara në Gjykatën e Lartë për vitin X kanë përfunduar brenda afatit 60 ditor?	
Cila është mesatarja e kohëzgjatjes së shqyrtimit të çështjeve administrative në Gjykatën e Lartë etj.?	

MODULI 5

CILËSIA DHE ARSYETIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE

1. Hyrje

Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural përfundimtar dhe kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Në nenin 142/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë deklarohet qartë detyrimi i gjykatave për të arsyetuar çdo vendim gjyqësor që jepet prej tyre.

Vendimet jepen në “Emër të Republikës” dhe duhet të jenë të arsyetuara, përkatësisht duhet të përmbajnë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyra e zgjidhjes së saj.

Në varësi të formës së gjykimit, llojit dhe natyrës së çështjes, kërkesave procedurale, Gjykata shprehet me:

Vendim të ndërmjetëm (neni 125 K.Pr.C) - Vendimet e ndërmjetme jepen nga gjykata në seancë gjyqësore me qëllim që t'i përgjigjet kërkesave dhe të sigurohet zhvillimi i gjykimit në pajtim me dispozitat e këtij Kodi. Si vendime të ndërmjetme janë vendimet për thirrjen e një personi të tretë në gjykim, vendimi për ckatimin e një eksperti etj.

Vendime jopërfundimtar (neni 127 K.Pr.C) - Vendimet jopërfundimtare janë vendimet e pushimit të çështjes, me të cilët gjykata në rastet e parashikuara në këtë Kod i jep fund procesit gjyqësor civil pa e zgjidhur çështjen në themel, si edhe çdo vendim tjetër që pa e zgjidhur çështjen në themel i jep fund procedimit gjyqësor të filluar. Vendime jopërfundimtare janë vendimi i kthimit të akteve/padisë pa verpim etj.

Vendime përfundimtare (neni 126K.Pr.C) - Vendimi përfundimtar jepet nga gjykata në përfundim të gjykimit i cili zgjidh çështjen në themel, për shembull vendimi i pranimit të padisë, vendimi për rrëzimin e padisë etj.

Dhënia e një vendimi të arsyetuar është një nga elementët e rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor, në bazë të të cilit gjykata i jep zgjidhje konfliktit ligjor dhe rivendos në vend të drejtën e shkelur. Një vendimi i arsyetuar është një nga kriteret bazë për rritjen e besimit të publikut në dhënien e drejtësisë.

2. Standartet ndërkombëtare

Neni 6/1 i KEDNJ-së i vë gjykatat nën detyrimin për të dhënë arsye për vendimet që marrin. Në veçanti, gjykata e shkallëve më të ulta apo autoritetet e tjera vendim-marrëse duhet të japin arsye të bazuara për të mundësuar palët që të përdorin në mënyrë efektive cilëndo nga të drejtat ekzistuese të apelimit (H. kundër Belgjikës (1987)).⁵⁶

Arsyetimi i vendimeve ka për qëllim që t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar dhe në këtë mënyrë, të japë ndihmesë për ta bërë vendimin më të pranueshëm nga ana e tyre. Përveç kësaj, ai e detyron gjyqtarin që ta mbështesë arsyetimin e tij në argumente objektive dhe i ruan të drejtat e mbrojtjes. Sidoqoftë, shtrirja e detyrës për arsyetim të vendimit mund të ndryshojë në varësi të natyrës së këtij të fundit dhe duhet të analizohet në dritën e rrethanave të çështjes (*GJEDNJ, Ruiz Torija k. Spanjës, § 29*).

3. Kuadri ligjor i brendshëm dhe jurisprudenca vendase

Detyrimi i gjykatave për të dhënë një vendim të arsyetuar, duke analizuar dispozitat ligjore, provat dhe faktet objekt gjykimi është një detyrim dhe garanci për palët ndërgjyqëse që parashikohet në nenin 142/1 të Kushtetutës. Gjithashtu në nenin 126 të K.P.Civile parashikohet që vendimi duhet të pëmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyra e zgjidhjes së saj.

Arsyetimi i vendimit është element përbërës i procesit të rregullt ligjor që duhet t'u garantohet të gjitha palëve ndërgjyqëse, ndërsa mungesa e tij e sanksionon vendimin me pavlefshmëri. Mos arsyetimi i vendimit është një nga shkaqet kryesore që ngrihet në ankimet, rekursat dhe kërkesat që i drejtohen Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë tashmë kanë krijuar një praktikë të konsoliduar mbi interpretimin dhe standartin e arsyetimit që duhet të ketë një vendim gjyqësor.

Gjykata Kushtetuese ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë.⁵⁷

Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që çënojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar.⁵⁸

Në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë

56. Shih Gomien. D "Udhëzues i shkurtër i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut", 2005, fq. 62

57. Shih Vendimin nr. 13 datë 24.04.2018; vendimet nr.2, datë 26.01.2015; nr.3, datë 23.01.2014 të Gjykatës Kushtetuese;

58. Shih vendimin nr.55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese;

bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë, përfundimisht, qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim.⁵⁹

Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik.⁶⁰

Duhet të theksojmë që standarti i arsyetimit mund të mos jetë i njëjtë për të gjitha llojet e vendimeve. Në rastin e vendimeve të mospranimit të rekurseve nga Gjykata e Lartë, nëse vendimi përmban, në pjesën hyrëse të tij, palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatës së shkallës së parë e asaj të apelit, faktin se kundër vendimit të kësaj të fundit kanë paraqitur rekurs kërkuesit, si dhe shkaqet që ato kanë parashtruar në rekurs, dhe vetë gjykata shprehet me fjalinë "*se rekursi i paraqitur nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së*", duke vendosur në pjesën urdhëruese mospranimin e tij, konsiderohet se e përmbush standartin kushtetues të arsyetimit të vendimit.⁶¹

4. Elementet, struktura dhe standarti i arsyetimit që duhet të ketë një vendim gjyqësor

Elementet, struktura dhe standarti i arsyetimit të vendimit parashikohen në dispozitat ligjore procedurale që rregullojnë zhvillimin e procesit civil, penal dhe administrativ. Pavarësisht llojit të gjykimit që zhvillohet apo natyrës së çështjes, të gjitha vendimet kanë një strukturë:

- *Hyrjen;*
- *Pjesën përshkruese-arsyetuese;*
- *Pjesën urdhëruese.*

Në varësi të natyrës së çështjes dhe llojit të gjykimit përmbajtja e secilit prej komponentëve të mësipërm mund të ndryshojë.

59. Shih vendimet nr.8, datë 16.03.2011; nr.23, datë 04.11.2008; nr.11, datë 02.04.2008; nr.7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese

60. Shih vendimet nr.3, datë 19.02.2013; nr.20, datë 13.04.2012; nr 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese

61. Vendimi nr.6, datë 02.3.2018 të Gjykatës Kushtetuese

4.1 Struktura dhe elementet e vendimeve civile dhe admisnitrative;

Në nenin 310 të Kodit të Procedurës Civile, parashikohen elementët që duhet të përmbajë vendimi gjyqësor:

Hyrja e vendimit duhet të përmbajë:

1. *Gjykata që ka gjykuar çështjen;*
2. *Trupi gjykues dhe sekretari;*
3. *Koha dhe vendi i dhënies së vendimit;*
4. *Palët, duke u shënuar identiteti dhe cilësia e tyre si paditës, i paditur, ndërhyrës, si dhe përfaqësuesit e tyre;*
5. *Emri i prokurorit, nëse ka marrë pjesë;*
6. *Objekti i padisë;*
7. *Kërkimet përfundimtare të palëve;*
8. *Mendimi i prokurorit nëse ka marrë pjesë.*

Pjesa përshkuese-arsyetuese e vendimit duhet të përmbajë:

- *Rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë gjykimit;*
 - *Përfundimet e nxjerra nga gjykata;*
 - *Provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi;*
 - *Dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi.*
- ❖ Në rastin e padive me vlerë deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi, vendimi duhet të përmbajë hyrjen dhe pjesën urdhëruese, duke anashkaluar pjesën arsyetuese. Nëse palët, brenda tre ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, njoftojnë me shkrim gjykatën se do ta ankimojnë vendimin, gjykata arsyeton vendimin dhe ua njofton palëve.

Pjesa urdhëruese, duhet të përmbajë:

1. *Çfarë vendosi gjykata;*
2. *Nëse gjykata vendos detyrime për palët, përmbajtjen konkrete të tyre dhe se vendimi është i ekzekutueshëm nga përmbartuesi gjyqësor;*
3. *Kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore;*
4. *E drejta për të bërë ankim dhe afati për paraqitjen e tij.*

Përveç elementeve të parashikuara më sipër, vendimi i gjykatës administrative përmban edhe (neni 41 i ligjit 49/2012):

- a. *Përcaktimin e qartë të çështjeve, në pjesën arsyetuese, të vlerësuara sipas nenit 37 të këtij ligji;*
- b. *Përcaktimin në pjesën urdhëruese, se kur parashikohet një detyrim konkret i palës së paditur, ai është i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor. Në këtë rast gjykata përcakton afatin dhe mënyrën e ekzekutimit të vendimit.*

Secila nga palët, brenda tridhjetë ditëve nga shpallja e vendimit, mund të kërkojë plotësimin e vendimit, në rast se gjykata nuk është shprehur mbi të gjitha kërkesat për të cilat pala ka paraqitur prova. Gjykata e shqyrton kërkesën me të njëjtin trup gjykues, pasi thërret palët dhe jep këtë vendim plotësues. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, sipas rregullave të përgjithshme (neni 313 K.P.C).

Sqarimi dhe interpretimi i vendimit. Gjykata ka të drejtë të japë sqarime ose të bëjë interpretimin e vendimit që ajo ka dhënë kur ky është i errët dhe e kërkojnë palët. Kërkesa për sqarimin dhe interpretimin e vendimit mund të paraqitet në çdo kohë, gjersa vendimi nuk është ekzekutuar. Kundër vendimeve të mësipërme mund të bëhet ankim i veçantë sipas rregullave të përgjithshme. (Neni 314 K.P.C)

4.2 Struktura dhe elementet e vendimeve penale;

Në Kodin e Procedurës Penale, në varësi të llojit të gjykimin që zhvillohet ka përcaktuar dhe elementet që duhet të përmbajë vendimi penal.

Në rastin e zhvillimit e gjykimeve të zakonshme, gjykimin të drejtpërdrejtë dhe gjykimin të shkurtuar në përfundim të shqyrtimit, gjykata shpall dhe arsyeton vendimin, i cili duhet të përmbajë (neni 383 K.P.P):

- *Gjykatën që e ka dhënë;*
- *Gjeneralitetet e të pandehurit ose të dhëna të tjera personale që vlejné për ta identifikuar, si dhe gjeneralitetet e palëve të tjera private;*
- *Akuzën;*
- *Parashtrimin e përmbledhur të rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta;*
- *Dispozitivin, duke treguar nenet e zbatuara të ligjit;*
- *Datën dhe nënshkrimin anëtarëve të trupit gjykues.*

Vendimi është i pavlefshëm kur mungon dispozitivi ose nënshkrimi i anëtarëve të trupit gjykues, si dhe kur ka haptazi kontradiktë mes arsyetimit dhe dispozitivit të tij. Në rastin kur zhvillohet gjykimi shkurtuar, përveç elementeve të mësipërme, vendimi duhet të përmbajë dhe uljen e dënimit me burgim ose gjobë me një të tretën (paragrafi 1 neni 406 K.P.P).

Në rastin kur gjykata operon me gjykim të posaçëm për miratimin e urdhrit penal ose gjykimi me marrëveshje vendimi duhet të përmbajë elementet e përcaktuara në nenin 383, konkretisht:

❖ *Vendimi për miratimin e urdhrit penal (neni 406/b):*

- Gjeneralitetet e të pandehurit;
- Parashtrimin e faktit dhe cilësimin juridik të veprës penale;
- Burimet e provës dhe faktet që ato u referohen;
- Masën e dënimit me gjobë, modalitetet e ekzekutimit të saj dhe llojin e dënimit plotësues të caktuar;
- Të drejtën e të pandehurit për të kundërshtuar vendimin e gjykatës, si dhe afatin brenda të cilit ky vendim mund të kundërshtohet;
- Disponimet për provat materiale dhe sendet që i përkasin veprës penale;
- Datën dhe nënshkrimin e gjyqtarit.

❖ *Vendimi për miratimin e marrëveshjes (neni 406/e) duhet të përmbajë:*

- Gjeneralitetet e të pandehurit dhe të dhënat e tjera personale të nevojshme për identifikimin e tij, si dhe gjeneralitetet e viktimës, nëse është e pranishme;
- Faktin që i pandehuri ka qenë i përfaqësuar dhe identitetin e mbrojtësit të tij;
- Faktin që i pandehuri e ka kuptuar përmbajtjen e marrëveshjes dhe pasojat që vijnë prej saj dhe ka nënshkruar me vullnet të lirë;
- Faktin se cilësimi juridik i veprës dhe rrethanat e saj, përshtatshmëria e dënimit të caktuar, si dhe mungesa e shkaqeve të padënueshmërisë apo të shuarjes së veprës penale, janë vlerësuar drejt nga prokurori;
- Deklarimin fajtor të të pandehurit, caktimin e dënimit dhe disponime të tjera, sipas përmbajtjes së marrëveshjes;
- Datën dhe nënshkrimin e vendimit;
- Marrëveshja për shpërblimin e dëmit civil (nesë ka).

5. Kontrolli i vendimeve gjyqësore nga gjykatat më të larta

Një vendim gjyqësor i marrë nga një gjykatë më e ulët mund t'i nënshtrohet kontrollit nga një gjykatë më e lartë, e cila në bazë të shkaqeve dhe pretendimeve të ngritura nga pala që kundërshton vendimin gjykon dhe kontrollon nëse dispozitat materiale dhe procedurale janë zbatuar drejtë nga gjykata më e ulët.

Një vendim gjyqësor, ashtu si çdo lloj vendimmarrje në të gjitha fushat, mund të jetë i gabuar. Për këtë arsye, ligjvënësi, për shkak të rëndësisë së të drejtave dhe lirive themelore të individëve në procesin penal (por edhe në atë civil apo administrativ) ka parashikuar mekanizma garancie, duke bërë të mundur kontrollin rishikues, si për themelin, ashtu edhe për ligjshmërinë e vendimit përfundimtar të gjykatave më të ulta. Në këtë kuptim, kontrolli i vendimit penal nga një gjykatë më e lartë konsiderohet si pjesë e pandashme e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke ulur mundësinë e gabimeve dhe rritjen e “drejtësisë” së vendimit penal.⁶²

Hierakia e gjykatave për “kontrollimin” e vendimeve të gjykatave nga më e ulëta deri tek më e larta pasqyrohet si më poshtë:



Gjykata e Apelit ka në kompetencë të gjykojë respektimin dhe interpretimin e drejtë të dispozitave ligjore, si dhe analizimin e fakteve dhe provave. Gjykata e Apelit kur çmon se duhet të merren prova të reja dhe sipas kriterëve të parashikuara në nenin 465 K.P.Civile, çel hetimin gjyqësor dhe gjykon si “shkallë e parë”.

Në përfundim të shqyrtimit Gjykata e Apelit mund të vendosë lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ndryshimin e vendimit, prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes, prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata e Lartë, ndryshe nga gjykata e apelit është një gjykatë ligji, që do të thotë se shqyrton vetëm nëse janë respektuar dhe interpretuar drejtë dispozitat ligjore materiale dhe procedurale, pra nuk gjykon dhe analizon prova.

Përveç sa më sipër, ligji i ka njohur GJL edhe një kompetencë tjetër lidhur me kontrollin dhe

62. Shih Vendimin Unifikues nr.2/2014 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

imponimin që ajo mund të ushtrojë ndaj vendimmarrjes së gjykatave më të ulëta nëpërmjet njehsimit ose ndryshimit të praktikës gjyqësore. Vendimet për njehsimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore të Kolegjit Civil dhe Kolegjeve të Bashkuara janë të detyrueshëm për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme. GJL mund të vendosë mospranimin e rekursit në rastet kur është paraqitur për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji ose kur nuk plotësohen kërkesat procedurale për paraqitjen e tij, prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues, prishjen e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë, prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit dhe pushimin e gjykimit të çështjes, ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe të vendimit të gjykatës së apelit dhe zgjidhjen përfundimisht të çështjes kur zbatimi i ligjit procedural apo material nuk diktohet nga nevoja për rishqyrtimin dhe rivlerësimin e fakteve apo të provave të çështjes, ose lënien në fuqi të vendimit të apelit.

Gjithashtu, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, GJK ka për kompetencë gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cënon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Në vendimin nr. 5, datë 2.02. 2001 të Gjykatës Kushtetuese ndër të tjera shprehet se: “Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që i’u imponon të gjithë organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsytimit të vendimit të saj. Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale”.

Nëse njëra nga palët pretendon se gjykatat vendase kanë cënuar një nga të drejtat e parashikuara në KEDNJ, pas ezuarimit të rrugëve gjyqësore të brendshme sipas hierkisë së pasqyruar në pirmaidën e mësipërme, kanë të drejtë ti drejtohen GJEDNJ-së brenda një afati 4 mujor. Në shumë raste GJEDNJ ka konstatuar shkelje të të drejtave të palëve ndërgjyqëse, zhvillim të proceseve gjyqësore duke cënuar procesin e rregullt ligjor.

Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, i masave individuale që duhet të merren nga shteti shqiptar është detyrim që buron nga nënshkrimi i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

6. Roli i organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në monitorimin e cilësisë së vendimeve

Pas hyrjes në fuqi të amendamenteve kushtetuese dhe ligjit për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të

të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë është Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

KLP dhe KLGJ kanë një rol thelbësor në vlerësimin e performancës së magistratit dhe zbatimit të masave disiplinore. Një ndër elementët kryesorë të vlerësimit të performancës së magistratit dhe zbatimit të masave disiplinore është edhe cilësia e vendimeve të marra prej tyre.

Të gjithë magistratët gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre janë subjekt i vlerësimit të tyre etik dhe profesional. Vlerësimi kryhet sipas kritereve të mëposhtme:

- a) aftësive profesionale të gjyqtarit nëpërmjet të cilave vlerësohet aftësia profesionale e gjyqtarit në drejtim të njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor;
- b) aftësive organizative nëpërmjet të cilave vlerësohet aftësia e magistratit për të përballuar ngarkesën e punës dhe për të kryer procedurat hetimore ose gjyqësore, si dhe aftësia për të administruar dosjet gjyqësore, duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga magistrati dhe që kanë efekt negative në rezultatet e vlerësimit⁶³.

Gjithashtu, një rast tjetër kur realizohet vlerësimi i ushtrimit të funksionit të magistratit është kur ky i fundit pretendohet që mund të ketë kryer një shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë. Magistrati mban përgjegjësi disiplinore për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, për sa kohë që nga rrethanat objektive dhe subjektive, rezulton se veprimet e tij mund të kenë qenë të qëllimshme, në kundërshtim të hapur dhe flagrant me ligjin apo me praktikatat unifikuese të gjykatave më të larta. Në çdo rast, bindja e brendshme duhet të jetë në përputhje me ligjin, me analizën e fakteve dhe provave në brendësi të çështjes, për ta kualifikuar atë sipas ligjit⁶⁴. Rastet të cilat përbëjnë shkelje disiplinore janë të parashikuara në nenet 101-104 të ligjit nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë*". KLGJ dhe KLP mund të vendosin ndaj magistratit një ose më shumë masa disiplinore.

ILD mund të fillojë hetimin me iniciativën e tij ose me nismë të ankuesit. Nëse ka dyshime të arsyeshme që magistrati ka kryer shkelje disiplinore, ILD fillon procedimin disiplinor, duke paraqitur pranë KLGJ ose KLP raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore. Pas shqyrtimit të fakteve dhe provave, Këshilli përkatës rrëzon kërkesën për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore, ose pranon kërkesën dhe vendos një ose më shumë masa disiplinore.

63. Nenet 68-76 të ligjit nr. 96/2016.

64. Vendimi nr.1, datë 30.05.2022 Kolegji i Posaçëm i Apelit i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

7. Roli i Shkollës së Magjistraturës në përmirësimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore

Shkolla e Magjistraturës është institucioni i cili siguron formimin profesional të magjistratëve. Formimi profesional përfshin:

- *Programin e formimit fillestar të kandidatëve për magjistratë;*
- *Programin e formimit vazhdues të magjistratëve në detyrë.*

Formimi fillestar i kandidatëve për magjistratë përfshin një periudhë tre vjeçare që përbëhet nga:

- a) *një vit program teorik që synon të rrisë njohuritë në lëndë të ndryshme të së drejtës;*
- b) *një vit program praktik para profesional, që synon të rrisë aftësitë praktike të kandidatëve si gjyqtarë dhe prokurorë nën kujdesin e shkollës dhe nën drejtimin e një gjyqtari ose prokurori me kualifikim të lartë;*
- c) *një vit praktikë profesionale që organizohet sipas mënyrës dhe afateve të parashikuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”⁶⁵.*

Magjistratët i nënshtrohen formimit vazhdues, nëpërmjet programeve të formimit të vazhdueshëm të hartuar dhe organizuar nga SHM, në bashkëpunim me KLGJ dhe KLP. KLGJ dhe KLP, miratojnë pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajnimin vazhdues, sipas programit të përcaktuar të formimit vazhdues dhe i’a dërgojnë SHM-së në fillim të vitit akademik.

KLJGJ dhe KLP bashkëpunon me SHM në lidhje me trajnimin vazhdues të magjistratëve duke këshilluar SHM rreth programit të trajnimit vazhdues për magjistratët, vendosur mbi kërkesat e magjistratëve për trajnimin vazhdues në SHM dhe monitorimit në lidhje me efektivitetin e trajnimeve⁶⁶.

Neni 5 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikon gjithashtu detyrimin e magjistratëve për të ndjekur kurset e formimit profesional vazhdues që organizon SHM. Pjesëmarrja në kurset e formimit profesional vazhdues që organizon SHM përbën edhe një kriter në kuadër të vlerësimit të aftësive personale dhe angazhimit profesional të magjistratit, duke u bazuar në tregues të tillë si pjesëmarrja e magjistratit në formimin vazhdues të SHM, pjesëmarrja në trajnime të tjera profesionale, disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr magjistratët e ardhshëm gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e magjistratëve të rinj, pjesëmarrja e magjistratit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun të gjykatave dhe publikimet ligjore akademike. Pjesëmarrja e magjistratit në formimin vazhdues të SHM matet nga KLGJ dhe KLP duke u bazuar në informacionin e dërguar nga SHM⁶⁷.

65. Neni 263 i ligjit nr. 115/2016.

66. Nenet 88 dhe 186 të ligjit nr. 115/2016.

67. Neni 74.6 i ligjit nr.96/2016.

8. Indikatorët për monitorimin e cilësisë dhe arsytimit të vendimit gjyqësor

<i>Treguesit e realizimit</i>	<i>Po/Jo</i>
A i përmban vendimi i gjykatës të gjithë elementët e parashikuar për hyrjen e vendimit?	
A i përmban vendimi i gjykatës të gjithë elementët e parashikuar për pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit?	
A i përmban vendimi i gjykatës të gjithë elementët e parashikuar për pjesën urdhëruese të vendimit?	
A është nënshkruar vendimi nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues?	
A kanë paraqitur palët kërkesë për ndreqjen e gabimeve në vendimin e gjykatës dhe kërkesa është gjetur e bazuar?	
A kanë paraqitur palët kërkesë për plotësimin e vendimit të gjykatës dhe kërkesa është gjetur e bazuar?	
A kanë paraqitur palët kërkesë për sqarimin dhe interpretimin e vendimit të gjykatës dhe kërkesa është gjetur e bazuar?	

<i>Treguesit e realizimit/indiktorët</i>	<i>Përqindje (%)/Shifër</i>
Sa % e çështjeve janë prishur nga Gjykata Kushtetuese, Gj. L për mospërmbushje të standartit të arsytimit?	
Sa % e vendimeve janë konsatuar si të pavlefshme për shkak të mosplotësimin të elementeve të parashikuar në ligj?	
Sa % e vendimeve shpallen të arsyetuara menjëherë sapo përfundon shqyrtimi gjyqësor?	
Sa është niveli i kënaqësisë së palëve në lidhje me standartin e arsytimit të vendimit nga gjykata?	

MODUL 6

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE

1. Hyrje

Në procesin penal një fazë e rëndësishme është dhe vënia në ekzekutim e vendimit. Duke marrë parasysh natyrën e çështjes, ku në përfundim të shqyrtimit gjyqësor mund të vendoset kufizimi i lirisë së personit (në rastin e dënimeve me burg), pezullimi i dënimit me burg dhe dhënia e dënimeve alternative (vënia në provë, kryerja e një pune me interes publik, kufizimi i pasurisë (psh. dënimi me gjobë, sekuestrimi i pasurive të paluajtshme ose të luajtshme, është e rëndësishme ekzekutimi i vendimit në një kohë sa më të shpejtë dhe brenda afateve të përcaktuara në ligj.

Ekzekutimi i vendimit penal nënkupton vënien në zbatim të urdhërimeve të vendimit të formës së prerë dhe i vendimeve që sipas K.P. Penale, kanë ekzekutim të menjëhershëm, me synimin e riedukimit të të dënuarve, të rivendosjes së të drejtave të personave të proceduar padrejtësisht dhe të drejtave të subjekteve juridike të cënuara nga vepra penale, duke ndikuar në parandalimin e tyre.⁶⁸

Rregullat procedurale për ekzekutimin e një vendimi penal dhe të drejtat e palëve gjatë ekzekutimit parashikohen në nenet 462-480 të K.P. Penale dhe ligjin nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Në kushtet kur nga një vendim penal kufizohet liria personale e personit siç janë rastet e masës së sigurimit “arresti në burg”, në ligj është parashikuar vënia në ekzekutim të menjëhershëm të vendimit, pavarësisht se vendimi mund të mos jetë përfundimtar. Rastet e ekzekutimit të menjëhershme të vendimit janë parashikuar specifikisht në ligj.

Përveç rasteve të ekzekutimit të vendimit të menjëhershëm, që një vendim të bëhet i ekzekutueshëm ai duhet të jetë i formës së prerë (neni 462/1). Në analizimin e kuptimit të shprehjes “formë e prerë”, Kolegjet e Bashkuara gjykojnë se për sa i përket metodologjisë, përqasja më e drejtë do të ishte ajo që lidhet me efektet e “formës së prerë”, të cilat kanë të bëjnë me shterimin e mjeteve të zakonshme të ankimit ose kalimin e afateve për ushtrimin e tyre. Ky është edhe përkufizimi i zgjedhur jo vetëm në shumë legjislacione të ngjashme me atë Shqiptar, por edhe në marrëveshje ndërkombëtare në të cilat shteti Shqiptar është palë. Kështu, në dhënien e një përkufizimi të “vendimit final” Raporti Shpjegues i Konventës Evropiane për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Vendimeve Penale (Raporti Shpjegues)

68. Shih Skënderaj, K., Hoxha, A. “Ekzekutimi i vendimeve penale”, Shëpia Botuese Morave 2019, fq 19

parashikon në lidhje me nenin 1 se: *“Vendimi duhet të jetë final. Një vendim është final, nëse, sipas shprehjes tradicionale, ajo ka fituar fuqinë e res judicata. Ky është rasti kur vendimi është i përvokueshëm, që do të thotë kur nuk ka mjete të mëtejshme të zakonshme në dispozicion ose kur palët i kanë konsumuar këto të tilla ose kanë lejuar që afati të mbarojë pa ushtruar ankim. [...]”*⁶⁹

Me ekzekutimin e vendimit penal kufizohen vetëm ato të drejta, në atë masë dhe kohë sa përcakton vendimi penal, duke respektuar të gjitha të drejtat e tjera të njohura dhe të mbrojtura nga legjislacioni në fuqi dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (neni 5 ligji 79/2020 ‘Për ekzekutimin e vendimeve penale’).

Ekzekutimi i dënimit duhet të bëhet brenda afateve maksimale të përcaktuara në Kod. Nëse kalojnë këto afate, vendimi nuk mund të ekzekutohet pavarësisht rëndësisë apo rrezikshmërisë së veprës penale.

Në nenin 68 të K. Penal parashikohet se vendimi i dënimit nuk ekzekutohet kur nga dita që ka marrë formë të prerë kanë kaluar:

- Njëzet vjet për vendimin që përmban dënim pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet burgim;
- Dhjetë vjet për vendimin që përmban dënim pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet burgim;
- Pesë vjet për vendime që përmbajnë dënim me burgim gjer në pesë vjet ose dënime të tjera më të lehta.

2. Nxjerrja e urdhrin të ekzekutimit

Organi që ndjek procedurën e ekzekutimit të një vendimi penal është prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, i cili merr masa, bën kërkesa dhe ndërhyr në të gjitha veprimet për ekzekutimin e vendimit (neni 463 të K.P.P).

Me qëllim ekzekutimin e një vendimi penal, prokurori nxjerr urdhrin e ekzekutimit. Urdhri i ekzekutimit përmban:

- a. Gjykatën që ka dhënë dhe/ose ka ndryshuar vendimin penal, numrin, datën, përmbajtjen e plotë të dispozitivit të vendimit penal objekt ekzekutimi dhe disponimet e nevojshme për ekzekutimin;
- b. Gjeneralitetet e personit ndaj të cilit do të ekzekutohet vendimi penal, adresën e vendbanimit ose të vendqëndrimit, pranë së cilës do të kryhet njoftimi i urdhrin të ekzekutimit;
- c. Llojin dhe masën e dënimit kryesor, si dhe kohëzgjatjen tërësore të kryerjes së dënimit, sipas procedurave të parashikuara në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe rregullave të parashikuara në ligjet e posaçme;

69. Shih Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.2, datë 03.11.2014;

- a. Llojin e dënimit plotësues dhe kriteret e zbatimit të tij;
- a. Në rastet e dënimit me burgim, llojin e sigurisë që duhet të ketë vendi i kryerjes së dënimit, sipas përcaktimit të bërë nga gjykata në dispozitivin e vendimit penal kryesisht ose bazuar në kërkesën e prokurorit për përcaktimin e llojit të sigurisë, sipas nenit 24 të ligjit nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”;
- b. Detyrimin civil në procesin penal;
- a. Organet që ekzekutojnë vendimin;
- c. Detyrimin e organeve që ekzekutojnë vendimin penal për njoftimin e fillimit të ekzekutimit. Në rastin e të dënuarve të mitur ose me aftësi të kufizuara përcaktohet edhe mënyra e njoftimit të urdhrin të ekzekutimit.

Urdhri i ekzekutimit i njoftohet menjëherë, por jo më vonë se 30 ditë, të dënuarit, mbrojtësit të tij dhe kur nuk ka të tillë, mbrojtësit të caktuar nga prokurori.

Në nenin 63 dhe 64 të ligjit nr. 79/2020 ‘Për ekzekutimin e vendimeve penale’ janë parashikuar afatet brenda të cilave gjykata dhe prokuroria duhet të kryejnë veprimet për ekzekutimin e vendimit penal.

a) *Afatet e veprimeve të gjykatës:*

- Për vendimet që përmbajnë dënim me burgim dhe për të cilat nuk është ushtruar ankim, gjykata i dërgon prokurorit kopjen e vendimit të përmbledhur brenda 24 orëve nga e nesërmja e ditës që vendimi merr formë të prerë;
- Vendimet e përmbledhura, që përmbajnë dënime të tjera penale ose urdhërime të tjera, i dërgohen prokurorit nga gjykata jo më vonë se 3 ditë nga marrja formë të prerë.
- Kur është vendosur pezullimi ose shtyrja e ekzekutimit të vendimit, afatet e mësipërme fillojnë nga data që gjykata anulon pezullimin ose plotësohet afati i shtyrjes.

b) *Afatet e veprimeve të prokurorit:*

Prokurori kryen veprimet paraprahe dhe nxjerr urdhrin e ekzekutimit:

- Për dënimet me burgim ose mjekim të detyrueshëm në institucionet mjekësore, me të paraburgosur, menjëherë pas marrjes së përmbledhjes së vendimit;
- Për vendimet që parashikojnë lirimin e menjëhershëm të të dënuarit dhe zbatimin e një dënimi alternativ, menjëherë pas marrjes së përmbledhjes së vendimit;
- Për dënimet me burgim për të gjykuarit në gjendje të lirë jo më vonë se 72 orë nga marrja e vendimit;
- Për dënimet me gjobë, kur është dhënë vetëm dënim plotësues;

- Për urdhërimet e tjera të gjykatës brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit;
- Për dënimet plotësuese që ekzekutohen njëkohësisht me dënimin kryesor, në të njëjtën kohë;
- Për dënimet plotësuese të tjera pas përfundimit të dënimit kryesor;
- Për dënimet ndaj personave juridikë brenda 5 ditëve nga marrja e përmbledhjes së vendimit.

c) *Afatet e fillimit të ekzekutimit:*

- Urdhrat e ekzekutimit për vendime penale me burgim dhe masë mjekësore me mjekim të detyrueshëm për personat e paraburgosur ekzekutohen menjëherë.
- Urdhrat e ekzekutimit për vendime me ekzekutim të menjëhershëm për personat e paraburgosur ekzekutohen menjëherë nga marrja e urdhrat.
- Urdhrat e ekzekutimit me dënime ose urdhërime të tjera, ekzekutimi duhet të fillojë menjëherë, por jo më vonë se 15 ditë nga marrja e tij.
- Urdhri i ekzekutimit për vendimet penale ndaj personave juridikë ekzekutohet brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Sa më sipër gjykata dhe prokuroria, si dhe palët e tjera në një proces gjyqësor janë të detyruar të respektojnë afatet e mësipërme. Mos respektimi i këtyre afateve sjell cënim të procesit të rregullt ligjor.

3. Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimeve penale

Gjykata në vendimet me ekzekutim të menjëhershëm, urdhëron vënien në ekzekutim të vendimit menjëherë pas shpalljes dhe dërgimin e një kopjeje të vendimit prokurorit pranë gjykatës që ka dhënë vendimin për ekzekutimin e tij (neni 10 ligjit 79/2020).

Vendimet penale që ekzekutohen menjëherë pas shpalljes janë:

- a. Vendimi penal që përmban pafajësi;
- b. Vendimi penal për përjashtimin e të gjykuarit nga dënimi;
- c. Vendimi penal për pushimin e gjyqimit të çështjes, me disponimin për lirim e personit të paraburgosur;
- d. Vendimi penal për caktimin e dënimit alternativ në vend të dënimit me burgim, ku përfshihet personi me masë sigurimi arrest, me disponimin e gjykatës për lirim e menjëhershëm të tij;
- e. Vendimi penal që përmban konfiskim pasurie, kur më parë është vendosur sekuestrimi;

- f. Vendimi për paligjshmërinë e arrestit në flagrancë/ndalimit;
- g. Vendimi kur masa e sigurimit e humbet fuqinë ose vendimi për revokimin apo zëvendësimin e masës së sigurimit me arrest, me disponimin e gjykatës për lirimin e menjëhershëm të personit të arrestuar, përveç kur ai ka një masë sigurimi me arrest për shkak tjetër ligjor, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale;
- h. Vendimi penal që miraton kërkesën e prokurorit për masën e sigurimit me arrest.

Për ekzekutimin e menjëhershëm, gjykata i njofton prokurorit vendimin e përmbledhur. Prokurori pranë gjykatës që ka dhënë vendimin nxjerr menjëherë urdhrin, i cili vihet në ekzekutim nga organet përgjegjëse, pasi të kenë verifikuar më parë që ndaj të njëjtit person ose të njëjtës pasuri nuk janë në fuqi vendime penale të tjera, që legjitimojnë vazhdimin e mbajtjes së personit nën arrest, ndalim, paraburgim ose burgim apo mbajtjen e pasurisë nën sekuestro ose konfiskim. Për ekzekutimin e menjëhershëm, gjykata i jep paraprakisht organit përkatës vendimin e përmbledhur dhe brenda afatit ligjor dërgon vendimin penal të arsyetuar (neni 22 ligji 79/2020).

4. Ekzekutimi i dënimit me burg

Vendimet penale që përmbajnë dënimin në burg vihen në ekzekutim me marrjen formë të prerë. Rastet kur vendimi merr formë të prerë dhe bëhet i ekzekutueshëm janë parashikuar në nenin 462 të K.P. Penale. Në ekzekutimin e vendimit penal duhet të bashkëpunojnë disa aktorë, si prokuroria, policia gjyqësore, i dënuari dhe sekretaria e prokurorisë.

Pas marrjes së vendimit gjyqësor, prokurori procedon me nxjerrjen e urdhrin të ekzekutimit duke analizuar dhe përfshirë në urdhrin ekzekutimit sipas rastit informacionin e mëposhtëm:

- Koha e kryer e dënimit dhe pjesa që mbetet, sipas kriterëve të nenit 57 të Kodit Penal;
- Kur i dënuari ka për të kryer më shumë se një dënim, prokurori i paraqet kërkesë gjykatës për bashkimin e dënimeve;
- Kur gjykata nuk e ka konstatuar dhe prokurori ka të dhëna se është vendi për vendosjen në institucione mjekësore të posaçme, ai urdhëron kontrollin mjekësor të të dënuarit dhe kur ka arsye, në bazë të rezultateve i paraqet kërkesë gjykatës sipas parashikimeve ligjore.

Pas nxjerrjes së urdhrin të ekzekutimit, prokurori i'a dërgon organit vendor të Policisë së Shtetit ku ka vendbanimin e përhershëm apo të përkohshëm ose vendqëndrimin i dënuari. Për të dënuarit ushtarakë, urdhri i dërgohet Policisë Ushtarake pranë repartit ku ka qenë efektiv i dënuari ose të vendit ku ai ndodhet. Kur i dënuari është i paraburgosur, urdhri i dërgohet institucionit ku ai mbahet në paraburgim

Policia e Shtetit, mbi bazën e urdhrin të prokurorit, në bashkëpunim me seksionet e Policisë Gjyqësore në prokurori dhe me shërbimet e Policisë Gjyqësore në strukturat hetimore në Policinë Ushtarake, si dhe me shërbime të tjera policore ose institucione shtetërore, ndihmon

për ekzekutimin vullnetar të dënimit me burgim ose në të kundërt vepron forcërisht për ekzekutimin e këtij dënimi (neni 23-27 të ligjit 79/2020).

5. Ekzekutimi i dënimeve alternative

Për kryerjen e një veprë penale, dënimet e parashikuara në Kodin Penal janë dënime kryesore⁷⁰ dhe dënime plotësues.⁷¹ Me qëllim rehabilitimin dhe riedukimin e personit që ka kryer një veprë penale, me miratimin e Kodit Penal në vitin 1995, u parashikuan disa lloje të reja dënimesh, të quajtuara dënime alternative, të cilat zëvendësojnë dënimin kryesor.

Parashikimeve i dënimeve alternative dhe zbatimi i tyre duke zëvendësuar dënimin me burgim, është një trend progresiv në të drejtën penale bashkëkohore dhe njëherit paraqet reformë të rëndësishme në konceptin dhe sistemin e sanksioneve ndëshkuese. Karakteristikë themelore e sistemit bashkëkohor konsiston në dy drejtime: dënimi me burgim, për vepra penale më të rënda dhe dënimet alternative për veprat penale më të lehta.⁷²

Kur gjykata vendos pezullimin e vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me një dënim alternativ, i dërgon menjëherë prokurorit vendimin e përmbledhur për ekzekutimin e dënimit alternativ. Në qoftë se i dënuari është i burgosur, gjykata i'a dërgon një kopje të vendimit për lirimin e tij edhe institucionit të ekzekutimeve të vendimeve penale ku mbahet i dënuari.

Shërbimi i Provës është organi shtetëror, përgjegjës për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe urdhërimeve të prokurorit për mbikqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative, të masave të shmangies nga ndjekja penale, të dënimeve jo me burgim për të miturit, ose veprimtarive të tjera sipas akteve të tjera ligjore, si dhe trajtimin e individualizuar të nevojave dhe aftësive të personit nën mbikëqyrje për të siguruar rehabilitimin dhe riintegrimin e tij në shoqëri (neni 17 ligjit 79/2020).

Misioni i këtij institucioni publik është mbrojtja e komunitetit dhe parandalimi i recidivizmit, asistimi dhe konsultimi për riintegrimin dhe risocializimin me sukses në komunitet të personave shkelës të ligjit, duke ndihmuar nëpërmjet metodave dhe instrumenteve më bashkëkohore, në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin shoqëror dhe sjelljen e ndryshimeve pozitive në jetën e tyre. Qëllimet e veprimtarisë së ShP janë:⁷³

- a. Zbatimi i AD me qëllim mbrojtja e interesave publikë;
- b. Parandalimi i kryerjes së veprave penale;

70. Sipas nënit 29 të Kodit Penal, dënimet kryesore janë: gjobë, burg, burgim i përjetshëm

71. Sipas nënit 30 të Kodit Penal dënimet plotësuese janë: *Ndalimi i të drejtës për të ushtruar funksione publike; Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale; Ndalimi për të drejtuar automjete; Heqja e dekoratave, titujve të nderit; Heqja e së drejtës të ushtrimit të një veprimtarie ose mjeshtërie; Heqja e së drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë; Ndalimi për të qëndruar në një ose disa njësi administrative; Nxjerrja jashtë territorit; Detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor; Humbja e përgjegjësisë prindëror.*

72. Shih <http://juridiksi.e-monsite.com/faqe/e-drejta-penale/leksione/denimet-alternative.html>

73. Shih Raport Monitorimi "Mbi aplikimin e vendimeve gjyqësore që përmbajnë alternativa dënimi në rrethet gjyqësore, Tropojë, Dibër, Krujë, Përmet, Pogradec dhe Sarandë", Prill 2019

- c. Asistimi i personave të dënuar për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga AD;
- d. Bashkëpunimi dhe paraqitja e informacionit dhe raporteve para prokurorisë dhe gjykatave;

Ekzekutimi i dënimeve alternative, në varësi të detyrimeve të përcaktuara dhe nevojave për trajtim dhe rehabilitim të të dënuarit, bëhet në bashkëpunim midis prokurorit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Shërbimit të Provës (Neni 3 i ligjit 79/2020).

6. Ekzekutimi i dënimit me gjobë

Krahas dënimeve me burg dhe dënimeve alternative një lloj tjetër dënimi i parashikuar në Kodin Penal është dënimi me gjobë, i cili konsiston në pagimin në favor të shtetit të një shume të hollash brenda kufijve të parashikuar në ligj. Për personat që kryejnë krim gjoba jepet nga 100 mijë gjer në 10 milionë Lek. Për personat që kryejnë kundërvajtje penale, gjoba jepet nga 50 mijë gjer në 3 milionë Lek (neni 34 K. Penal).

Gjykata vendos në dispozitivin e vendimit masën, afatet dhe mënyrën e pagimit. Në bazë të këtyre parashikimeve prokurori nxjerr urdhrin e ekzekutimit (neni 42 ligjit 79/2020, neni 467 K.P.P). Ekzekutimi bëhet nga organi përmbarrimor në territorin e të cilit ka vendbanimin i dënuari, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile për titujt ekzekutivë.

Kur ekzekutimi i gjobës është i pamundur tërësisht ose pjesërisht, me njoftim të organit përmbarrimor, prokurori i paraqet kërkesë gjykatës së vendit të ekzekutimit për konvertimin e gjobës, duke zbatuar rregullat e nenit 467 të Kodit të Procedurës Penale. Në rastet kur i dënuari nuk ekzekuton gjobën sipas afateve dhe masës së përcaktuar, prokurori mund të kërkojë konvertimin e gjobës me burg sipas parashikimeve në nenin 34 të K.Penal.

7. Indikatorët për monitorimin e ekzekutimit të vendimeve penale

<i>Treguesit e realizimit/indikatorët</i>	Po/Jo
Në rastet e vendimeve me ekzekutim të menjëhershëm a i është dërguar prokurorisë përmbledhja e vendimit/dispozitivi menjëherë pas shpalljes së tij?	
Në rastet e vendimeve me ekzekutim të menjëhershëm a e ka nxjerrë prokurori urdhrin e ekzekutimit menjëherë pas marrjes së përmbledhjes/dispozitivit të vendimit?	
A i është njoftuar palëve urdhri ekzekutimit brenda afatit 30 ditor?	
Në rastet kur vendimet përmbajnë dënim me burgim dhe për të cilat nuk është ushtruar ankimi, a i është dërguar nga gjykata prokurorit, vendimi i përmbledhur brenda 24 orëve?	

Në rastin e vendimeve me gjobë, a e ka nxjerrë prokurori urdhrin e ekzekutimit brenda 5 ditëve?	
A i përmban të gjitha elementët e parashikuar në ligj urdhri i ekzekutimit i nxjerrë nga prokuria?	
A ka pasur raste ku për shkak të mos respektimit të afateve për ekzekutimin e vendimeve penale, personit i është cënuar liria?	
A ka pasur raste kur vendimi nuk është ekzekutuar pasi kanë kaluar afatet e parashkrimit?	

<i>Treguesit e realizimit/indikatorët</i>	Përqindje (%) / Shifër
Sa është niveli i kënaqësisë së palëve në lidhje me standartin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor?	
Sa është niveli i kënaqësisë së palëve në lidhje me komunikimin dhe mbikqyrjen e ekzekutimit të dënimit nga Shërbimi i Provës?	
Sa është niveli i kënaqësisë së palëve në lidhje me standartin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor?	

MODUL 7

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE CIVILE & ADMINISTRATIVE

1. Hyrje

Kërkimi i një të drejte në gjykatë dhe në eventualitet marrjen e një vendimi gjyqësor pozitiv do të ishte një iluzion në qoftë se sistemi i brendshëm ligjor i ndonjërës prej palëve të larta kontraktuese do të lejonte që një vendim gjyqësor përfundimtar dhe i detyrueshëm të ngelej pa efekt dhe në dëm të ndonjërës prej palëve në proces. Do të kishte qenë e pakonceptueshme që neni 6/1, i KEDNJ të duhej të përshkruante në detaje garancitë procedurale të ofruara palëve në mosmarrëveshje, procedura të cilat ja ën të drejta publike dhe me efekt të drejtëpërdrejtë, pa mbrojtur vënien në zbatim të vendimeve gjyqësore. Një interpretim i tillë i nenit 6, që të ketë të bëjë vetëm me mundësinë për t'iu drejtuar një gjykate dhe me ecurinë e procedurave para saj, do të mund të çonte në situata të papajtueshme me parimin e shtetit të së drejtës, parim të cilin shtete kontraktuese morën përsipër që ta respektojnë kur ratifikuan Konventën.⁷⁴

Shkalla e respektimit të ekzekutimit të vendimit përcakton në mënyrë të ndjeshme dhe efektivitetin e procesit gjyqësor. Periudha e afatit të arsyeshëm për përfundimin e një procesi gjyqësor civil shtrihet, që nga momenti i ngritjes së padisë deri tek momenti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Gjykata ka një pozitë kryesore dhe të veçantë, pasi është i vetmi organ që është përgjegjës për dhënien e drejtësisë dhe si e tillë merr pjesë në mënyrë të detyrueshme në të gjitha marrëdhëniet që krijohen gjatë gjykimit të çështjes.⁷⁵

Në jurisprudencën e vazhdueshme të GJEDNJ, e cila është cilësuar si *“konventa në veprim”*, ka qenë i konsoliduar qëndrimi se faza e ekzekutimit të detyrueshëm është pjesa fundore dhe integrale e procesit gjyqësor civil dhe si e tillë meriton të gjitha garancitë dhe vëmendjen e nenit 6 të KEDNJ. Rasti i parë që ndryshoi praktikën gjyqësore dhe mënyrën doktrinare të të konceptuarit të fazës së ekzekutimit të detyrueshëm në Shqipëri ishte çështja *“Qufaj v. Shqipërisë”*.⁷⁶

Në këtë çështje GJEDNJ u shpreh se *“e drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk do të ishte reale, nëse sistemi ligjor i një shteti do të lejonte që një vendim gjyqësor i detyrueshëm dhe përfundimtar të mos zbatohej në dëm të njërës palë”*.

74. Shih Bianku.Ledi *“Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut”*, çështja Hornsby vs. Greqisë vs. Kroacisë, kërkesa nr.18357/91 Tiranë 2005, fq 350

75. Shih Vendimin nr. 00-2023-2342, datë 13.06.2023 të Gjykatës së Lartë

76. Shih vendimin nr.392, datë 26.10.2022 Kolegji Civil Gjykatës së Lartë

Duke u nisur nga ky konceptim, në praktikën e konsoliduar të GJEDNJ, është vendosur si standard se, në veçanti, ekzekutimi i detyrueshëm i një vendimi gjyqësor të formës së prerë, duhet të përfundojë brenda një afati të arsyeshëm. Vonesat në ekzekutim, çenojnë të drejtën e palës për akses në gjykatë dhe kjo qasje përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ.

Kjo praktikë e GJEDNJ, mbi afatet e arsyeshme të ekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, gjeti pasqyrim edhe në praktikën e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Në gjykimin e kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se gjykimi për realizimin e një të drejte, si një proces kompleks, në vetvete përbëhet nga dy faza, të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën.⁷⁷

- *Faza e parë*, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarimin e të drejtës që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë. I gjithë procesi gjyqësor, shpesh herë i vështirë e problematik, nuk do të kishte vlerë në qoftë se nuk do të pasohej nga një proces që lidhet drejtpërsëdrejti me veprimtarinë e organeve të përmbarimit, me ekzekutimin e vendimit ose të realizimit të së drejtës së fituar.
- *Në fazën e dytë*, kur lipset dhe ndërhyrja, qoftë dhe me masa shtrënguese për zbatimin e tij, realizohet ajo që quajmë qëllimi i drejtësisë. Duke qenë kështu, gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë vetëm me sigurimin e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar, nëse ajo nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit, mbetet pa asnjë vlerë.

Gjykata Kushtetuese, ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të KEDNJ. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimin të drejtë. Ai konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces.⁷⁸

2. Vënia në ekzekutim e vendimit gjyqësor

Vënia në ekzekutim e një vendimi gjyqësor, si pjesë thelbësore e procesit të rregullt ligjor, kërkon marrjen e disa veprimeve ligjore me qëllim ekzekutimin e vendimit civil ose administrativ.

Ekzekutimi i detyrueshëm i titujve ekzekutivë në përgjithësi, e sidomos ekzekutimi i detyrueshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës në veçanti, konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar sipas ligjit. Karakteri unitar i procesit

77. Vendimi nr.1, datë 21.01.2016 të Gjykatës Kushtetuese

78. Po aty

civil detyron respektimin e garancive të procesit të rregullt si në fazën e gjyqimit, ashtu edhe të ekzekutimit të detyrueshëm. Në këtë mënyrë ligji procedural ka ndërfutur si moderator të këtij procesi gjykatën e shkallës së parë të vendit të ekzekutimit.⁷⁹

Deri në vitin 2017, edhe pse ishte marrë një vendim gjyqësor, i cili kishte marrë formë të prerë nuk mund të vihej menjëherë në ekzekutim, pasi duhet të lëshohej urdhri i ekzekutimit. Lëshimi i urdhrit të ekzekutimit kërkonte një proces të veçantë dhe gjykata dilte me një vendim të veçantë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.

Me ndryshimet që i janë bërë nenit 511 të K.P.Civile, gjykata në dispozitivin e vendimit është e detyruar të parashikojë që vendimi është i ekzekutueshëm nga përmbartimi (neni 511/a K.P.C). Referuar analizës së vendimeve gjyqësore përgjithësisht në një pikë të dispozitivit gjykata shprehet: *“Ky vendim është i ekzekutueshëm nga përmbartuesi gjyqësor”*.

Krahas rregullave të përcaktuara në K.Pr.Civile për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore civile, në ligjin 49/2012, janë parashikuar disa rregulla specifike për ekzekutimin e vendimit gjyqësor administrativ.

Çdo akt i nxjerrë apo veprim i kryer nga organi publik i paditur, pasi vendimi i gjykatës administrative është bërë i ekzekutueshëm dhe që është në kundërshtim me dispozitivin e vendimit të gjykatës, është absolutisht i pavlefshëm dhe nuk pengon ekzekutimin e vendimit (neni 65/2l, i igjit 49/2012).

Në rastin e ekzekutimit të vendimit, gjykata administrative ka një rol aktiv, pasi gjatë procesit të ekzekutimit mund të urdhërojë kryerjen e veprimeve të posaçme, të vendosë afate dhe të caktojë mënyrën e kryerjes së veprimeve. Nëse Gjykata ka vendosur që një organ publik të nxjerrë një akt administrativ dhe ky i fundit nuk e zbaton vendimin e gjykatës edhe pas lajmërimit për ekzekutimin vullnetar, Gjykata mund të marrë vendim që zëvendëson aktin administrativ. Pra në këtë rast gjykata bëhet dhe ekzekutuesja e vendimit (neni 67 ligji 49/2012).

3. Zhvillimi i procedurës përmbartimore për ekzekutimin e vendimit

Vendimi gjyqësor vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbartimor gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përmbartuesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit (neni 515 K.P.C).

Përmbartuesi gjyqësor, kur fillon ekzekutimin, i dërgon debitorit një lajmërim për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhri i ekzekutimit, duke i caktuar për këtë një afat prej 5 ditësh, kur objekti i tij është pagë ose detyrim për ushqim dhe prej 10 ditësh në të gjitha rastet e tjera (neni 517 K.P.C).

Lajmërimi duhet të përmbajë një shkurtim të përmbajtjes së urdhrit të ekzekutimit, vendin, adresën e kreditorit dhe paralajmërimin që i bëhet debitorit se do të fillojë ekzekutimi i detyrueshëm, në qoftë se ekzekutimi nuk ekzekutohet vullnetarisht prej tij brenda afatit të caktuar në lajmërim (neni 517 K.P.C).

79. Shih vendimin Njësues nr.392, datë 26.10.2022 Kolegji Civil Gjykatës së Lartë

Në rastet kur debitori nuk ezekuton vullnetarisht vendimin e gjykatës, përmbaruesi vijon me ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit. Përmbaruesi gjyqësor, për çdo veprim të kryer prej tij, është i detyruar të mbajë procesverbal, në të cilin përmenden dita dhe vendi i kryerjes së veprimit, kërkesat dhe deklaratimet e bëra nga palët, sendet e marra, shuma e nxjerrë dhe shpenzimet e bëra për ekzekutimin (neni 519, 524 K.P.C).

Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv, duke respektuar parimin e ligjshmërisë, objektivitetit, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të garantuara me ligj subjekteve që marrin pjesë në ekzekutim.

Përmbaruesi gjyqësor shtetëror ose i organizuar mbi baza private, është një figurë e posaçme procedurale, që drejton fazën ekzekutive dhe që vihet në lëvizje me kërkesë të kreditorit. Për këtë qëllim, ligji procedural civil, e ka pajisur me kompetencën për të marrë vendime dhe për të nxjerrë urdhra, të cilat janë të detyrueshme për zbatim, pavarësisht dëshirës dhe vullnetit të debitorit. Megjithëse veprimtaria e përmbaruesit gjyqësor është e normuar nga ligji, ai nuk plotëson kualitetet e gjykatës apo quazigjykatës (sikurse janë pavarësia, paanësia etj.), prandaj aktet procedurale të realizuara prej tij, nga të cilat mund të cenohen të drejtat pasurore të debitorit ose të personave të tretë, i nënshtrohen kontrollit gjyqësor.⁸⁰

4. Pavlefshmëria e titullit ekzekutiv (neni 609 i K.Pr.C.)

Në nenin 609 të K.Pr.Civile, parashikohet shprehimisht se: *“Debitori mund të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël ose është shuar më pas”*.

Vendimi i gjykatës për detyrimin e palës së paditur për të kryer një veprim apo për të dhënë një send përbën titull ekzekutiv dhe është i ekzekutueshëm sapo merr formë të prerë ose në rastet kur vendimi është dhënë me ekzekutim të përkohshëm, ekzekutimi bëhet menjëherë.

Në nenin 317 të K.Pr.Civile parashikohet se: *“Vendimi i gjykatës mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm, kur është vendosur: a) detyrimi për ushqim; b) për shpërblimin nga puna; c) për rivendosjen në posedimin e banesës bashkëshortore. Vendimi mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm edhe kur nga vonesa e ekzekutimit, paditësi mund të pësojë dëme të rëndësishme, që nuk mund të vihen në vend, ose kur ekzekutimi i vendimit do të bëhej i pamundur, ose do të vështirësohej së tepërmi. Në këtë rast gjykata mund të kërkojë që paditësi të japë një garanci.*

Nëse gjykata është shprehur me vendim për detyrimin e palës së paditur për të kryer një veprim apo për të dhënë një send, ky i fundit nuk mund të paraqitet në gjykatë dhe të kërkojë pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor sipas nenit 609 të K.Pr.Civile, për fakte dhe rrethana që janë gjykuar gjatë procesit gjyqësor.

80. Shih vendimin njësuës nr.392, datë 26.10.2022 Kolegji Civil Gjykatës së Lartë

5. Kundërshtimi i veprimeve përmbarimore (neni 610 K.P.Civile)

Kundërshtimi i veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, i normuar në nenin 610 të K.P. Civile, është konceptuar nga ligji si mjet juridik mbrojtës, me natyrë thelbësisht procedurale, në dispozicion të palëve të një procesi gjyqësor civil, në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm. Ky mjet në duart e palëve, ka për qëllim të kundërshtojë veprimet (*aktet procedurale*) që kryhen nga përmbaruesi gjatë procesit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, ose kundër refuzimit të përmbaruesit për të ekzekutuar një titull ekzekutiv. Me këtë mjet, nuk kundërshtohet e drejta e kreditorit, por mënyra dhe ligjshmëria e zhvillimit të vetë procesit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, për shkak të mosrespektimit të ligjit procedural civil në vendimmarrjen dhe veprimet e përmbaruesit⁸¹.

Në nenin 610 të K.Pr.Civile parashikohet se: ***“Kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, të kryera në kundërshtim me procedurat e parashikuara nga ky Kod dhe kundër refuzimit të përmbaruesit gjyqësor për të kryer një veprim që i’a ngarkon ligji, palët mund të bëjnë ankim në gjykatën që ekzekuton vendimin, brenda 5 ditëve nga dita e kryerjes së veprimit ose refuzimit, kur palët kanë qenë të pranishme në kryerjen e veprimit ose kanë qenë thirrur, dhe, në raste të tjera, nga dita që u është njoftuar ose kanë marrë dijeni për veprimin ose refuzimin. Kundër veprimeve të personave, përmbaruesit gjyqësorë, që ushtrojnë veprimtarinë publike të shërbimit përmbarimor gjyqësor të organizuar mbi baza private, pala debitore mund të paraqesë ankim në gjykatën, ku ekzekutohet titulli ekzekutiv, brenda 5 ditëve nga data e kryerjes së veprimit”***.

Me ligjin nr.44/2021, gjykimi përmbarimor pësoi një ndryshim thelbësor. Në nenin 610 të KPC, u shtua paragrafi i tretë me këtë përmbajtje: ***“Ankimet kundër veprimeve ose refuzimit të përmbaruesit gjyqësor shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar i vetëm gjatë gjithë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv kur veprimet ose refuzimi i përmbaruesit gjyqësor lidhet me të njëjtin titull ekzekutiv, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.”***

Me këtë parashikim të fundit ligjor, u centralizua kompetenca e një gjyqtari të vetëm në shqyrtimin e të gjitha ankimeve ndaj veprimeve të përmbaruesit gjyqësor të lidhura me të njëjtin titull ekzekutiv. Nevoja për këtë ndryshim erdhi si rrjedhojë e problematikës që shkaktonte decentralizimi i procesit gjyqësor në fazën ekzekutive, ku ankimet ndaj veprimeve të përmbaruesit gjyqësor shqyrtoheshin si çështje të veçanta nga gjyqtarë të ndryshëm të cilët caktoheshin me short sipas nenit 154/a të KPC dhe sipas vendimit nr. 238/1/a, datë 24.12.2008 ***“Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore”*** të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.⁸²

Padia për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore ngrihet nga palët që janë kreditori e debitori, por edhe nga palë të tjera, që rast pas rasti pretendojnë se kanë interesa konkrete, efektive dhe aktuale me procesin e ekzekutimit, pra që me anë të kësaj padie synojnë të mënjanojnë cënimin e interesit të tyre nga aktet e parregullta të përmbaruesit. Kjo padi ngrihet jo vetëm në rastet kur parashikohet shprehimisht nga ligji, por edhe në ato raste kur palët dhe

81. Shih vendimin nr.392, datë 26.10.2022 Kolegji Civil Gjykatës së Lartë

82. Po aty

çdo subjekt i interesuar pretendon se nga zbatimi i gabuar i ligjit prej përmbauresit apo nga veprimet që ai po kryhen në rastin e rrethanat konkrete po i cënohen të drejta dhe interesa të ligjshme.⁸³

Kur faza e ekzekutimi të titullit ekzekutiv nuk kryhet midis palëve, debitorit apo kreditorit, por ndaj personave të tretë që nuk e kanë këtë cilësi, ata nuk mund të mbrohen ndryshe veçse duke kundërshtuar veprimet përmbartimore, përndryshe mohohet e drejta kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Për këtë arsye koncepti i “palës” në kuptimin e nenit 610 të K.Pr. Civile duhet zgjeruar, pasi kundërshtimi i veprimeve përmbartimore nuk është vetëm e drejtë e palëve pjesëmarrëse në konflikt.⁸⁴

Gjykimi përmbartimor ka për objekt pikërisht vlefshmërinë e këtyre akteve dhe me këtë logjikë juridike, edhe vendimet e gjykatës, në përfundim të gjykimit përmbartimor, kanë për qëllim kontrollin dhe drejtimin e fazës ekzekutive.

Ankimi kundër veprimeve të përmbartuesit shqyrtohet brenda 20 ditëve nga gjykata e vendit të ekzekutimit, e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë palët dhe përmbartuesin gjyqësor.

Gjykata shqyrton dhe vlerëson, nga pikëpamja procedurale, nëse ankimi është ngritur brenda afatit ligjor të parashikuar shprehimisht në nenin 610 të KPC dhe nëse veprimet e përmbartuesit gjyqësor janë kryer apo jo në përputhje me ligjin. Shkaku për të cilin mund të kundërshtohen gjyqësisht veprimet e përmbartuesit lidhen kryesisht me parregullsitë procedurale që mund të vërehen gjatë kryerjes së tyre nga ana e përmbartuesit, ose me mungesën e kushteve që duhen për të proceduar lidhur me ekzekutimin e një titulli ekzekutiv.⁸⁵ Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë, brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit të arsyetuar.

6. Kërkimi i sendit nga personi i tretë (neni 612 i K.Pr.C)

E drejta e ngritjes së padisë për të kërkuar sendin nga personi i tretë (i cili nuk ka statusin e debitorit), gjatë fazës së ekzekutimit të titullit ekzekutiv është parashikuar në nenin 612 të K.P.Civile.

Ky mjet juridik është vendosur formalisht në rregullimet e pjesës së katërt të KPC, pasi në thelb ka natyrën e një padie rivendikimi (*rei vindicatio*), e një lloji të veçantë, meqë ngrihet vetëm gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm, pra para se të ketë përfunduar ekzekutimi i detyrueshëm dhe sendi të jetë shitur në ankand. Gjithashtu ajo ka një karakter njohës dhe detyrues në të njëjtën kohë.

Gjykata në shqyrtimin e kësaj padie investohet në verifikimin e vlefshmërisë së titujve të pronësisë, që kanë palët ndërgjyqëse, me pretendime pronësie mbi sendin. Ajo konkludon për përjashtimin e sendit nga ekzekutimi, duke i njohur dhe konfirmuar titullin e pronësisë palës

83. Vendimin nr.157, datë 19.03.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.609, datë 20.11.2014;Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.81, datë 22.02.2011;

84. Shih Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Nr. 73, datë 07.02.2002

85. Shih vendimin nr. 658, datë 17.12.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

paditëse që i kundërvihet titullit të pronësisë së palës të paditur. Në përfundim të gjykimit, gjykata e detyron palën e paditur që të njohë pronësinë e paditësit mbi sendin.⁸⁶

Vendimi i dhënë nga gjykata në përfundim të gjykimit të investuar nga padia sipas nenit 612 të KPC është vendim përfundimtar dhe ndaj të tij mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve nga njoftimi i vendimit të arsyetuar.

7. Indikatorët për monitorimin e zbatimit të rregullave dhe afateve procedurale për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore civile dhe adminsitrativë

<i>Treguesit e realizimit</i>	<i>Po/Jo</i>
A i ka vendosur në dispozicion administrata gjyqësore vendimin e formës së prerë palës që ka fituar gjyqin brenda një kohe të arsyeshme?	
A ka kryer përmbaruesi të gjitha veprimet e nevojshme për ekzekutimin e vendimit gjyqësor?	
A i është drejtuar përmbaruesi debitorit duke i dërguar lajmërimet për ekzekutim vullnetar, për ekzekutimin e detyrueshëm, urdhrat për vendosjen e sekuestrove, kërkesa për përmbushjen e detyrimit, gjoba të ndryshme?	
A i ka respektuar përmbaruesi afatet procedurale për kryerjen e veprimeve të mësipërme?	
A i ka përmbushur përmbaruesi detyrimet e vendosura nga gjykata për pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv ose veprimeve përmbarimore?	
A e kanë përmbushur vullnetarisht, organet e shtetit detyrimin që buron nga vendimi gjyqësor?	
A i kanë përmbushur organet e shtetit detyrimin që buron nga vendimi gjyqësor nëpërmjet procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm?	
A është ekzekutuar vendimi gjyqësor civil brenda afatit 1 vjeçar?	
A është ekzekutuar vendimi gjyqësor administrativ brenda afatit 1 vjeçar?	
A ka pasur raste kur për shkak të mosekzekutimit të vendimit nga organi publik, gjykata me anë të një vendimi ka nxjerrë një akt administrativ?	
A ka pasur raste kur është kundërshtuar titulli ekzekutiv “vendim gjyqësor”?	
A është gjykuar brenda afatit 5 ditor kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të titullit?	
A është gjykuar nga gjykata e apelit brenda afatit 60 ditor ankimi kundër vendimit për pavlefshmërinë e titullit?	
A është gjykuar brenda afatit 20 ditor nga gjykata e shkallës së parë ankimi për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore?	
A është gjykuar nga gjykata e apelit brenda afatit 30 ditor ankimi për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore?	

86. Shih vendim nr.222, datë 23.06.2016 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

<i>Treguesit e realizimit/ indiktorët</i>	Shumë mirë	Mirë	Keq
Si e vlerësoni respektimin e afateve procedurale nga ana e përmbaruesve, palëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor?			
Si e vlerësoni rolin e administratës gjyqësore në komunikimin e vendimit gjyqësor brenda afateve procedurale?			
Si e vlerësoni punën e gjykatës në respektimin e afateve procedurale për shqyrtimin e kërkesave, ankimeve dhe padive gjatë ekzekutimit të vendimit gjyqësor?			

EKSTRAKTE NGA LEGJISLACIONI

Kushtetuta

Neni 42 paragrafi 2:

Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Neni 142:

- 1. Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.*
- 2. Gjykata e Lartë duhet t'i botojë vendimet e saj, si dhe mendimet e pakicës.*
- 3. Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.*

Kuadri ndërkombëtar

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

Neni 10:

Gjithkush gëzon njëlloj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Neni 14/1:

Të gjithë janë të barabartë përpara gjykatave dhe organeve të drejtësisë. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të trajtohet me paanësi dhe publikisht nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme, e ngritur sipas ligjit, që do të vendosë qoftë për përcaktimin e çdo akuze të karakterit penal që drejtohet kundër tij, qoftë për konfliktet lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tij në fushën civile.

Neni 19/3:

*Çdo person i arrestuar ose i ndaluar për shkak të një vepre penale duhet të nxirret, pa vonesë, përpara një gjykatësi ose ndonjë zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për ushtrimin e funksioneve gjyqësore **dhe duhet të gjykohet brenda një afati të***

arsyeshëm ose të lirohet. Ndalimi i personave të cilët presin të gjykohen nuk duhet të jetë rregull i përgjithshëm, por lirimi mund të kushtëzohet me garanci për të siguruar daljen e të interesuarit para gjyqit, në cilëndo fazë tjetër të procedurës gjyqësore, dhe po qe se paraqitet nevoja, edhe për ekzekutimin e gjykimit.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Neni 6/1:

Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

Kartës së të Drejtave Fundamentale të Bashkimit Evropian

Neni 47:

*Të gjithë ata, të cilëve u janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me të drejtën e Bashkimit Evropian, kanë të drejtën e zgjidhjes efektive në një tribunal, në pajtim me kushtet e caktuara në këtë Nen. Të gjithë kanë të drejtën e seancës dëgjimore të drejtë dhe publike, **dhe brenda një kohe të arsyeshme**, nga një tribunal i pavarur dhe neutral i cili paraprakisht ka qënë i themeluar në mënyrë të ligjshme.*

Kuadri ligjor i brendshëm

Kodi Procedurës Civile

Neni 4:

Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jepen nga ky Kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme.

Neni 14:

Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin.

Neni 15:

Palët janë të detyruara të japin ndihmesën e tyre për zhvillimin normal të hetimit gjyqësor. Gjykata i ngarkon ato me përgjegjësi në rast mosveprimi ose pengimi me faj të tyre.

Neni 28:

Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrihen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm.

Neni 171:

Gjykata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor. Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kërkuara prej saj.

Neni 310:

Vendimi duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese.

I. Në hyrjen e vendimit duhet të përmenden:

- 1. gjykata që ka gjykuar çështjen;*
- 2. trupi gjykues dhe sekretari;*
- 3. koha dhe vendi i dhënies së vendimit;*
- 4. palët, duke u shënuar identiteti dhe cilësia e tyre si paditës, i paditur, ndërhyrës, si dhe përfaqësuesit e tyre;*
- 5. emri i prokurorit, nëse ka marrë pjesë;*
- 6. objekti i padisë;*
- 7. kërkimet përfundimtare të palëve;*
- 8. mendimi i prokurorit nëse ka marrë pjesë.*

II. Në pjesën përshkruese-arsyetuese duhet të përmenden:

- 1. rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë gjykimit dhe përfundimet e nxjerra nga gjykata;*
- 2. provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi;*
- 3. dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi.*

Vendimi i gjykatës për paditë me vlerë deri në deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi duhet të përmbajë hyrjen dhe pjesën urdhëruese, sipas pikës 1 të këtij neni. Nëse palët, brenda tre ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, njoftojnë me shkrim gjykatën

se do ta ankimojnë vendimin, gjykata arsyeton vendimin dhe ua njofton palëve.

III. Në pjesën urdhëruese, ndër të tjera, duhet të përmenden:

1. çfarë vendosi gjykata;
2. 1/1. nëse gjykata vendos detyrime për palët, përmbajtjen konkrete të tyre dhe se vendimi është i ekzekutueshëm nga përmbartuesi gjyqësor;
3. kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore; 3. e drejta për të bërë ankim dhe afati për paraqitjen e tij.

Neni 399/1:

1. Në kompetencë të gjykatave, sipas shkallëve të gjykimit të përcaktuar në këtë kre, hyjnë edhe shqyrtimi i kërkesave për shpërblimin e drejtë të personit që ka pësuar një dëm pasuror ose jopasuror, për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes, sipas përkufizimit të nenit 6/1 të Konventës Europiane "Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore".
2. Dispozitat e këtij kreu përcaktojnë vlerësimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, si edhe shpërblimin e drejtë, kur konstatohet kohëzgjatje e paarsyeshme në procedurat e hetimit, gjykimit të çështjeve, si edhe në procedurat e ekzekutimit të vendimeve.

Neni 399/2:

1. Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen:
 - o në gjykimin administrativ në shkallën e parë dhe në apel, përfundimi i gjykimit brenda një viti nga fillimi i tij në secilën shkallë;
 - o në gjykimin civil në shkallë të parë përfundimi i procesit të gjykimit brenda dy viteve, në gjykim civil në apel brenda dy vjetëve; dhe gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, brenda dy vjetëve;
 - o në procedurën e ekzekutimit të një vendimi civil apo administrativ, me përjashtim të detyrimeve periodike ose të përcaktuara në kohë, afati njëvjeçar fillon nga dita e paraqitjes së kërkesës për vënie në ekzekutim;
 - o Në hetimin e veprave penale afati maksimal i kohëzgjatjes së hetimeve, sipas Kodit të Procedurës Penale;
 - o në gjykimin penal në shkallë të parë, afati i gjykimit të krimeve 2 vjet dhe i kundërvajtjeve 1 vit, në gjykimin në apel përfundimi i gjykimit për krimet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj dhe në Gjykatën e Lartë, përfundimi i gjykimit për krimet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj.
2. Palët në proces mund të kërkojnë konstatimin e tejzgjatjes së procedurave, sipas nenit 399/6 pika 1, edhe pa kaluar afatet e mësipërme, duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjykimit, sjelljen e organit që po kryen procedurat, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen, kur pretendojnë zvarritje të hetimit, gjykimit ose ekzekutimit të vendimit.
3. Në kohëzgjatjen e gjykimit ose të procedimit, nuk llogaritet koha kur çështja është

pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, sipas këtij kreu, ose kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim.

Kodi Procedurës Penale

Neni 1:

1. Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit.

Neni 2:

- 1. Dispozitat procedurale caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit.*
- 2. Dispozitat procedurale penale janë të zbatueshme edhe për të pandehurit e mitur për aq sa nuk parashikohet ndryshe në ligjin e posaçëm në fuqi.*

Neni 11:

- 1. Gjykata është organi që realizon dhënien e drejtësisë.*
- 2. Askush nuk mund të deklarohet fajtor dhe të dënohet për kryerjen e një vepre penale pa vendim të gjykatës.*

Neni 12:

Drejtësia penale jepet nga:

- a) gjykatat penale të shkallës së parë;*
- b) gjykatat e apelit;*
- c) Gjykata e Lartë.*

Neni 342:

- 3. Kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të përfundohet në një seancë të vetme, gjykata vendos që të vazhdojë ditën e mëpasme të punës.*
- 4. Gjykata mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor, vetëm për arsye të veçanta, deri në pesëmbëdhjetë ditë.*

Neni 383:

Elementet e vendimit

1. *Vendimi përmban:*
 - a) *gjykatën që e ka dhënë;*
 - b) *gjeneralitetet e të pandehurit ose të dhëna të tjera personale që vlejné për ta identifikuar, sidhe gjeneralitetet e palëve të tjera private;*
 - c) *akuzën;*
 - ç) *parashtrimin e përmbledhur të rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta;*
 - d) *dispozitivin, duke treguar nenet e zbatuara të ligjit;*
 - dh) *datën dhe nënshkrimin anëtarëve të trupit gjykues.*
2. *Vendimi është i pavlefshëm kur mungon dispozitivi ose nënshkrimi i anëtarëve të trupitgjykues, si dhe kur ka haptazi kontradiktë mes arsyetimit dhe dispozitivit të tij.*

Neni 407:

Rastet dhe mjetet e ankimit

3. *Ligji cakton rastet në të cilat vendimet dhe urdhrat e gjykatës mund të ankimohen, si dhe mjetin e ankimit.*
4. *Ankimi i urdhrave të gjykatës, kur nuk parashikohet ndryshe nga ligji, mund të bëhet vetëm*
 1. *me ankimin kundër vendimit.*
5. *Mjetet e ankimit janë: apeli, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe kërkesa për rishikim.*
6. *E drejta e ankimit i takon vetëm atij që ligji ia njuh shprehimisht. Kur ligji nuk bën dallim ndërmjet palëve, kjo e drejtë i takon secilës prej tyre.*
7. *Kur ankimi bëhet në gjykatën jokompetente, ajo ia dërgon aktet gjykatës kompetente*

Ligji 49/ 2012:

Neni 3:

1. *Gjykata, në gjykimin administrativ, siguron nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, mbrojtjen juridike të të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë të subjekteve, që mund të cenohen si pasojë e ushtrimit ose jo të funksioneve publike nga ana e organeve të administratës publike.*
2. *Gjykata administrative zbaton parimin e mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave e interesave të ligjshëm të personave privatë.*
3. *Organi i administratës publike, si rregull, ka detyrimin të provojë bazueshmërinë në ligj dhe në fakt të veprimeve të kryera prej tij.*

4. *Gjykata administrative, sipas natyrës së çështjes, shqyrton çështjen gojarisht në seancë gjyqësore ose mbi bazë aktesh shkresore në dhomë këshillimi. Mosparaqitja e palëve nuk përbën shkak për pushimin e gjykimit.*

Neni 41:

Përmbajtja e vendimit Përveç sa parashikohet në Kodin e Procedurës Civile, vendimi i gjykatës administrative përmban edhe:

- a) *përcaktimin e qartë të çështjeve, në pjesën arsyetuese, të vlerësuara sipas nenit 37 të këtij ligji;*
- b) *përcaktimin në pjesën urdhëruese, se kur parashikohet një detyrim konkret i palës së paditur, ai është i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor. Në këtë rast gjykata përcakton afatin dhe mënyrën e ekzekutimit të vendimit.*

Neni 42:

1. *Vendimi, pavarësisht formës së gjykimit, duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar.*
2. *Në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, gjykata shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 5 ditë.*
3. *Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore.*

Neni 48:

1. *Gjykata, ku është paraqitur ankimi, dërgon ankimin, së bashku me aktet që i bashkëlidhen atij, vendimin e gjyqtarit për pranimin e ankimit, aktet e komunikimit të ankimit, si dhe dosjen e gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.*
2. *Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi.*
3. *Gjykata Administrative e Apelit dërgon dosjen në gjykatën administrative të shkallës së parë jo më vonë se 3 ditë pas kryerjes së njoftimit të vendimit të palëve.*

Neni 60:

1. *Gjykata administrative e shkallës së parë dërgon rekursin, së bashku me aktet që i bashkëlidhen atij, vendimin e gjyqtarit për pranimin e rekursit, aktet e komunikimit të rekursit, kundërrekursin, si dhe dosjen e gjykimit në Gjykatën e Lartë, brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të komunikimeve.*
2. *Gjykata e Lartë shqyrton çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit dhe akteve bashkëlidhur prej gjykatës ku është depozituar rekursi.*

RASTE STUDIMORE

Kazus 1:

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur masën e sigurimit “arresti në shtëpi” për veprën penale të parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal (shpërdorimi i detyrës). Gjykata e apelit vendos ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe heqjen e masës së sigurimit. Që të ekzekutohet vendimi (siç do të analizojmë më poshtë) gjykata duhet që minimalisht të shpalli një vendim të arsyetuar ose një përmbledhje të vendimit. Shtetasi A, 1 ditë pas shpalljes së vendimit të apelit planifikon të lëvizë jashtë vendit, meqë ndaj tij nuk kishte asnjë masë. Policia kufitare arreston personin për shkelje të masës së sigurimit “arresti në shtëpi”. Deri në nxjerrjen e urdhrin të ekzekutimit nga prokurori personi qëndron në ambientet e paraburgimit.

Varianti A:

Gjykata menjëherë pas shpalljes, i dërgon një përmbledhje të vendimit prokurorisë. Prokurori nxjerr urdhrin e ekzekutimit pas 2 ditësh nga momenti i marrjes së përmbledhjes së vendimit dhe ia njofton urdhrin policisë kufitare.

Varianti B:

2 ditë pas shpalljes së vendimit, Gjykata i dërgon prokurorit përmbledhjen e vendimit të arsyetuar. Prokurori menjëherë pas marrjes së vendimit nxjerr urdhrin e ekzekutimit dhe i'a njofton policisë.

Treguesit e realizimit/Indikatorët:

- A është çenuar liria e personit për shkak të shkeljes së afateve dhe procedurave nga ana e gjykatës dhe prokurorisë?
- A ka shkelur gjykata afatin për dhënien e vendimit të arsyetuar brenda afatit ligjor në variantin B?
- A ka shkelur prokuroria afatet për ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit në variantin A?
- A ka shkelje të parimit për gjykimin e “çështjes brenda afatit të arsyeshëm”?

Kazus 2:

A" paraqet padinë në sekretarinë e gjykatës në datën 10.05.2022. Padia regjistrohet në datën 20.05.2022. Një nga kërkimet e objektit të padisë është dhe marrja e masës së sigurimit të padisë. Gjykata kryen veprimet paraprake në datën 20.09.2022, duke e vendosur t'ia njoftojë aktet palës së paditur, duke i lënë një afat për paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes 50 ditë nga momenti i marrjes së dijenisë mbi vendimin, padinë dhe aktet. Ftusi gjyqësor njofton palën e paditur për vendimin dhe aktet bashkangjitur në datën 30.10.2022.

Treguesit e realizimit/Indikatorët:

1. A është regjistruar padia në ditën e paraqitjes së padisë?
2. A është shqyrtuar kërkesa për marrjen e masës së sigurimit të padisë brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së padisë?
3. A është repektuar afati maksimal prej 30 ditë për paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes?
4. A janë realizuar veprimet përgatitore brenda afatit 7 ditor nga ana e gjykatës?
5. A janë caktuar seancat gjyqësore brenda afatit 15 ditor nga gjykata e shk.1?
6. A është dërguar nga administrata gjyqësore dosja në Gjykatën e Apelit brenda afatit 15 ditor nga data e depozitimit të ankimit?
7. A është shqyrtuar çështja në apel brenda 30 ditëve nga momenti i regjistrimit të çështjes?

Kazus 3:

Në datën 15.03.2023, ndaj shtetasit A është marrë vendim për "Prishje të banesës" për shkak se është konsideruar ndërtime pa leje. Në datën 16.03.2023, shtetasi A i drejtohet gjykatës administrative me kërkesë për marrjen e masës së sigurimit të padisë duke kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit për prishjen e banesës.

Varianti A:

Gjykata administrative cakton datën 21.03.2023, për zhvillimin e seancës për shqyrtimin e kërkesës. Mbrojtësi ligjor i shtetasit A kërkon shtyrjen e seancës së datës 21.03.2023, për shkak se ishte sëmurë dhe ishte në pamundësi për të ndjekur seancën. Gjykata pranon kërkesën për shtyrje dhe cakton datën 15.04.2023. Gjykata me vendimin e datës 15.04.2023 vendos pranimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë.

Varianti B:

Gjykata administrative cakton datën 21.04.2023, për zhvillimin e seancës për shqyrtimin e kërkesës. Në datën 19.04.2023, IKMT ekzekuton vendimin dhe prish banesën e shtetasit A. Gjykata në datën 21.04.2023, vendos rrëzimin e kërkesës me arsyetimin që vendimi për prishjen ishte ekzekutuar.

Treguesit e realizimit/Indikatorët:

1. Cilat parime/standarte mendoni që janë shkelur në variantet e mësipërme?
2. A kemi shkelje të afateve procedurale në variantin A?
3. A kemi shkelje të afateve procedurale në variantin B?
4. Si ndikon vendimi i gjykatës në variantin B në cilësinë e zhvillimit të gjykimit dhe dhënien e drejtësisë?
5. Si mund të monitorojmë respektimin e afateve procedurale?
6. Si mund t'i analizojmë të dhënat në lidhje me respektimin e afateve procedurale?

BIBLIOGRAFIA

Ligjet

- Ligji nr. 49/2012 Ligji nr. 49/2012 *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar
- Ligji nr. 111/2017 Ligji nr. 111/2017 *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*
- Ligji nr.115/2016 Ligji nr.115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*
- Ligji nr.96/2016 Ligji nr.96/2016 *“Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”*.
- Ligji nr. 10385 Ligji nr. 10385, datë 24.02.2011 *“Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”*
- Ligji nr. 79/2020 Ligji nr. 79/2020 *“Për ekzekutimin e vendimeve penale”*

Literaturë

- Piotr STASZCZYK ‘Pozicioni i debitorit dhe kreditori sipas legjislacionit Brusles, legjislacioni dytesor, STUDIA PRAËNO-EKONOMICZNE, t. XCIV, 2015 PL ISSN 0081-6841 s. 109–121;
- Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri, Qershor 2015, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë;
- Udhëzues rreth nenit 5 të Konventës, E drejta për lirinë dhe sigurinë personale”, Këshilli i Evropës/Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2014, fq.35;
- Bianku.Ledi “Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut”, çështja Rajak vs. Kroacisë, kërkesa nr.49706/99 Tiranë 2005, fq 343;
- Terihati.F, Kurti.A *“Risitë dhe sfidat e përfshirjes së llojeve të reja të gjykimeve të posaçme në Kodin e Procedurës Penale”*, Interantional Scientific Conference, Universiteti i Tiranës, 7 Dhjetor 2017;
- Skënderaj. K, Hoxha. A *“Ekzekutimi i vendimeve penale”*, Shëtpia Botuese Morave 2019;

- Mërkuri. E, “*Organet e sistemit të drejtësisë*”, Monitorimi i Zbatimit të Reformës në Drejtësi, Tiranë 2020, fq.1
- Raporti: Studim dhe Monitorim i Gjykatës së Rrethit Tropojë”, përgatitur nga Qendra Integrim dhe Zhvillim Demokratik”, Viti 2019
- “Një hartë e re gjyqësore për Shqipërinë”, Raport vlerësimi nga KLGJ – Shtator 2021, aksesuar në linkun: <https://klgj.al/ep-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>;
- Raporti “Mbi Gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2020”, aksesuar në linkun: http://www.gjykataelarte.gov.al/ëeb/raporti_vjetor_klgj_2020_6578.pdf;
- Raportin Vjetor të Performancës për vitin 2022., Gjykata e Lartë, aksesuar në linkun http://www.gjykataelarte.gov.al/ëeb/raporti_vjetor_i_performances_se_gjykates_se_larte_per_vitin_2022_redaktuar_final_14055.pdf;
- Raporti Vjetor për vitin 2021 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, aksesuar në linkun <https://www.gjykata.gov.al/gjykata-administrative-e-shkallës-se-pare-tiran%C3%AB/gjykata-administrative-tiran%C3%AB/njoftime-p%C3%ABr-publikun/>;
- “Udhëzues për paraqitjen dhe shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë”, aksesuar në linkun:
http://www.gjykataelarte.gov.al/web/rregullat_e_rekursit_ne_gjl_2021_5779.pdf

Faqe interneti

- <https://rm.coe.int/best-practices-on-the-prevention-of-the-unreasonable-length-of-proceed/1680790b44>
- <https://www.gjykata.gov.al/gjykata-administrative-e-apelit/gjykata-administrative-e-apelit/statistika/koh%C3%ABzgjatja-e-c%C3%ABshtj%C3%ABve/>
- <http://juridiksi.e-monsite.com/faqe/e-drejta-penale/leksione/denimet-alternative.htm>

Vendime GJENDJ

- Vendimi i GJEDNJ “Gjon bocari etj. Kundër Shqipërisë” (aplikim nr.10508/02, datë 31.03.2008
- Vendimin e GJEDNJ “*Eckle kundër Republikës Federale Gjermane*”, datë 15.07.1982;

- Vendimin e GJEDNJ “*Humen kundër Polonisë*” [GC], 15 tetor 1999, § 66
- Vendimin e GJEDNJ “*Tsikakis k. Gjermanisë*”, 10 shkurt 2011, §§ 64 dhe 68;
- Vendimin e GJEDNJ *Thlimmenos k. Greqisë* [GC], 6 prill 2000, §§ 60 dhe 62;
- Vendimin e GJEDNJ “*Triggiani kundër Italisë*” datë 19.02.1991;
- Vendimin e GJEDNJ “*Manieri kundër Italisë*” dt. 27.02.1992,
- Vendimin e GJEDNJ “*Stefancic kundër Sllovenisë*”, datë 25.10.2012;
- Vendimin e GJEDNJ-së “*Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*”, aplikimet nr. 43391/18 dhe 17766/19, datë 12.10.2021;

Jurisprudenca vendase:

- Vendimi nr.139, datë 21.06.2023 i Gjykatës Kushtetuese;
- Vendimi nr.1 datë 30 05.2022 Kolegji i Posaçëm i Apelit i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
- Vendimi nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese;
- Vendimi nr.16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese;
- Vendimi 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 13 datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese;
- Vendimi nr.6, datë 02.3.2018 të Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi nr. 22, datë 20.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi nr. 76, datë 04.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 26 datë 27.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese
- vendimi nr. 46 datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi nr.14, datë 10.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese;
- Vendimi nr.1, datë 21.01.2016 të Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi. 59, datë 16.09.2016 të Gjykatës Kushtetuese;
- Vendimi nr. 83, datë 30.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimin nr. 69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi nr.2, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese;
- Vendimi nr.3, datë 23.01.2014 të Gjykatës Kushtetuese;

- Vendimi nr.55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi nr. 12, datë 05.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr.8, datë 16.03.2011 të Gjykatës Kushtetuese;
- Vendimi nr.7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi nr.23, datë 04.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese;
- Vendimi nr.11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese;
- Vendimi nr.3, datë 19.02.2013 i Gjykatës Kushtetuese;
- Vendimi nr.20, datë 13.04.2012 i Gjykatës Kushtetuese;
- Vendimi nr 38, datë 30.12.2010 i Gjykatës Kushtetuese;
- Vendimi nr.6, datë 02.3.2018 të Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi nr. 5, datë 2.02. 2001 të Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi unifikues GJL nr.2/2014;
- Vendimi nr. 00-2023-2493, datë 08.06.2023 i Kolegjit Administrativ i Gj. Lartë;
- Vendimin nr. 33/2, datë 17.01.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë;
- Vendimi nr. 10-2023, datë 23.03.2023 Gjykata e Lartë;
- Vendimi nr. 00-2023-2342, datë 13.06.2023 të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr.392, datë 26.10.2022 Kolegji Civil Gjykatës së Lartë
- eVdimin nr.392, datë 26.10.2022 Kolegji Civil Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr.157, datë 19.03.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë;
- Vendimi nr.609, datë 20.11.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë;
- Vendimi nr. 658, datë 17.12.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë;
- Vendimi nr.81, datë 22.02.2011 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë;
- Vendimi nr.3384, datë 03.07.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Juridiksioni Përgjithshëm Tiranë;

Të tjera:

- Rekomandimi nr. (87)18E i Komitetit të Ministrave pranë Këshillit të Evropë, 1987 *“Në lidhje me lehtësimin e procedurave në sistemin drejtësisë penale”*
- Relacioni *“Projektligjin për Kodin e Procedurës Civile”*, aksesuar në:

- <http://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/RELACION-KODI-PROCEDURAVE-CIVILE-1.pdf>
- Relacioni për ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale
- Relacioni për projekt ndryshimet për Kodin e Procedurës Penale, aksesuar në linkun: <https://www.aksedrejttesi.al/dokumenta/1597827373RELACION-SHTESA-E-NDRYSHIME-7905-KODI-I-PROCEDURES-PENALE-Resized.pdf>
- Relacioni për projektligjin nr.49/2012 *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*
- Rregulloren (KE) nr. 861/2007 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 11 Korrik 2007

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore
Monitorimi i aksesit në drejtësi dhe performanca gjyqësore
për zhvillimin e një gjykimi të drejtë : afatet dhe cilësia e
gjyqimit : manual trajnimi për shoqërinë civile / Instituti për
Studimet Publike dhe Ligjore. - Tiranë : Muza, 2023.

Pj.3, ... f. ; ... cm

ISBN 9789928361479

1.E drejta dhe legjislacioni 2.Gjykata 3.Gjykimi

4.Manuale 5.Shqipëri

34(496.5) (035)